

BIBLIOTEKA

B5H-82

N 78

F. Noë


Pjesë
të
zgjedhura

BSH-82

N 78 BIBLIOTEKA E NXËNËSIT

F. S. NOLI

PJESË TË ZGJEDHURA



- poezi
- shqipërime
- introdukta
- artikuj
- ese dhe biseda

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR

Ky botim bëhet për nxënësit, prandaj është i pajisur me shënime e sqarime që të kuptohet e të interpretohet drejt. Ndonjë nga pjesët është shkurtuar dhe janë bërë ndreqjet e nevojshme drejtshkrimore në atë masë që të mos çënojnë origjinalitetin e stilit dhe të gjuhës së Nolit.

Përgatitja e këtij botimi është bërë sipas përmbledhjes «Vjersha të zgjedhura» Tiranë 1965 pajisur me shënime nga Dh. Pasko dhe F.S. Noli, «Vepra», vëllim 1-5 Tiranë 1987.

Përgatitur për botim nga **Stefan Bulo**

Redaktor: Rita Petro
Kopertina: Shkëlqim Fekushi

Recensues: Gjergj Zheji

... Noli rron e do të rrojë në radhë të parë si krijues i veprave madhore poetike; siç rron Eskili në figurën simbol të «Prometeut të lidhur» dhe Gëte me «Faustin» dhe ëndrrën e tij për një popull të lirë me tokë të lirë. Noli do të rrojë për jetë në historinë e letërsisë e të kulturës shqiptare e botërore me figurën e madhe të Maratonmakut të kuq që vrapon faqendritur nëpër shekuj duke sjellë lajmin gazmor, optimizmin revolucionar, lajmin e fitores të të shtypurve të bashkuar; rron në figurën madhështore të lumenjve vërshues që çbijnë, përmbysin e përmbysin në valët e tyre një botë të tërë të vjetër, të kalbur; rron me simbolin e madh të luftëtarëve popullorë që pikërisht kur bien, ngrihen më lart, si legjendari Ante; rron në figurën e madhe të flamurit të vegjëlisë: «le të dridhen tiranët — ja cili ishte kuptimi që i jepte ai këtij simboli; e sotmja e tiranëve është e shkurtër dhe e nesërmja e madhe e jona, e luftëtarëve të lirisë që janë kryelartë për të djeshmen, të patrenbur nga e sotmja, të sigurt për të nesërmen»; janë këto fjalë një porosi, një amanet i madh gjithmonë i gjallë i tij.

Pa karakter të madh, nuk ka as artistë të mëdhenj, tha ai për Betovenin. Kjo fjalë e madhe mund të vlejë edhe për Nolin tonë, për poetin e madh, për prozatorin, për publicistin militant, për gojëtarin e zjarrtë e dramaturgun, për historianin e mendimtarin, për kritikun e artit e të letërsisë, për mjeshtrin e madh që i fali gjuhës sonë të shenjtë shqipe një potencial të rrallë fuqie shprehëse artistike; ai la gjurmë të thella e të pashlyeshme në historinë e popullit tonë e të kulturës së tij.

Noli i lidhur gjatë gjithë jetës së tij me popullin e vet, me njerëzit e vegjëlisë, me punëtorët e katundarët,

të cilëve u njohu vuajtjet, dhe i thirri në luftë dhe u
admiroi fitoret, militon midis nesh; është i yni, pikërisht
i këtij populli punëtor që ndërton sot socializmin dhe
ecën sypatrembur, ballëlart e fitimtar, ashtu siç e pat
ëndërruar dikur Noli, duke siguruar për jetë e mot
të ardhmen e këtij kombi me rrënjë të lashta dhe gjith-
monë i ri — të kombit shqiptar.

ALEKS BUDA

(Marrë nga Noli, Vepra 1, Tiranë 1987)

Himni i flamurit*)

O flamur gjak, o flamur shkabë,
o vend e vatr', o nën' e babë,

*) Poezia «Himni i flamurit» është shkruar më 14 nëntor 1926 dhe u botua për herë të parë në gazetën «Liria kombëtare» të Gjenevës, në numrin e jashtëzakonshëm të 28 Nëntorit 1926, kushtuar Ditës së Flamurit.

«Liria kombëtare» e Gjenevës (Zvicër) ishte organ i Komitetit Nacional Revolucionar (KONARE), organizatë politike e demokratëve shqiptarë antizogistë dhe antifashistë, që kishin marrë pjesë në revolucionin e Qershorit 1924 dhe që, pas shtypjes së këtij, ishin mërguar jashtë shtetit. Komiteti Nacional Revolucionar ishte themeluar më 25 mars 1925, në Vjenë dhe kishte, qysh në fillim, për kryetar Fan S. Nolin.

Pasi u dëbua nga Shqipëria, në qershor 1924, Ahmet Zogu u hodh në Jugosllavi bashkë me një pjesë të klikës së tij dhe atje filloi intrigat kundër qeverisë demokratike të Shqipërisë, kundër atdheut.

Me përkrahjen e imperialistëve dhe me ndihmën ushtarake të qeverisë borgjeze jugosllave, Ahmet Zogu përgatiti kundërvolucionin, sulmin e dhjetorit 1924 dhe përmbysjen e qeverisë demokratike. Si mori fuqinë në dorë, ai u lidh me Italinë fashiste. I dha asaj një sërë koncensionesh ekonomike dhe financiare, Ahmet Zogu organizoi një terror të vrazhdë policor dhe vrasjen sistematike të patriotëve shqiptarë brenda dhe jashtë atdheut. L. Gurakuqin dhe B. Currin i vrau, ndërsa Nolin e dënoi me vdekje në mungesë. Pavarësia kombëtare, e fituar me gjakun dhe sakrificat e shumë brezave në luftë kundër armiqve të shumtë, kishte mbetur vetëm sa për sy e faqe, sepse në Shqipëri sundonte kapitali italian.

Përballë tradhtisë së lartë të Ahmet Zogut, që ishte përfaqësues i interesave të klasave feudalo-borgjeze, patriotët e vërtetë u hodhën përsëri në luftë, si në kohën e Rilindjes, për të mbrojtur atdheun, popullin shqiptar dhe simbolin e tyre, flamurin.

Këto kanë qenë rrethanat në të cilat Fan Noli shkroi dhe botoi poezinë «Himni i Flamurit».

lagur me lot, djegur me flakë,
flamur i kuq, flamur i zi.

Fortesë shkëmbi, tmerr tirani,
s'të tremb romani¹⁾, as veneciani,²⁾
as serb Dushani,³⁾, as turk sulltani,⁴⁾
flamur i madh për vegjëli.

Flamur që lint Shën Kostandinin⁵⁾
pajton Islam me Krishterimin
shpall midis feve vllazërimit,⁶⁾
flamur bujar për Njerëzi.⁷⁾

Me Skënderben' u lavdërove
dhe në furtun' i fundmi u shove,⁸⁾
me Malon⁹⁾ prapë lart vrapove,
yll i pavdekur për liri.

Sa shpesh, pastaj përdhe u shtrive,
me zjarr e zi u ndeze, u nxive,
po çdo mizor me shpat' e grive,
o fushëkuq, o shkabëzi.

Përpyetë prie Shqipërinë,
përlindja¹⁰⁾ shpirtin dhe fuqinë.
diell për vllanë, yrnek¹¹⁾ për fqinjë,
për botën ëndrr' e qiell i ri.

1. **S'të tremb romani...** — Është fjala për qëndresën e rreptë, me armë në dorë, të stërgjyshërve tanë ilirë kundër romakëve, që nga shekulli III para erës së re dhe gjer në fillim të shekullit I të erës së re. Luftërat iliro-romake zgjatën shekuj të tërë. Kryengritja e madhe ilire e viteve 6-9 të erës sonë tundi themelet e pushtimit romak. Romakët, pas Ilirisë pushtuan Galinë (Francën e sotme), Belgjikën, Spanjën, Portugalinë dhe i romanizuan. Më vonë, në mbarim të shekullit I dhe në fillim të shekullit II, pushtuan Dakinë, (Rumaninë e sotme) dhe e romanizuan. Por Ilirinë nuk e romanizuan dot.

2. ... **as veneciani** — Në shekullin XIV, ndërsa principatat arbërore luftonin për të përballuar sulmet e rrebeshta të turq-

ve, republika tregtare e Venedikut u hodh e pushtoi shumë qendra bregdetare të vendit tonë, për të nxjerrë fitime tregtie. Ajo vuri dorë mbi Durrësin, Shkodrën, Lezhën, Danjën dhe qendra të tjera arbë. Lakmia dhe pabesia e Venedikut dëmtoi shumë qëndresën tonë në luftërat kundër Turqisë.

Me fjalën «veneciani» vjersha bën aluzion këtu edhe për imperializmin italian.

3. **As serb Dushani** — Aty nga mesi i shekullit XIV, Stefan Dushani i Serbisë pushtoi një pjesë të madhe të vendeve të Ballkanit, duke krijuar njëfarë perandorie feudale serbe, që nuk i pati dirët të gjata. Stefan Dushani pat pushtuar edhe një pjesë të tokave të Arbërisë, duke i bërë disa nga feudalët arbër vasalë të tij.

Në një kuptim alegorik, fjalët **As serb Dushani** mund të merren edhe me kuptimin: s'të trembin sulmet e shovinistëve serbë, trashëgimtarë të synimeve pushtuese të Dushanit.

4. **as turk sulltani** — as Turqia me sulltanët e saj.

5. **Shën Kostandinin:** — Është fjala për Kostandinin I, i quajtur edhe Kostandini i Madh (apo Shën Kostandini), perandor romak me origjinë ilire, lindur në Nish. Kostandini I hipi në fron më 306 dhe mbi germadhat e Bizantit të vjetër themeloi Kostandinopojën. Më 313 la të lirë fenë kristiane, që deri atëherë ndiqej si herezi (ishte e paligjshme në Perandorinë Romake). Figura e Kostandinit idealizohet nga Noli, sepse është me origjinë ilire dhe nuk ve në dukje se edhe me këto masa ai u shërbente interesave të klasave sunduese skllavopronare.

6. Me këto vargje (2 dhe 3) Noli në vazhden e letërsisë sonë më përparimtare e patriotike i bën jehonë idesë së madhe, që «Flamuri» si simbol i kombit, ngrihet mbi dasitë fetare, bashkon e vëllazëron besimtarët e ndryshëm që P. Vasa e shpreh «Feja e shqiptarit është shqiptarija».

7. Edhe një herë Noli si demokrat flamurin e quan simbol të *njerëzisë*, të *veggjëlisë*, jo të klasave sunduese, ndaj edhe ua kushton atyre.

8. **Dhe në furtun' i fundmi u shove** — «Furtuna» është sulmi i osmanëve. Ndër popujt e Ballkanit, ai që qëndroi më gjatë kundër sulmeve osmane qe populli shqiptar.

9. **Me Malon** — Me Ismail Qemalin.

10. **Përlindja** — rilindja, ia lind rishtas.

Fjala «përlindje», që u përdor shumë kohë në mbarim të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, u zëvendësua më vonë me fjalën «rilindje».

11. **yrnek** — shembull, model.

Jepni për nënën*)

Ç'thot' ajo e ve e gjorë,
— Mbretëshë pa kurorë
faqëgjerrur, leshlëshuar,
shpirt e zemër përvëlur
gjysm' e vdekur: «O Shqiptarë,
Nënës mos ia bëni varrë!»¹⁾
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
se ke djemtë n'Amerikë!²⁾

Qan e lutet Nën' e mjerë,
kërkon vatrën edhe nderë,
do lirinë dhe atdhenë,
si ç'e pat me Skënderbenë,³⁾
bijt' e besës thërret pranë.

*) Është një nga vjershat më të hershme të Nolit, shkruar më 1917. Në këtë vit shoqëria «Vatra» e shqiptarëve të Amerikës hapi një fushatë për shpëtimin e Shqipërisë nga elementët antikombëtarë e sidomos për t'i ardhur në ndihmë popullsisë së krahinave të dëmtuara nga veprimet e forcave ndërluftuese. Vjersha është hartuar në formën e një kërkesë prekëse që poeti u drejton bashkatdhetarëve për të mos kursyer për «nënën e mjerë», për Shqipërinë, dhe dëshmon edhe një herë për një nga tiparet dalluese të poezisë së Nolit, që u bën jehonë ngjarjeve të rëndësishme politike të kombit. E gjithë vjersha është ndërtuar me vargje 8-rrokëshe, me strofa me 8 vargje, me rimë të puthur. Dy vargjet e fundit përdoren si refren pas çdo strofe.

kur i thirri dhe s'i vanë?⁴⁾
Mbahu, Nëno, mos kij frikë etj.

Cilët jan' ata tiranë
që të pren' e që të vranë
që të therë bij e bija,
dhe t'u nxi, t'u mbyll shtëpia?⁵⁾
Derdhni plumba, o Shqiptarë,
gjak'n e Nënës, për të marrë!
Mbahu, Nëno, mos kij frikë etj.

Cilët bij të tradhëtuan
dhe të doqnë dhe të shuan
dhe të lan', o Shkab' e ngratë
pa fole, pa zoq, pa shpatë?⁶⁾
Këta qena, o shok' i mbytni,
mbushni gjyle që t'i shtypni!⁷⁾

Mbahu, Nëno, moj kij frikë etj.
Sa kërkon e sa të duhen?
Burrat nga detyra s'ndruhen!
Trim' i mirë do të japë,
s'kursen jetën as paratë,
hidhni, hidhni tok dollarë,
të mos mbetemi të sharë!⁸⁾
Mbahu, Nëno, mos kij frikë etj.

Do të ndihim pa kursyer
për ty, Nëna jon' e vyer,
që me drit' e nder të thuresh
dhe me bijt' e tu të mburresh.
Cila Nënë lyp paranë?
Cilët bij me shpirt s'i dhanë?
Mbahu, Nëno, mos kij frikë etj.

Armë dhe fishekë mblidhni,
gesen edhe shpirtin hidhni:
Për lirin' e vendit tonë,
sot — se nesër është vonë;

jepni, Nënë ta shpëtoni,
komb e vatra të nderoni!⁹⁾
Mbahu, Nëno, mos kij frikë etj.

1. Reaksioni i brendshëm dhe shkelësit e huaj e kanë katan-disur si njeri të pa zot. Në këto vargje duket qartë karakteri agjitativ që do ta përshkojë të gjithë poezinë.

2. Vini re kufizimin ideor të Nolit që mbivlerësonte rolin e shqiptarëve të mërguar në Amerikë.

3. Në vazhden e ideve të patriotëve të mëdhenj të Rilindjes, Noli evokon të kaluarën e lavdishme të Shqipërisë, «**motin e madh**» siç e quajnë arbëreshët e Italisë kohën e Skënderbeut. Njëpërmjet kontrastit të fatkeqësive që i kanë rënë mbi krye Atdheut dhe lavdisë së tij në kohën e Skënderbeut, Noli do t'i prekë në sedër bashkatdhetarët, që të mos kursejnë asgjë për t'ua rikthyer ato siç i pati me Skënderbenë. (Kujtoni me këtë rast se si e përshkruan Pashko Vasa në poezinë «O moj Shqipni» gjendjen e Shqipërisë nën pushtimin shumëshekullor osman.

4. Poeti duke bërë pyetje retorike nuk pret ndonjë përgjigje; por e përdor atë sa për t'i dhënë ligjëratës një ton më bindës, më të fuqishëm e më emocional.

5. Njëpërmjet këtyre vargjeve Noli akuzon elementët antikom-bëtarë me Esat Pashë Toptanin në krye etj. që e çuan shtetin e porsalindur shqiptar në buzë të greminës, duke bërë kështu pluhur e hi ëndrrën shumëshekullore të popullit për liri e pa-varësi. Vini re sa bukur autori përdor shprehjet popullore «**t'u nxi**», «**t'u mbyll shtëpia**» për të treguar gjendjen e rëndë të Shqipërisë sidomos në vitet 1914-1915.

6. Mllafi i urrejtjes ndaj tradhtarëve, ndaj elementëve anti-kombëtarë vjen gjithmonë e duke u rritur.

7. Ide mjaft e përparuar e autorit, por që ai vetë nuk e zbatoi në jetë, kur erdhi në krye të qeverisë që doli nga Revolucioni i Qershorit.

8. **Të mos mbetemi të sharë**, d.m.th: të mos mbetemi të tur-përuar, sepse nuk kemi plotësuar detyrën ndaj atdheut, nën-kuptohet, të jemi kryelartë si gjithmonë.

9. Strofa e fundit shpreh jo vetëm optimizmin e autorit që bashkatdhetarët e mërguar do ta përmbushin detyrën ndaj Shqipërisë, por është njëkohësisht edhe një thirrje luftarake, një grishje për luftë të papajtuar kundër reaksionit feudal për shpëtimin e vendit.

Moisiu në mal*

Ngjitet përpjetë malit të shkretë
kryeprofeti trimi me fletë,¹⁾
të bisedojë me perëndinë
për Palestinë.²⁾

Arrin në majë³⁾ lart i kapitur,
qëndron me frikë, pret i tronditur,
dhe Jehovah, i flet prej një reje
me zë rrufeje:

«Ti dhe të tjerët pleq do të ngelni,
tokën e shenjtë kurrë s'e shkëlmi

*) Vjersha «Moisiu në mal», shkruar në janar të 1930-ës, është botuar për herë të parë në «Lirinë Kombëtare» më 27 janar 1930 me këtë shënim: «Sipas biblës, Moisiu, që i çliroi izraelitët nga zgjedha egjiptiane nuk mundi të shkëlë tokën e Atdheut të lirë. E pa vetëm për së largu nga maja e një mali; përpara se të vdiste në shkretëtirën e Arabisë».

Nëpërmjet këtij simboli të marrë nga bibla, Noli shpreh në mënyrë alegorike përpjekjet e veta për çlirimin e popullit shqiptar, idealet dhe luftën e tij, botën e tij të brendshme, iluzionet dhe deziluzionet e veta në çaste të ndryshme historike, në etapa të veçanta të jetës së tij.

Sipas biblës, Moisiu kishte lindur në Egjipt, ku populli i tij, i emigruar në ato anë, jetonte në robëri. Ai sheh vuajtjet e panumërta që heq populli dhe vendos që ta çlirojë nga robëria, ta kthejë dhe ta rivendosë në atdheun e tij. Prandaj vihet në krye të izraelitëve, i nxjerr këta nga Egjipti dhe nis për në «Tokën e premtuar», duke ecur nëpër shkretëtirat e Arabisë. Udha është e gjatë, plot vuajtje, mungon streha, ujë, ushqimet etj.

skllevër, bij-skllëvrish, s'e meritoni
se liri s'doni!
Kryeprofitit dita i ngryset,
dhe shpirtkëputur përdhe përmbysset
me lot në sy, me zemër të ngrirë
i lyp mëshirë.

Pse kaqë gjatë, Zot, m'arratise,
pse më përplase, më përpëlise,
pse shpresën dyzet vjet m'a ushqeve,⁴⁾
dhe sot ma preve?

«Nëm Dhen' e Lirë⁵⁾! Zot, ku ma ke?»
«Shiko, i tha dhe ja ku e pe.»
Së largu, Zoti ia pasqyron,
dhe e shikon.

Përballë këtyre vuajtjeve, shumë nga krerët dhe mjaft njerëz nga populli izraelit dëshpërohen dhe ngrenë krye edhe kundër Moisiut. Ata duan të kthehen prapa, duke pranuar që të hyjnë përsëri nën zgjedhën e robërisë së huaj. Të tjerë duan që të shkëputen nga shumica dhe të çajnë ndonjë rrugë më vete, të dalin ku të dalin. Por të gjithë i mban të bashkuar dora e fortë e udhëheqësit, e Moisiut, i cili mundohet t'i bindë se do t'i shpjerë në tokën e premtuar.

Ka çaste që përballë këtyre vështirësive dhe pengesave të paparashikuara e të pamenduara edhe vetë Moisiu lëkundet, humbet shpresën, humbet besimin se do t'ia dalë në krye detyrës, që ka marrë përsipër. Pikërisht për këto luhatje, për këtë dëshpërim të përkohshëm, Jehovah, Perëndia e izraelitëve, e dënon Moisinë që të mos arrijë të shkelë tokën e premtuar, por ta shohë atë vetëm nga larg dhe pastaj të vdesë në majë të Malit të thatë, të zhveshur dhe të pabanuar, Nebo.

Vjersha ka nota të theksuara autobiografike. Në fillim të viteve 20, Noli u vu në krye të forcave përparimtare të vendit që luftonin për ta çliruar popullin nga prangat e skllavërisë shekullore feudale. Dita e bekuar e marshimit drejt Palestinës, tokës së premtuar erdhi, kur shpërtheu vullkani antifeydal dhe triumfoi Revolucioni Demokratik i Qershorit. Por shpejt ky revolucion u shtyp nga forcat kundërrevolucionare të Ahmet Zogut të përkrahura nga reaksioni ndërkombehtar dhe Noli mori rrugët e mërgimit.

Ja Nazareti, ja Bethlehemi,
lum' i Jordanit, Jerusalemi,
mal' i Sionës, Bethsaidaja,
dhe Golgothaja,⁶⁾

sheh gasn' e pritmë për djalërinë⁷⁾
dhe shkretëtirën për pleqërinë,
atje sa bukur, këtu sa zi,

o Moisi.

Këtej ka dimrin, andej pranverën,
kërkon parajsën, vdes në Skëtërrën;⁸⁾
ajme⁹⁾, sa vrer, sa keq e sa zor,
liberator!¹⁰⁾

1. **Kryeprofeti; trimi me fletë** — Është fjala për Moisinë. Noli i vë epitetin «trimi me fletë» sepse luftoi që të çlironte popullin izraelit nga zgjedha e Egjiptit.

2. **Për Palestinë** — Një pjesë toke që shtrihet nga bregu i detit Mesdhe, deri në brigjet e Detit të Vdekur.

3. **Në majë** — Në majë të Malit Nebo.

4. **Pse shpresën dyzet vjet më ushqeve** — Sipas biblës, Moisiu jetoi 40 vjet në Egjipt.

5. **Nëm dhen' e lirë** — Më jep tokën, Atdheun e lirë. Këtë shprehje Noli e përdor me kuptim alegorik. «Më jep Shqipërinë, Atdheun, por jo kështu siç është, por të çliruar».

6. **Ja Nazareti..:** etj. Në këtë strofë poeti rreshton vende, lumenj dhe qytete të Palestinës së moçme. Këto qytete janë ndërtuar shumë kohë pas Moisiut, janë një vegim i shekujve të ardhshëm.

7. **Sheh gasn' e pritmë për djalërinë** etj. — Në këtë strofë alegorike kemi një pamje të «Tokës së premtuar» të Atdheut, që do ta gëzojë djalëria, brezi tjetër, kurse pleqëria dhe vetë kryeprofeti, nuk do ta gëzojnë dot. Fjala «e pritme» ka kuptimin «e ardhshme».

8. **Vini re antitezat e goditura që përdor Noli.**

9. **ajme** — vaj, medet, sa keq, mjerisht.

10. **liberator** — çlirimtar.

Marshi i krishtit*

Hosanna,¹⁾ o çlironjës, Mesi,²⁾ hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,
brohoritni trumbeta, timpane, zurna,³⁾
thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!

Kryetrim, që lëfton, triumfon për atdhe,
shpëtimtar, kryemjek, kryeshenj, kryefe,
pasuri, dhe liri, dhe fuqi ti na dhe,
lum e lum, Galile⁴⁾. Hosanna, hosanna!

O i bir' i Davidit⁵⁾, i miri Bari,
ti na prin dhe na rrit në luath e vërrin
ti na ruan, dhe na mbron, dhe për ne bëhesh fli,
o Njeri-Perëndi: Hosanna, hosanna!

*) Është një poezi hymnizuese për çliruesin, ku nëpërmjet simboleve që merr nga bibla, autori shpreh aspekte të jetës politike e sidomos autobiografike, që lidhen me ngjarjet e viteve '20 në Shqipëri. Në epigëndër të poezisë është «çlirimtari», «shpëtimtari» i masave. Vetëkuptohet Noli bën aluzion për veten e tij kur ishte në krye të forcave demokratike, të cilat e adhurojnë, e himnizojnë, sepse u jep liri, pasuri, fuqi, dhe i mbron e për ta bëhet fli etj. Nga mënyra se si është shkruar vjersha, nga adhurimi që kanë masat për çliruesin, nga mënyra se si paraqiten masat (si «turma të dehura, të droguara») përvijohet qartë mendimi i Nolit për rolin e heroit, të cilin e mbivlerëson, kurse masat i quan turma që e ndjekin pas në mënyrë të verbër. Ky kufizim ideor i autorit, është ndikim i filozofisë idealiste që mbivlerëson rolin e individit.

Përmi Dhe, përmi Fron, përmi Qiell u bekofsh,
përmi djall dhe tiran, përmi Ferr mbretërofsh,
me pean, dhe temjan, dhe këmban'u këndofsh,
drit' e gas, rrofsh e qofsh: Hosanna, hosanna!

O i fort', o i urt', o i ëmbel' Jesu⁶⁾
Plot me bes' e me shpresë të biem mbi gju,
T'adhurojmë me zemër këtu e tehu,
Gjithëkunt e pa funt: Hosanna, hossana!

Hosanna, o çlironjës, Mesi, hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,
Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,
Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!⁷⁾

1. **Hosanna** — lutje që përdoret në faktore, thirrje ngazëllimi.

2. **Mesi** — sipas fesë hebraishte njeri-perëndi, profet ose çdo personalitet i konsoliduar, që është përpjekur për popullin, (në fenë kristiane) Krishti. Noli e përdor në kuptimin e çliruesit të popullit, të masave, duke bërë këtu ndoshta edhe aluzion për veten e vet.

3. **zurna** — vegël muzikore fryme, curle

4. **Galile** — krahinë e Palestinës nga thuhet se kishte prejardhjen Krishti.

5. **Davidi** — Mbreti i Izraelit në vitet 1000-972 para epokës sonë. Thuhet se me origjinë ka qenë bari dhe qetësonte mbretin Saul (paraardhësi i tij) me muzikën e tij të bukur.

6) **Jesu** — Jesu Krishti

7) Siç shikohet e gjithë poezia është një himn për çliruesin, për heroin, për individin.

Krishti me kamxhikun*)

Në kështjellë t'atdheut, në tempull të fesë¹⁾
janë shtruar sarafët²⁾ pa shpirt e pa besë,³⁾
tregëtojn' e gënjejnë, rrëmbejn' e sfrutojnë,⁴⁾...
«Thon' ashtu Izraelin⁵⁾ e mbrojn, e shpëtojnë.

*) Poezia ka kuptim të qartë simbolik. Motivin fetar Fan Noli e kthen nëpërmjet kësaj poezie në motiv politik. Të gjitha figurat dhe veprimet e huajtura nga bibla përdoren si metafora për të përshkruar ngjarjet e Shqipërisë në vitet 1920-1924.

Në këtë poezi, në personin e Krishtit fshihen ata demokratë të asaj kohe (midis tyre dhe Noli), që nuk mundën ta duronin më tej gjendjen e mjerë të atdheut dhe morën pjesë aktive në Revolucionin e Qershorit 1924.

Shën Pjetri simbolizon ata njerëz që mendonin se edhe pas ngjarjeve të qershorit 1924 duhej të ndiqej me vendosmëri rruga revolucionare, të përdorej dhuna kundër «sarafëve».

Por Noli, si udhëheqës i Revolucionit të Qershorit, nuk e pranoi këtë mendim. Ai nuk pranonte më 1924 se liria mund të rrënohej nëpërmjet dhunës, por vetëm nëpërmjet bindjes. Dhe, meqenëse Krishti, në këtë rast Noli, nuk e dëgjoi keshillën e Shën Pjetrit, por e hodhi kamxhikun, aty për aty kamxhikun e rrëmbyen «sarafët», domethënë qarqet reaksionare, dhe me kundërrevolucionin që bënë në dhjetor 1924 «shembën» siç dihet, «çliruesin», «fenë» (demokracinë) dhe «atdhenë» (Shqipërinë).

Duke na treguar nëpërmjet këtyre figurave mendimin e vet mbi arsyet e shembjes së Revolucionit të Qershorit, Noli bën autokritikë, dhe pranon se duhet vazhduar revolucionin, gjersa të çrrënohen krejtësisht «sarafët», armiqtë e popullit dhe të atdheut.

Shtrembërojnë kanunet, i marrin në dorë,⁶⁾
dhe shkëlqejnë në kish' e në fron me kurorë,⁷⁾
vegjësia për ta batërdisen dhe vriten
dhe kështu parazitët gjakpirës po rriten.

Tradhtari dinak, hipokrit e kusar⁸⁾
na u ngrit në kulm, dhe u bë kryetar;
nën zgjedhë besnikët⁹⁾ për vdekje lëngojnë,
se mëkat dhe mallkim kryengritjen kujtojnë.

Çdo i shenjt' ideal, çdo shtëpi perëndie¹⁰⁾
ishite bërë dyqan dhe pazar tregëtie.
Kush fitonte më tepër, ai ish usta,
dhe kush nuk plaçkiste, ish krejt budalla.

Kur e pa këtë zi dhe këtë errësirë,
Krisht' i ëmbël u ndez dhe u bë i vështirë:
Me kamxhik e me fshikull sarafët i dboi,
dhe nga larot gjakpirës atdhen' e shpëtoi.¹¹⁾

Dhe shën Pjetri' gëzuar ahëre i tha:
«Ja tani e ke nisur tamam, or usta!
me kërbaç e me shpatë mbi ne mbretëro,
dhe me forc' e pahir na çliro, na shpëto».

«Je gabuar, o Krisht, që u ke predikuar,¹²⁾
se të marrët, të shurdhërit s'kanë dëgjuar;
ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin,
se shpirtrobi s'çlirohet askurrë pa drurin».

Jesu Krishti s'dëgjoji dhe s'e mori vesh mikun,
dhe me lot i penduar e hodhi kamxhikun,
dhe i tha: «S'e ka fajin kurrizi, po truri,
se lirin' e sjell drita e mendjes, jo druri.»¹³⁾

«Merre prapë kamxhikun, — shën Pjetri u përgjigj,
— se përndryshe kjo punë na del mos më keq.
Përkëdhelu kurrizin dhe do t'të besojnë,
vrëjti, shtypi dhe shtrydhi, dhe do t'adhurojnë.»¹⁴⁾

Jesu Krishti s'dëgjoi, dhe s'e mori vesh mikun.
Dhe s'u ul përsëri që ta merrte kamxhikun;
dhe e kapën kamxhikun sarafët për fenë,¹⁵⁾
dhe e shembën çlironjësin, fen' e atdhenë.

1. **Në kështjellë t'atdheut, në tempull të fesë** — Është fjala për kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranën, dhe për parlamentin, qeverinë, organet e shtetit të kohës së Zogut.

2. **Janë shtuar sarafët** — Në kuptimin e drejtpërdrejtë, «sarafët» do të thotë shkëmbyes të hollash. Këtu kuptohen afaristët, dallaveraxhinjtë, shfrytëzuesit.

3. **pa shpirt e pa besë** — shfrytëzues të pamëshirshëm, pa ndërgjegje, pa ndjenjë atdhetarie.

4. **sfrutojnë** — shfrytëzojnë

5. **Izraelin** — këtu: atdheun

6. **i marrin në dorë** — i shkelin, i marrin nëpër këmbë

7. **shkëlqejnë në kish' e në fron me kurorë** — kapardisen në ofiqe të larta, mburren.

8. **Tradhtari dinak, hipokrit e kusar** — Bëhet aluzion për Ahmet Zogun. Noli e quan A. Zokun *dinak*, sepse ky në fillim ishte rreshtuar në Partinë Popullore, ku bënte pjesë edhe Noli me shokët e vet, po këtë punë Zogu e kishte bërë me qëllim që të tregohet se gjoja ishte demokrat; e quan *hipokrit*, sepse ndonëse fliste për demokracinë, ishte lidhur fshehurazi me bejlerët dhe bajraktarët; e quan *kusar*, sepse postin e kryeministrit e kishte rrëmbyer më 1922 me veprime prapa krahëve, me manevra kusari dhe përdori pozitën shtetërore për të plaçkitur vendin.

9. **besnikët** — populli, vegjëlia

10. **çdo shtëpi perëndie** — çdo organ shtetëror, çdo zyrë shtetërore e kohës së Zogut (Vini re ironinë e Nolit).

11. **Me kamxhik e me fshikull etj.** — Këtu nënkuptohet Revolucioni i Qershorit 1924, që e dëboi Zogun bashkë me klikën e tij.

12. **u ke predikuar** — u ke mbajtur fjalime, u ke dhënë këshilla.

13. **Se lirin' sjell drita e mendjes.** — Sipas Krishtit në këtë vjershë, lirinë e sjell arsimit dhe kultura, njohja e së vërtetës.

14. **Merre prapë kamxhikun etj.** — Vazhdoje revolucionin gjer në fund, gjersa të çrrënjosen krejtësisht feudalët. Tërë kjo strofë ka kuptimin: armatosu, mbaj shpatën gati, vigjëlo, godit ata që përgatiten të të përmbysin; të të godasin.

15. **Dhe e kapën kamxhikun sarafët etj.** — Atë që s'deshi të bënte qeveria e qershorit, e bëri reaksioni zogist, i cili e rrëmbeu kamxhikun, domethënë përdori dhunën, dhe e përmbysi regjimin demokratik të qershorit.

Shën Pjetri në mangall*)

Fryn e shfryn veriu,¹⁾
ngrin, mërdhin i ziu
dhe mangallit i afrohet
që të ngrohet.

Krishtin brenda e gjykojnë²⁾
dhe pas ligjës e dënojnë,
e goditin dhe e shtyjnë,
e pështyjnë.

*) Poezinë satirike «Shën Pjetri në mangall» Noli e shkroi në janar të 1930-ës dhe e botoi për herë të parë në «Lirinë Kombëtare» më 21 shkurt 1930. Botimin e saj e shoqëroi me një shënim ku thuhet se Krishti i paralajmëron apostujt (pasuesit, dishepujt e tij) se në orën e vështirë ata do ta neveritin dhe se i pari i tyre, Pjetri, do ta mohojë tri herë para se të gdhihet. Ky e ndjeu veten të fyer (Pjetri) dhe bëri be e rrufe se nuk do ta mohojë e nuk do ta braktisë, por nuk e mbajti dot fjalën, sepse atë natë bënte shumë ftohtë «frynte e shfrynte veriu», ai mërdhinte dhe «duhej doemos të ngrohej në zjarrin që kishin ndezur shërbëtorët e gjykatores në oborr».

Revolucioni i Qershorit, i udhëhequr nga Noli, ishte një ngjarje e madhe historike dhe fitorja e tij një ngjarje e shënuar e forcave demokratike. Revolucionin kërkonte që pjesëmarrësit t'u qëndronin besnikë e të vendosur idealeve që i frymëzuan kur rrëmbyen armët dhe përmbysën pushtetin reaksionar të bejlerëve, që kishin në krye Ahmet Zogun. Në ditët entuziaste të revolucionit pati nga ata bashkëpunëtorë të Nolit që u betuan se do t'u qëndronin besnikë deri në fund idealeve të revolucionit dhe do të luftonin për realizimin e programit që kishte hartuar Noli si kryetar i qeverisë revolucionare.

S'del askush që ta shpëtojë,
Roma do ta kryqëzojë,³⁾
triumfon Legaliteti⁴⁾
dhe Laneti⁵⁾

Kur e rrahin dhe e tallin
Pjetri ngulet mbi mangallin;
kur e pa, u — koll këndesi⁶⁾
nga qymezi.

Dhe një shërbëtores i tha:
— «Je dhe ti një nga ata!»
po shën Pjetri proteston⁷⁾,
e mohon.

Kruspull mbi mangallin mblidhet,
po djek dorën dhe përdridhet;
se ç'këndon bandill këndesi
nga qymezi:

«S'ka e s'ka si heroizma,⁸⁾
edhe si idealizma,
po kur dimër del behari
s'ka si zjarri.»

— «Nga ata je!» — thot' ajo,
e mohon shën Pjetri: — «Jo!
As e njoh, as e kam parë,
moj e marrë!»

Por ç'ndodhi në të vërtetë? Pas dështimit të revolucionit dhe pas «triumfit të legalitetit», pati nga ata bashkëpunëtorë të Nolit që «u lëkundën» deri në atë shkallë sa mohuan plotësisht idealet e revolucionit për të shpëtuar nga akuzat dhe ndjekjet e klikës zogiste. Përmes figurës së Shën Pjetrit (të marrë nga Bibla) hipokrit dhe renegat, autori godet atë kategori njerëzish që tradhtuan idealet e revolucionit dhe u tërhoqën me turp në vetvete (buxhak). Kjo përbën thelbin e poezisë satirike «Shën Pjetri në mangall», ku Krishti personifikon vetë poetin.

Kruspull mbi mangallin mblidhet
po djek mjekrën dhe përdridhet;⁹⁾
se ç'këndon bandill këndesi
nga qymezi:

«Shkab' e shkëmb me poz' e fjalë,
se ç'na dole shkumb e galë,
në je trim këtu tregoje,
shko shpëtoje.»

Thot'ajo: — «Je, mos gënje!»
Pjetri e mohon me be:
— «Jo, për zotin, moj aman,
s'jam e s'jam.»

Kruspull mi mangallin mblidhet,
po djek gjuhën dhe përdridhet;¹⁰⁾
se ç'këndon bandill këndesi
nga qymezi:

— «Simon Pjetër, Bar Jona,¹¹⁾
kështu ndahet kjo dynja:
Kryqi andej, këtej buxhaku¹²⁾
dhe allçaku».

Se ç'e dogje, se ç'e fike,
gjel me gjëmb' e këng' armike,
dhe ndërgjegjen se ç'ia shpove,
se ç'ia zgjove.

Se ç'vajton shën Pjetri hidhur,
leshleshuar, duarlidhur,
tri her' e mohoj pa gdhirë,
faqenixirë.

1. Fryn e shfryn veriu — Ky varg ka kuptim kryesisht alegorik dhe do të thotë: «reaksioni bën kërdinë, vret e pret».

2. Krishtin brenda e gjykojnë etj. — Klika e Zogut që erdhi në fuqi pas dështimit të Revolucionit (dhjetor 1924), hapi

gjiqje e ngriti padije për të dënuar e masakruar të gjithë ata që kishin marrë pjesë në Revolucionin e Qershorit ose që e kishin ndihnuar dhe simpatizuar atë. Gjiqje të tilla u hapën edhe për ata që mbetën në Shqipëri, edhe për ata që ishin mërguar. Madje një ndër ata që u dënuar nga këto gjiqje, ishte dhe vetë Noli. Në kuptimin e përgjithshëm në këtë strofë është fjala për gjykimin dhe dënimin e idealeve të lëvizjes popullore të qershorit 1924, që solli në fuqi Qeverinë Demokratike që kryesohej nga Noli.

3. **Roma do ta kryqëzojë** — Nëpërmjet këtij vargu Noli jo vetëm që denoncon përkrahësit e kundërrevolucionit, reaksionin ndërkombëtar, por bën aluzion edhe për Italinë fashiste me të cilën Zogu u lidh këmbë e kokë pasi erdhi në fuqi derisa ia shiti vendin asaj.

4. **Triumfon Legaliteti** — Noli satirizon regjimin satrap të Zogut, duke përdorur fjalët e tij. Zogu, pasi erdhi në fuqi, e shpalli regjimin e tij «Triumf të Legalitetit», d.m.th., triumf të ligjshmërisë», të asaj që ishte e ligjshme, duke bërë iluzion se Qeveria Demokratike që kryesohej nga Noli ishte e paligjshme.

5. **Laneti** — Fjalë arabisht dhe do të thotë «djalli», «shejtani», «i mallëkuari», «dreqi», «i paudhi». Kështu quan Noli në këtë poezi Ahmet Zogun.

6. **U koll këndesi** — Është shprehje metaforike dhe përdoret në vend të fjalisë këndo i këndesi.

7. **Proteston** — Nuk pranon, e kundërshton, e mohon me forcë.

8. **S'ka e s'ka si heroizma etj.** — Noli vë në lojë ata që ishin betuar se do t'u qëndronin besnikë idealeve të Revolucionit Demokratik të Qershorit, por që në të vërtetë, pas dështimit të tij dhe ardhjes në fuqi të reaksionit, nuk i bënë dot ballë shtrëngesës së xhandarëve të Zogut, sepse idealet e tyre ishin «falso», s'kishin bindje, i kishte marrë me vete «rryma» etj.

9. **Po djek mjekrrën dhe përdridhet.** — Vini re shkallëzimin që përdor Noli për të treguar veprimet (tërheqjen nga idealet) e shën Pjetrit. Në fillim shën Pjetri ngrohte vetëm duart, kurse tani «me acarimin e dimrit» (kupto: me forcimin e reaksionit zogollian), po i afron mangallit edhe mjekrrën, fytyrën etj., d.m.th. «po futet i gjithë në mangall».

10. **Po djek gjuhën dhe përdridhet** — Vargu ka kuptim të figurshëm dhe do të thotë se po mohon të gjitha ato që ka thënë dikur.

11. **Simon Pjetër, Bar Jona** — Emri i mëparshëm i Pjetrit kishte qenë Simon. «Bar Jona» do të thotë i biri i Jona-it».

12. **Kryqi andej, këndeje buxhaku** — Këtu fjala «kryq» ka kuptimin e vuajtjeve për qëllime të larta fisnike, për idealin (nga kryqi ku u kryqëzua Krishti sipas biblës), kurse «buxhaku»

qoshe e ngrohtë, skutë për të fshehur kokën, d.m.th. vendi ku struket dhe fshihet frikacaku në kohë rreziku. Me këto vargje Noli do të thotë se revolucionin kërkon sakrifica, ata që qëndruan me revolucionin hiqnin e vuanin, vriteshin e priteshin. mërgoheshin etj., kurse ata që mohonin revolucionin dhe i nënshtroheshin reaksionit jetonin në «qetësi» (të paktën), ose përfitonin prej tij, por mbuloheshin me turp, ishin allçakë (të poshtër, pa parime etj.)

Marshi i Barabajt^{*)}

Allalla, o rezil¹⁾ e katil²⁾, allalla,
Shtroni udhën me hidhr³⁾ e me shtog turfanda,³⁾
Gumëzhi,⁴⁾ o zinxhir o kamxhik; batërma,
Lehni, laro,⁵⁾ kaba⁶⁾: Hosanna,⁷⁾ Barabba!

Tradhtar, ti na nxive, na le pa atdhe,⁸⁾
ti na shthure, na shkule, na zhduke çdo fe,⁹⁾
varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,
derbeder,¹⁰⁾ ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit,¹¹⁾ teptil si bari,¹²⁾
ti na shtyp e na shtrydh e ti gjakun na pi,
ti na therr e na grin për qejf na bën fli;
o kukudh¹³⁾ e lubi. Hosanna, Barabba!

*) Kjo satirë e rreptë antizogiste është shkruar në nëntor të vitit 1927.

Fytyra e saj qëndrore, Barabaj, është huazuar nga bibla, por është përdorur në një kuptim politik. Ajo simbolizon shtypësin, dhunuesin dhe vrasësin.

Alegoria që përdor Noli në këtë poezi, kuptohet lehtë: në këtë rast Barabaj është kusari, rebeli, tradhtari dhe vrasësi Ahmet Zogu, Larot, domethënë të poshtrit, dallkawkët, kopukët, janë njerëzit e klikës së Zogut: ministrat, senatorët dhe deputetët e tij, të cilët krahasohen me qena të ndarë, që, të shtyrë nga interesat e tyre të ulta, zgjodhën si udhëheqës tradhtarin e atdheut, vrasësin e patriotëve.

«Marshi i Barabajt» do të thotë «marshi i vrasësit», i tradhtarit». Kundër këtij tradhtari dhe klikës së tij shpërthen në këtë satirë, me një forcë të papërmbajtur, tërë urrejtja e Nolit demokrat.

Në bodrum, nëpër lloj' e kufom' u mallkofsh,
në skëtërrën, katran e tيران, u harbofsh,
me tam-tam¹⁴⁾ e alarm¹⁵⁾ e me nëm¹⁶⁾ u shurdhofsh.
Në zëndan¹⁷⁾ mbretërofsh: Hosanna, Barabba!

O i zhgryer,¹⁸⁾ i zhyer,¹⁹⁾ i vyer për hu²⁰⁾
turp-e-ndot-kundërmonjës,²¹⁾ të krrusen mbi gju
dallkawkët,²²⁾ kopukët²³⁾ e turmat pa tru,
zemër-krund-e-gërdhu²⁴⁾ Hosanna, Barabba!

Allalla, o rezil e katil, allalla,
shtroni udhën me hithër e me shtog turfanda,
gumëzhi o zinxhir e kamxhik, baterma,
lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

1. **rezil** — i poshtër, i fëlliqur, pa cipë

2. **katil** — vrasës, gjakatar

3. **turfanda** — i freskët, i njomë. Këtu do të thotë: mos shtroni udhën me dafina lavdie dhe me lule të bukura, siç u ka hije çlirimtarëve, por me hithra të freskëta, që djegin, dhe me shtog të njomë, që mban erë të keqe; sepse kështu e meriton katili — Ahmet Zogu.

4. **gumëzhi** — këtu ka kuptimin: kërcit, zhurmo.

5. **laro** — qena; këtu: të poshtër, të paudhë.

6. **kaba** — i trashë, i pagdhendur

Vargu: «Lehni, laro, kaba»; do të thotë: «Lehni, qena, me zë të trashë».

7. **hosanna** (hebraisht) — lutje, që këndohet në faltore, himn fetar, thirrme ngazëllimi; këtu përdoret me ironi.

8. **na le pa atdhe** — na e shite atdheun.

9. **Ti na shture, na shkule, na zhduke çdo fe** — Fjala «fe» është përdorur këtu në kuptimin «ideal adhetar». Po këtë fjalë e ka përdorur Fan Noli edhe në elegjinë «Shpell' e Dragobisë» dhe i ka dhënë vetë një shpjegim të tillë.

10. **derbeder** — vagabond, horr

11. **Kain** — Sipas një legjende të Biblës, Kaini, i biri i Adamit, vrau të vëllanë, Abelin, nga zilia dhe ligësia. Këtu emri «Kain» ka kuptimin gjakatar, vrasës, vëllavrasës.

12. **teptil si bari** — që shtiret si bari, që paraqitet sikur është bari. Këtu ka kuptimin: «ti që shtiresh si mbrojtës i popullit», me fjalë të tjera «ti, ujk në lëkurë qengji».

13. **kokudh** — kukudh, lugat

14. **tam-tam** — vegël muzikore: një pllakë metali e rrumbullakët, varur pingul dhe që goditet me çekan, për të bërë zhurmë të madhe.

15. **alarm** — këtu: bujë e madhe, zhurmë shurdhuese,
16. **nëmë** — mallkim
17. **zëndan** — burg, skëterrë
18. **i zhgryer** — që bie përtokë, perpëlitet e ndyhet me pluhur e baltë. Këtu ka kuptimin i zhgryer në ndyrësi, në tradhti
19. **i zhyer** — i zhytur në baltë, i lerosur. Këtu ka kuptimin i zhytur në tradhti e gjak.
20. **i vyer për hu** — që meriton të vihesh në hu (dënim që u jepej dikur tradhtarëve, vrasësve, njerëzve të ligj).
21. **turp-e-ndot-kundërmonjës** — ai që kundërmon turp e ndyrësi.
22. **dalkauk** — lajkatar i ndyrë, lajkatar hipokrit. Këtu goditen politikanët hipokritë, që e lavdëronin dhe i bënin lajka Zogut.
23. **kopuk** — vagabond, aventurier, imoral
24. **zemër-krund-e-gërdhu** — zemërndyrë, zemërqen. Fjala «gërdhu» do të thotë gëzhutë, mbeturinë nga të shoshurat e drithit.

Marshi i kryqësimit*)

Do t' të vrasim, Jesu, se të kemi Baba,
do t' të varrim, Mesi,¹⁾ se të kemi Usta,²⁾
se s'ke dashur as jet', as martes', as para:
kryqësoje, Pilat,³⁾ në Kalvar,⁴⁾ Golgotha!⁵⁾

Dy kusarë të vegjël i zumë në lak.
Kryqësoji këta, se na vothnë fort pak,
kryqësoje këtë, se s'na vodhi aspak:
kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

Vrajeni, se përunj dhe përmbys⁶⁾ pasurinë,
pasuron, dhe çliron, dhe forcon varfërinë,⁷⁾
se lëngatën shëron,⁸⁾ se ndriçon verbërinë:
kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

*) Është një poezi me nota të theksuara satirike, ndoshta më të fuqishmet e kësaj gjinie në letërsinë tonë. Në mjaft drejtime afrohet me poezinë «Krishti me kamzhikun». Edhe këtu alegoria biblike përdoret për të shprehur aspekte të jetës politike, madje në një masë të madhe, aspekte nga vetë jeta e Nolit. Në epiqëndër vihet figura e shpëtimtarit të masave, dhe për çudi këtij njeriu që e kanë baba çlironjës (Mesi), usta etj, i japin atë dënim që do ta meritonte një shtypës, tiran, tradhtar etj. Në mjaft aspekte poezia ka elemente autobiografike. Noli duket sikur bën autokritikë kur thotë se «s'do... as gjakun ta marrë» ose «...s'do as të vrasë, as të vrarë» etj: d.m.th. që mohon përdorimin e dhunës revolucionare për të arritur fitore ose për të mbrojtur fitoret e arritura. Këtë qëndrim mbajti dhe vetë Noli pas fitores së Revolucionit të Qershorit dhe një dënim të ngjashëm vuajti (Zogu e dënoi me vdekje në mungesë).

Varreni, se me botën, me ne s'shëmbëllen,⁹⁾
se na ndreq shtrembëritë,¹⁰⁾ dhe kurrë s'na rreh,
se e do vegjëlin' e tiran' e urren:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

Vrajeni, se për vete s'kujdeset, s'lëfton,
dhe të mjerët, të humburit nuk i sfruton,¹¹⁾
dhe për sherr, për vllavrasje, për luftë s'punon:
kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

Vareni, posa s'do as të vras', as të varë,
as të bënë të keqen, as gjakun ta marrë,
dhe katilët me nam na i qanë si të marrë:¹²⁾
kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

Vrajeni kryengritësin e shenjtëruar
si katil të mallkuar, atë ka kërkuar,
se kujtoi që pa armë na ka për të zgjuar:¹³⁾
kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha!

-
1. Shiko shpiegimin te poezia «Marshi i Krishtit»
 2. **Usta**-mjeshtër, këtu në kuptimin udhëheqës
 3. **Pilat** — Pous Pilat — qeveritar romak në Judë (26-36 të erës sonë) që lejoi dënimin e Krishtit (kryqëzimin). me iithëse nuk ishte i bindur se kishtë bërë ndonjë krim, prandaj përpara «lau duart» në mënyrë simbolike.
 4. **Kalvar** — rruga e mundimshme që të shpie në Golgotha
 5. **Golgotha** — vendi, bregorja ku u bë kryqëzimi i Krishtit. Këtu përdoret me kuptim alegorik. Ky varg përsëritet në fund të çdo strofe.
 6. **Përmbys dhe përunj pasurinë** — nuk e vlerëson, e përbuz, e braktis pasurinë. Përdoret në kuptimin figurativ:
 7. **çliron dhe forcon varfërinë** — këtu: çliron dhe forcon të varfërit, vegjëlinë.
 8. **lëngatën shëron** — këtu: heq vuajtjen, çliron të varfërit nga vuajtja, mundimi.
 9. **me botën, me ne s'shëmbëllen** — d.m.th nuk është i neja-shëm me ta (nënkupto të shtypurit, shfrytëzuesit, tiranët).
 10. **se na ndreq shtrembëritë** — se ndreq padrejtësitë
 11. **nuk i sfruton** — nuk i shfrytëzon

12. katilët me nam na i qan si të marrë — sikur ata janë bërë të tillë pa vetëdije, si të pavetëdijshëm, si viktima.

13. Në këtë varg më qartë se kudo jepet ideja themelore e vjershës. Ai që kujton se pa armë ka për të fituar..., kështu ka për ta pësuar, do të përfundojë në Golgotha, çka tingëllon jo vetëm si një këshillë, por më tepër si një autokritikë e Nolit për qëndrimin e tij të pavendosur si kryetar i qeverisë, që doli nga Revolucioni Demokratiko-borgjez i Qershorit.

Kirenari*

Ç'deshe ti, mor, në Kalvar!¹)
O qyqar, o Kirenar!²)
Del me poçen për sehir,
ndrit me Kryqin si martir.³)

Rent nëpër kallaballëk,
seç po ngjan, s'merr vesh as gëk,
je i pir' e s'mban dot anë
për çlironjës a tiranë.⁴)

Nëpër pluhur dhe shamatë
turren burrat, çirren gratë.

*) Vjershën «Kirenari» Noli e shkroi më 1925, kur ishte i mërguar në Vjenë dhe e botoi për herë të parë në gazetën «Dielli» të Bostonit më 1945. Ajo hyn në grupin e vjershave me motive biblike dhe me përmbajtje politiko-shoqërore. Trajton një temë të përafërt me vjershën «Shën Pjetri në mangall». Vjersha ka kuptim alegorik. Kirenari është më kompleks të Shën Pjetri. Ai përfaqëson atë kategori njerëzish që në udhëkryqet e historisë, midis revolucionit e kundërrevolucionit, mundohen të qëndrojnë asnjane. Kur e shohin se e drejta është me revolucionin, kalojnë në anën e tij, por s'janë nga ata që t'u bëjnë ballë vësh-tirësive e të sakrifikohen.

Në këtë poezi nëpërmjet figurës së Kirenarit, autori shpreh aspekte të jetës politike të viteve 1921-24, e veçanërisht të kohës së Revolucionit të Qershorit. Me këtë figurë Noli stigmatizon bashkudhëtarët e përkohshëm të këtij revolucionit, që u tërhoqën që në ndeshjen e parë me reaksionin zogist.

turm' e ndezur, e tërbuar,
Krishtin për të kryqëzuar.⁵⁾

«Mir' e gjeti», — tha sarafi —
se ashtu ia desh qylafi,⁶⁾
se po çvishte vegjëinë
Me uzurën dhe vergjinë.⁷⁾

Po kur pe që u gënjeve,
kryqëzimin s'e pëlqeve.
Kirenar, seç the një fjalë:
«Mos e vrisni këtë djalë!»⁸⁾

«Daleni, the, mor amani;
Oratorin mos e ngani,
si politikan flet n'erë,
po s'e bën më tjetër herë!»

Fare bukur e fillove,
po më kot e këshillove,
se katilët s'të sajdisnin,
si pjanik të qesëdisnin.

Dhe kur pe këto avaze
një dolli me verë zbraze
për të mbytur mallëngjimin,
për të shuar hidhërimin.⁹⁾

Po dollia të tronditi
dhe mi Krishtin të vërtiti,
të tre Kryqet i përfshive
dhe përdhe të gjith' i shtrive.¹⁰⁾

Ç'ngjau pasandaj s'kuptove
kryqin gjersa e zaptove,
dhe si krisht u kapardise
dhe në djers' u batërdise.¹¹⁾

Ç'vate shtrembër në Kalver
O qyqar, o Kirenar!
Seç përmbysesh, kamçikohesh,
rrihesh, ngrihesh, çdehesh, zgjohesh.

Krishtin me habi pyet:
«Nga më krisi ky tërmet?
Pse pa faj po më mundojnë,
kryqn' e huaj ç'ma ngarkojnë?»

Krishti po të ngushëllon
dhe durim të këshillon:
«Mos kij dert, se u bekovë,
me dolli lavdi fitovë!

Mos kij dert, mor Kirenar,
ta bën këngën një shqiptar!»
«Po ku është Shqipëria?»
«Tek ndes vetë perëndia!»

Bëj gajret, mor Kirenar,
drejt përpjet në Kalvar!
Për paradën që bën ti
çdo besnik të ka zili.¹²⁾

1. **Kalvar-i** — një lartësi e vogël, ku sipas biblës u mundua Krishti, rrugë e mundimshme për të arritur një qëllim, prandaj jo më kot e pyet Noli Kirenarin, se ç'deshi ai në këtë rrugë, se e njuh tipin e tij.

2. **Kirenar-i** — banor i Kirenës që ka qenë një qytet antik në Sirenaj të Libisë, themeluar më 631 para erës sonë nga kolonë grekë. Më vonë kaloi nën sundimin romak. Është qytet i dëgjuar për kulturën e tij të lashtë. Një nga monumentet e tij më të dëgjueshme është statuja e Afërditës së Kirenës (sh. III para erës sonë), që sot gjendet në muzeun e Romës.

3. **Del me poçen për sehër** etj. Një paralajmërim ky për fatin që e pret, për rrugën plot mundime që ai s'është i zoti ta përballojë.

4. E gjithë strofa bën fjalë për çoroditjen, hutimin e Kirenarit ca nga pija e ca nga kallaballëku «(turma) e që s'di nga t'ia mbajë.

5. Turma plot bujë e shamatë po shoqëron «kortezhin» që shkon të kryqëzojë Krishtin. Ajo është e **ndezur, e tërbuar, por e pavetëdijshme** për krimet që ka bërë Krishti, i cili si dhe në ndonjë poezi tjetër të Nolit përfaqëson çlironjësin, mbrojtësin e vegjëlisë, duke bërë kështu aluzion edhe për veten e vet. Me këtë turmë bashkohet edhe Kirenari.

6. Noli me mjeshtëri shfrytëzon frazeologjinë popullore, dhe duke vënë në gojën e Kirenarit shprehjen «**sipas kokës dhe qylafi**» (të përpunuar) shpreh solidarizimin, bashkimin e tij me turmën edhe pse nuk e di fajin për të cilin e dënojnë Krishtin.

7. **Se po çvishte vegjëlinë/ Me uzurën dhe vergjinë** — d.m.th. po çlironte vegjëlinë, masat punonjëse nga çdo lloj takse (**uzurë** — kamatë, fais; **vergi** — taksë për banesën e tij).

8. Mirëpo më vonë Kirenarit i del pija, vjen në vete dhe e shikon që është futur në një rrugë të gabuar, pendohet, e ndien që ishte i gënjer.

9. Para një gjendjeje të tillë Kirenari kthehet përsëri në rrugën e vjetër. Vini re ironinë e Nolit kundrejt karakterit të lëkundur të Kirenarit.

10. Kalon kështu sa nga një anë në tjetrën, duke u bërë një figurë tragjikomike...

11. E pas kësaj fillon «Kalvari» (rruga e mundimshme e Kirenarit). Sipas legjendës biblike, ushtarët romakë zunë një kirenar dhe i ngarkuan në shpinë kryqin që ta shpinte në Golgotha, në bregoren ku u kryqëzua Krishti, po rruga e mundimshme e lodhi.

12. Në 4 strofat e fundit, autori me keqardhje e me qesëndi jep gjendjen e çoroditur të kirenarit që **s'di se nga i erdhi kjo e keqe, që e mendojnë pa faj?...**, por s'merr asnjë përgjigje veç fjalëve të mira që e këshillojnë **të durojë e të bëjë gjajret...** Ka në këto vargje një notë të theksuar aktuale për kohën kur u shkrua vjersha, notë që tallet e stigmatizon bashkëudhëtarët e përkohshëm të Revolucionit të Qershorit të 1924, rënien e ngritjen e tyre, iluzionet e deziluzionet e borgjezisë shqiptare në kohën e revolucionit e të reaksionit që e pasoi.

Kënga* e Salep sulltanit¹⁾

Një mexhliz²⁾ të madh na çeli
Pandeli Jano Vangjeli³⁾
me sulltan-llokum na veli
si kofini pas të vjeli.

*) Pas kthimit në Shqipëri me bajonetat e huaja dhe pas përmbykses së qeverisë demokratike, Ahmet Zogu e shpalli Shqipërinë republikë dhe ai vet u shpall kryetar i kësaj republike me titullin «president i parë», në fakt sundimtar dhe diktator i Shqipërisë. Ai ndoqi, burgosi dhe vrau kundërshtarët e tij dhe hapi rrugën për të realizuar ambicjen e tij më të madhe: të shpallej mbret. Për këtë qëllim disa muaj më parë u hap një fushatë e shfrenuar propagandistike: prefektët, nënprefektët, kryetarët e bashkive dhe kryepleqtë e shumë katundeve kërkuan, me anë telegramesh, që Shqipëria të shpallej mbretëri dhe Ahmet Zogu të shpallej mbret. Pas kësaj përgatitjeje zhurmëmadhe, më 1 shtator 1928 u mbledh në Tiranë një «asamble» e ashtuquajtur «Konsistente» (kushtetuese), e përbërë nga «asamblistë» të caktuar me ndërhyrjen e çandarëve zogistë. Këta, sapo u hap seanca e parë, vrapuan kush e kush t'i bënte më shumë lajka Zogut.

Pikërisht kjo mbledhje përbën lëndën e vjershës «Kënga e Salep-Sulltanit». Këtë vjershë Noli e ka shkruar në Vjenë më 15 tetor 1928, dhe e botoi për herë të parë në gazetën «Liria kombëtare», në numrin e saj të jashtëzakonshëm të 28 Nëntorit 1928.

Vjersha është një nga satirat më therrëse dhe më realiste të Nolit. Aty parakalojnë personalitetet më kryesore zogiste, dhe morën pjesë në seancën e turpshme të 1 shtatorit 1928, dhe secilit i jepet nga një karakteristikë e veçantë, që del nga gjesti hipokrit ose fjalimi lajkatar i mbajtur atë ditë.

Fyt' i Floqit⁴⁾ po pëllet,
top' i Krosit⁵⁾ po kërcet:
Ç'është ky sheqer-kësmet?
Hallvaxhin⁶⁾ e pamë mbret!

Dhe rakia vete — vjen,
Xhafer Ypi⁷⁾ na mbërthen
dhe për lot na mallëngjen
rreth konopit me legjen.

Koço Kota, mjek hanxhari,⁸⁾
niç një valle palikari,⁹⁾
se me një ferman kusari
sadrzem¹⁰⁾ u bë firari.

Dhe Feridi¹¹⁾ faqen ndrron,
dje shante, sot lëvdon,
fryn bulçit' e trumbeton,
që katrani zbardhëllon.

Dhe sarhosh Iljas Vrioni¹²⁾
dehet, siç e do zakoni,
bërtet: «Rroftë Napoloni!
Kështu tha dhe Ksenofoni!»

Seç u shporr xhumhurieti,¹³⁾
seç u rehatos mileti,
se sulltanin prap' e gjeti,
se, që kur e humbi, s'fjeti!

Ç'ka sense i vjetri qe¹⁴⁾
madhështor sa një deve
dhe ky s'bën as për meze!
Rroftë sa jep ylyfe.

Seç na u gëzua xhani¹⁵⁾
seç na preu ramazani¹⁶⁾
seç na piu italiani!¹⁷⁾
Rroftë, pra, Salep-sulltani!

1. **Salep-Sulltani** — Sipas zakonit, në Perandorinë Osmane, oborrtarët dhe kronistët u vinin sulltanëve nga një mbiemër lavdërimi, me të cilin shprehej veçoria kryesore e këtyre sulltanëve.

Noli mendonte se edhe Ahmet Zogu, që u bë mbret, domethënë sulltan, duhet të kishte një mbiemër karakteristik. Sipas tij, mbiemri më i përshtatshëm për Zogun ishte «Salep-Sulltan» domethënë sulltan Salepçiu, pra një sundimtar i tipit otoman dhe qesharak, pa asnjë vlerë e pa merita.

2. **Mexhliz** — turqisht do të thotë: asamble, mbledhje, kuvend; poeti e përdor me tallje. Këtë kuptim e plotëson më tej me mbiemrin «i madh», pra një asamble e madhe, siç u pëlqente ta quanin lajktarët e Zogut.

3. **Pandeli Jano Vangjeli** — ose më saktë Pandeli Evangjeli ishte kryetar i «asamblesë». Në fjalimin e hapjes së mbledhjes, ai ngriti në qiell «të mirat» që do t'i vinin Shqipërisë nga shpallja e Zogut mbret. Vargu i fundit do të thotë se, ndërsa në vendet e tjera po përmbyseshin monarkitë, Shqipëria nga republikë po kalonte në monarki, po bëhej me mbret si kofini pas të vjeli.

4. **Floqi** — Kristo Floqi, avokat, shkrimtar, deputet, i cili më 1922 kishte shkruar një vjershë plot me lëvdata të shpëlara për Ahmet Zogun.

Kur Zogu u shpall mbret, kjo vjershë u bë «himni mbretëror».

5. **Krosi** — Është fjala për Abdurrahman Krosin, këshilltar dhe dora e djathtë e Ahmet Zogut, njeri pa kulturë, por shumë finok, dallaveraxhi imoral; i cili kryente për llogari të padronit të tij abuzime të mëdha dhe arbitraritete skandaloze.

6. **Ç'është ky sheqer-kësmet** etj — Dy vargjet e fundit të strofës së dytë kanë këtë kuptim tallës: nga na erdhi ky «fat i ëmbël» (sheqer-kësmet).

7. **Xhafer Ypi** — Bashkëpunëtor i ngushtë i Ahmet Zogut, ish-ministër, ish kryeministër, ish-anëtar i Këshillit të Lartë në periudhën 1921-1924. Më 1928 u bë ministër i arsimit në qeverinë e parë të monarkisë. Servilizmi dhe hipokrizia e Xh. Ypit arritën gjer në atë shkallë, sa ai fillon urimet me raki për Zogun mbret, para se ky të shpallej si i tillë nga «asambleja». Në fjalimin e tij Xh. Ypi lëshoi lotë krokodili, gjoja nga mallëngjimi, për ngjarjen e madhe, në një kohë kur pasuesit e Zogut mbanin pranë litarin (konopin) për të varur kundërshtarët e moarkisë.

8. **Koço Kota** — Një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Zogut në përgatitjen e kundërrevolucionit të vitit 1924, ministër i tij gjatë periudhës së republikës reaksionare dhe disa herë kryeministër. Poeti e quan mjek hanxhari, sepse duke mos qenë mjek dhe, duke pretenduar se kishte studiuar për mjekësi,

kishte kryer fshehurazi, për qëllime spekulimi; operacione kirurgjikale, pra; ishte jo kirurg i vërtetë, por kirurg që përdorte hanxharin e kasapit.

9. **Nis një valle palikari** — Palikar greqisht do të thotë «trim»; «bandill». Kështu quheshin, për mburrje, nga qeveritarët e Athinës, luftëtarët grekë. Këtu vargu ka kuptimin: nga gëzimi që Zogu u bë mbret, Koço Kota fillon të hedhë një valle prej palikari, si ato që hidhnin palikarët grekë (këtu bëhet aluzion për ndjenjat grekomane që ai kishte treguar kur ishte i ri).

10. **Sadrazem** — Turqisht, do të thotë kryeministër. Dy vargjet e fundit kanë këtë kuptim; Koço Kota filloi të hidhte valle, sepse me fermanin (dekretin) e një kusari, domethënë të Zogut, që kishte grabitur pushtetin si kusar; ishte bërë kryeministër. Dhe me të vërtetë, sapo Zogu u bë mbret, Koço Kota u emërua kryeministër: **Firar** do të thotë i arratisur. Është fjala gjithnjë për Koço Kotën, i cili më 1924 u arratis bashkë me Zogun.

11. **Feridi** — Në botimin e parë (atë të «Lirisë kombëtare» të vitit 1923) thuhet **Faiku** domethënë Faik Konica. Ky emër u zëvendësua më vonë nga poeti me atë të Feridit.

12. **Iljas Vrioni** — çifligar i madh feudal, dy herë kryeministër më 1920-1924, një nga bashkëpunëtorët e Zogut, i njohur si sarhosh (pijanec), që mbahej se njihte historinë dhe letërsinë, por që, në të vërtetë, kishte një kulturë të cekët dhe shpeshherë në bisedat e tij i ngatërronte gjërat.

Këtë dobësi të tij Noli e shpreh në dy vargjet e fundit, domethënë, sipas Iljas Vrionit, për Napoleonin (që ka jetuar në shekujt XVIII-XIX) ka folur Ksenofoni (historian dhe filozof grek i shek. V-IV para erës sonë).

13. **Seç u shporr Xhumhurieti etj.** — Gjithë strofa ka një kuptim ironik. Nga fjalimet e mbajtura në «asamble» dilte sikur gjoja populli shqiptar ishte shumë i shqetësuar nga «republika», gati të bënte kryengritje për të vendosur monarkinë dhe për ta bërë Zogun mbret.

14. **Ç'ka sepse i vjetri qe etj.** Në këtë strofë vazhdon thumbi ironik i poetit: I vjetri (sulltani turk) ishte perandor:

15. **xhani** — shpirti

16. **Seç na preu ramazani** — është fjala për fanatizmin fetar.

17. **Seç na piu italiani** — Seç na gllabëroi italiani, domethënë na pushtoi Italia fashiste, së cilës Zogu i kishte bërë të gjitha lëshimet ekonomike që kishte kërkuar, saqë nuk mund të flitej aspak për pavarësi kombëtare.

Syrgjyn-vdekur¹⁾!

(Elegji për Luigj Gurakuqin*)

Nëno²⁾ moj, mbaj zi për vëllanë,
me tre plumba na i ranë,³⁾
na e vran' na e shanë,
na i thanë tradhëtor.⁴⁾

* Elegjia «Syrgjun-vdekur» është botuar për herë të parë më 28 Nëntor 1926 në gazetën «Liria Kombëtare». Ajo i kushtohet jetës, luftës dhe vdekjes së Luigj Gurakuqit.

I rritur dhe i brumosur me idetë e mëdha të Rilindjes, në Shkodër ku lindi më 1879, e pastaj në Kalabri ku pati fatin të ishte nxënësi i De Radës, për të cilin ruajti gjithë jetën një admirim të veçantë. Gurakuqi që në rini e vuri jetën në frontin e parë të luftëtarëve të kombit në llogoret e luftës për liri, pavarësi e përparim shoqëror.

Në të gjitha zigzaget e historisë ai diti të orientohet drejt e të mbetet shembull i një atdhetari të flaktë në shërbim të Atdheut e të popullit të vet. Ai ishte një nga bashkëluftëtarët e Bajo Topullit për organizimin e kryengritjes së armatosur në Shqipërinë e Veriut në 1907, pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit më 1908, drejtor i së parës shkolle normale (pedagogjike) që u hap në Elbasan më 1909, pjesëmarrës me armë në Kryengritjen e malësorëve të Mbishkodrës më 1911 dhe një nga udhëheqësit e saj, një nga hartuesit kryesorë të Memorandumit të Gërçës dhe nga veprimtarët më aktivë për organizimin e kryengritjes së përgjithshme më 1912. Ai ishte shok i afërt dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Ismail Qemalit gjatë udhëtimit historik drejt Vlorës dhe, përkrah tij e Isa Boletinit, në aktin solemn të ngritjes së Flamurit më 28 Nëntor 1912. Në qeverinë e përkoh-

Se të deshte dhe s'të deshnin,
se të qante kur të qeshnin,
se të veshte kur të zhveshnin,⁵⁾
nëno moj, të ra dëshmor.

Nëno moj, vajto, merr malin,
larot⁶⁾ ta përmbysën djalin
që me Ismail Qemalin
ngriti flamur trimëror.

Nëno moj, ma qaj në Vlorë
ku të dha liri, kurorë,
shpirt' i bardhë si dëborë'
ti s'i dhe as var për horr.⁷⁾

Nëno moj, ç'është përpjekur
gojëmjalt' e zemërhekur,
syrgjyn-gjall' e syrgjyn-vdekur,⁸⁾
ky Vigan Liberator,

shme të Vlorës u caktua Ministër i Arsimit, më vonë anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, një nga udhëheqësit e opozitës demokratike në vitet 1921-24, pjesëmarrës në Revolucionin e Qershorit 1924, Ministër i Financave në qeverinë e F.S. Nolit dhe më vonë, pas shtypjes së Revolucionit, i emigruar politik në Itali, ku gjeti vdekjen më 2 mars 1925, i vrarë nga një njeri i vënë e i paguar nga klika e Zogut. Këto janë disa nga pikat më kulmore të jetës dhe veprimtarisë së këtij luftëtari të palodhur e demokraci të shquar të popullit tonë.

Luigj Gurakuqi ka edhe një veprimtari të begatë shoqërore kulturore e letrare si poet, publicist e orator, dhe njëherazi edhe si mësues e organizator i arsimit.

Figura të tilla të shquara si Luigj Gurakuqi i ka ngritur në piedestalin e pavdekësisë koha jonë e re, epoka e Partisë, duke e nderuar atë me titujt e lartë «Hero i Popullit» dhe «Mësues i Popullit». Vrasësit e zhdukën atë fizikisht, por nuk mund ta zhduknin kujtimin dhe veprën e tij.

Luigj Gurakuqi kishte qenë njeri i dashur, i nderuar nga të gjithë, dhe një demokrat i vendosur. Vrasja e tij pati jehonë të dhembshme në zemrat e patriotëve shqiptarë. Këtë dhëmbje e shpreh Fan Noli në vjershën e tij «Syrgjyn-vdekur». Ai e kishte pasur shok lufte dhe ia kishte njohur thellë vetitë e larta dhe fisnike, që ia këndon në vjershë me një zjarr të madh.

1. **syrgjyn-vdekur** — Fjala syrgjyn është marrë nga turqishtja dhe do të thotë i dëbuar nga vendi i vet, nga atdheu. Syrgjyn-vdekur do të thotë: njeriu që vdiq i dëbuar nga atdheu i vet.

2. **Nëno** — Atdhe, Shqipëri.

3. **Me tre plumba na i ranë** — Luigj Gurakuqi u rrëzua për-dhe, i vrarë, pasi kishte marrë tre plumba nga atentatori, një mercenar i paguar nga Zogu.

4. **Na e vran' na e shanë, Na i thanë tradhëtor** — Vini re se si i rendit fjalët poeti. Vrasja është më e pakët se sharja, sharja është më e pakët se fjala e tmerrshme tradhtar, për një patriot si Luigj Gurakuqi.

5. **Se të deshte dhe s'të deshnin etj.** — Në këtë strofë, duke përdorur antitezat të deshte — s'të deshnin, të qante — të qeshnin, të veshte — të zhveshnin, dhe duke iu drejtuar atdheut, Fan Noli skali të me mjeshtëri portretin e patriotit Luigj Gurakuqit.

6. **Larot** — qenat, zuzarët. Është fjala për klikën kriminale, që organizoi vrasjen e Luigj Gurakuqit.

7. **Ti s'i dhe as varr për horr** — Ti nuk i dhe as vend për t'u varrosur, për t'u prehur pas vdekjes, (që i jepet edhe horrit) sepse, siç dihet, Luigj Gurakuqi u varros në dhe të huaj; në Bari, atje ku u vra. Eshtrat e tij u sollën në Shqipëri vetëm pas Çlirimit, nga pushteti popullor.

8. **Syrgjyn-gjall' e syrgjyn-vdekur** — Sa ishte gjallë Luigj Gurakuqi, e kaloi një pjesë të madhe të jetës së tij syrgjyn (larg atdhetu); edhe tani që u vra, mbeti përsëri larg atdheut.

Shpell' e Dragobisë¹⁾

(Elegji për Bajram Curri *)

Kur tufani²⁾ e shturi fenë,³⁾
kur tirani e krrusi atdhenë,
mbi një breg të Dragobisë
priret⁴⁾ flamur' i lirisë.

*) Para se të mbushej një muaj nga vrasja e gjëmshme e Luigj Gurakuqit, më 29 mars 1925 ra afër Dragobisë, duke luftuar me armë në dorë, Bajram Curri, heroi i luftës çlirimtare shqiptare kundër sundimit osman, luftëtari i pamposhtur i lëvizjes demokratike kundër pushtetit të feudalëve shqiptarë, një nga udhëheqësit më të ndritur të Revolucionit të Qershorit. Atij i kushton Fan Noli elegjinë «Shpell' e Dragobisë» të shkruar më 28 tetor 1926 dhe të botuar për herë të parë në «Lirinë Kombëtare», më 28 Nëntor 1926 së bashku me elegjinë «Syrgjyn-vdekur», kushtuar Luigj Gurakuqit.

Bajram Curri ka lindur në Krasniqe të Gjakovës më 1862. Ai ka marrë pjesë në lëvizjen kombëtare të çlirimit kundër Turqisë; më vonë kundër Esat pashës dhe pastaj kundër Ahmet Zogut ose «Esatit të dytë», siç i thoshte vetë. Pas dhjetorit 1924, kur u kthye Zogu në Shqipëri, Bajram Curri nuk u arratis jashtë shtetit, po qëndroi me armë në dorë në malësitë e Tropojës, sepse nuk deshë të largohej nga gjiri i popullit, që «ka da bukën, mjerimet dhe gëzimet me mue».

Poeti e quan elegji vjershën «Shpell' e Dragobisë», por kjo nuk i ngjet aspak një vajtimi. Ajo është një himn dhe një kushtrim lufte. Noli e quan Bajramin «rrufe-shkabë», «div» dhe «dragua», «tribun i vegjëlisë», «bajrak i gjallë», sepse vdiq ashtu siç jetoi, duke luftuar për shpëtimin e atdheut nga zgjedha e huaj ku po e shpinte Zogu, për çlirimin e popullit nga shtypja e bejlerëve, ku e kishte gozhdur Zogu.

Atje nisi, atje mbaroi,
atje krisi, atje pushoi.
Rrufe-shkab' e malësisë,
në një shkëmb të Dragobisë.

Vendi dridhej, ai mbeti
se s'tronditej nga tërmeti,
div⁵⁾ dragoi⁶⁾ i Dragobisë,
trim tribun' i vegjëlisë.⁷⁾

O Bajram, brajrak i gjallë,
more nam me gjak në ballë,
te një shpell' e Dragobisë,
yll' i rrall' i burrërisë.

Thon' u shtri e thon' u vra,
por ti s'vdiqe, or Baba,
as te shkëmb' i Dragobisë,
as te zemr' e djalërisë.

As je vrar e as po vritesh,
legjendar Ante⁸⁾ po rritesh,
dithiramb⁹⁾ i Dragobisë,
tmerr, panik i mizorisë.

Me zjarr shenjt' u ndrit kjo shpellë,
gjer në qiell u ngrit kështjellë
për çlirimn' e Shqipërisë,
katakomb¹¹⁾ i Dragobisë.

1. **Dragobia** — katund i Krasniqës në malësi të Gjakovës. Në një shpellë të këtij katundi u rrethua Bajram Curri prej larove të Ahmet Zogut dhe u vra duke u përpjekur të çajë udhë me armë në dorë (shënim i F.N.)

2. **tufani** — kundërrevolucioni, reaksioni zogist

3. **e shthuri fenë** — këtu: »feja» përdoret në kuptimin e një ideali patriotik dhe jo në kuptimin e ngushtë fetar.

4. **priret** — ulet

5. **div** — qenie përrallore me shtat vigan dhe fuqi mbinjehzore, që shkul lisa, bluan gurë me duar, shemb shkëmbinj etj.

6. **dragua** — qenie përrallore të cilën populli ynë e përfyty-

ron shumë trim dhe të guximshëm; dragoi lufton me kuçedrën dhe e mposht.

Autori bashkon epitetet «div» dhe «dragua», që të na e paraqitë më të gjallë figurën morale dhe fizike të luftëtarit të patrembur Bajram Curri.

7. **Trim tribun** i vegjëlisë — Tribunët qenë zyrtarë të Republikës Romane, të ngarkuar me përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të vegjëlisë kundrejt aristokracisë (shënim i F.N.)

8. **Anteu** — i biri i Tokës, ishte një vigan i mitologjisë greke, i cili, kur rrëzohej prej ndonjë kundërshtari përdhe, merrte forca të reja prej Tokës, nënës së tij; dhe ngrihej prapë më i fortë (shënim i F.N.).

9. **Dithirambi** (fjalë greqisht) këngë fetare triumfale për perëndinë Dionis. Shpesh përdorej si një mbiemër i Dionisit vetë (shënim i F.N.).

10. **panik** — frikë e madhe, e përnjëhershme, që pushton një grumbull njerëzish.

11. **katakombet** — shpella nën dhé, të cilat përdorreshin prej të krishterëve si kisha në shekujt e parë të krishtërimit nga shkaku i ndjekjeve (shënim i F.N.).

Rend' or Maratonomak*!)!

Rend, or rend, rend e u thuaj,
se u shthur ordi,¹⁾ e huaj,
se betejën e fituam
dhe qytetin e shpëtuan!
Rend, or rend,
rend, or Maratonomak!

Kap një degë prej dafinë²⁾
dhe vërvitësh ndaj Athinës,

*) Vjersha «Rend, or Maratonomak!» u botua për të parën herë në gazetën «Liria kombëtare» të 30 prillit 1930.

Figura qendrore, Maratonomaku, është nxjerrë nga historia e Greqisë së vjetër dhe pikërisht nga lufta që u zhvillua në fund të shekullit V para erës sonë rreth fshatit Maratonë, 42 kilometra larg Athinës, midis ushtrisë persiane dhe ushtrisë athinase. Ndonëse të dy ushtritë u takonin dy vendeve skllavopronare, ato përfaqësonin në Maratonë dy botë të ndryshme. Në njërin anë qëndronin ushtritë e Persisë së madhe, të Persisë monarkiste despotike, që sundonte nga India gjer në Thrakë, duke përfshirë gjithë vendet e Lindjes së Mesme dhe të Azisë së Vogël, kurse, në anën tjetër, qëndronte ushtria e Athinës së vogël, e Athinës së demokracisë skllavopronare, me kulturë materiale, politike dhe artistike shumë më të lartë sesa të armikut. Mbreti i Persisë vinte të pushtonte dhe të shkatërronte Athinën, të skllavëronte banorët e saj. Ushtria persiane ishte disa herë më e madhe se ajo e Athinës, por në luftën e Maratonës fitoi ushtria e Athinës, që e vuri përpara armikun, e shkatërroi. Kjo fitore tregoi se një popull, qoftë edhe i vogël, mund t'i bëjë ballë dhe të thyejë një fuqi armike shumë më të madhe, në qoftë se është i bashkuar, në qoftë se di përse lufton.

Ndërkaq, në Athinë populli priste me ankth të madh.

Nëpër fush' e breg mbi breg
këmba tokën as ta prek,
hip' e zbrit,
Petrit, Maratonomak!

Ke një plagë, po s'e the,
djers' e gjak pikon përdhe;
do që ti të jesh i pari,
për triumfin lajmëtari.
Flamur — gjak,
Kuqo, Maratonomak!

T'u tha gryka po s'të pihet,
t'u mpi këmba, po s'të rrihet,
se mileti po të pret,
ankthi zemrat ua vret,
vrer e tmerr,
shpejt, or Maratonomak!

Menjëherë pas fitores, një maratonomak (luftëtar i Maratonës), vrapoi që të shpjerë lajmin gazmor në Athinë. Ai ishte i lodhur, sepse kishte marrë pjesë në luftë, por gëzimi se shpinte një lajm kaq të madh në qytet, i dha fuqi t'ia arrinte qëllimit. Pas një vrapo të jashtëzakonshëm nëpër kodra e fusha, nëpër shumë pengesa, maratonomaku arriti në Athinë, dha lajmin e fitores dhe ra përdhe i vdekur.

Nga kjo ngjarje fjala maratonomak ka marrë në letërsi kuptimin e «lajmëtarit të fitores», siç e përdor edhe Fan Noli në këtë vjershë.

Megjithëse kishin kaluar mjaft vjet nga shtypja e Revolucionit të Qershorit, Fan Noli kishte gjithnjë besim të patundur se populli shqiptar do të ngrihej dhe do ta përmbyste sundimin e tiranit Zog.

Maratonomaku i vjershës së Nolit nuk është vetëm një luftëtar dhe lajmëtar i fitores së një populli kundër një ushtrie të huaj pushtuese. Ai është lajmëtari i fitores së revolucionit popullor. Dhe me të vërtetë, më 1930, kur e shkroi këtë vjershë, Noli i kishte varur shpresat për shpëtimin e Shqipërisë vetëm në revolucionin popullor. Këtë bindje e përforcon vjersha «Anës lumenjve», që vjen më pas.

Kurrë kaq s'dogji dielli
dhe si plumb s'rëndoi qielli,
kurr' aq'ëmbël'e bukur s'ftoi
hij' e lisit edhe kroj;
turru tej,
tutje, or Maratonomak!

Vapa mbyt e pluhri nxin,
ferra gjerr e guri grin,
afsha⁵⁾ gjoksin përvëlon,
syrin avulli verbon;
ur'e prush,
furr' or Maratonomak!

Gryka si gjyryk⁴⁾ të shfryn
prej vullkani flak' e tym
seç vëngon⁵⁾ e seç gulçon,
zemra brinjët t'i shkallmon
me tokmak⁶⁾
mbahu, or Maratonomak!

Nëna, motra, nusja dalin,
ngrehin krahët të të ndalin,
mos, se s'janë veç Najada;⁷⁾
magjistrica⁸⁾ dhe Driada,⁹⁾
larg or larg,
larg, or Maratonomak!

Hajde, ja Akropolia,¹⁰⁾
ja qyteti e njerëzia,
që të pan' e që të shquan
dhe fuqinë ta rishtuan,
ha dhe pak,
hajde, or Maratonomak!

Ja arrite, ua the:
Ç'gas e ç'helm që kjo myzhde!¹¹⁾
«E fituam!» brohorite
dhe përtokë u përpëlitë;

vdiq, or vdiq!
vdiqe, or Maratonmak.

Rend kudo, duke bërtitur,
nëpër shekuj faqendritur
se i vogli shtrin viganin,
dhe i shtypuri tiranin,
veç e tok,
tok, or Maratonmak!

1. **ordi** — hordhi, turmë mizore, ushtri barbare
«U shthur ordi e huaj» do të thotë: u shpartallua hordhia e huaj, ushtria barbare.

2. **dafinë** — këtu përdoret si simbol i fitores, i lavdisë.

3. **afsha** — afshi, të nxehtët, ajri i valë

4. **gjyryk** — rrëshek farke, kacek

5. **vëngon** — gjëmon, oshëtin

6. **tokmak** — trung druri i rëndë, me dy doreza lart; përdoret për të ngjeshur gurët e një kalldrëmi të ri, për të rrahur hunjtë mbi të cilët do të ndërtohet ndonjë urë, për të dërmuar plisat në arë etj.

7. **Najadë** — gërshetëza, floçkë, nuse uji (burimi, lumi, liqeni)

Sipas mitologjisë greke, najadat ishin bija të Zeusit, të pajisura me fuqi mjekuese dhe mirëbërëse.

8. **magjistricë** — magjistare, grua që bën magji.

9. **driadë** — të bukura të drurëve, të pyjeve (në mitologjinë greke)

10. **Akropolia** — fortesa të qyteteve të moçme greke, të ndërtuara në një lartësi që zotëronte mbi këto qytete dhe brenda mureve të tyre rrethuese. Këtu është fjala për Akropolin e Athinës, fortesë e ndërtuar mbi një shkëmb gëlqeror, rreth 65 metra i lartë, që zotëron sipër qytetit.

11. **myzhde** — lajm i gëzuar, sihariq

Ānēs lumenjve*)

Arratisur, syrgjynosur,
raskapitur dhe katosur¹⁾
po vajtoj pa fund, pa shpresë,
anës Elbës, anës Spreesë.

Ku e lam' e ku na mbeti,
vaj-vatani e mjer mileti
anës detit i palarë,
anës dritës i paparë,
pranë sofrës i pangrënë,

*) Kishin kaluar disa vjet nga koha kur, pas shtypjes së Revolucionit të Qershorit, Fan Noli ishte mërguar në dhe të huaj. Në fillim, poeti kishte shpresuar se tirani nuk do t'i kishte ditët të gjata në Shqipëri, se pushteti i dhunës dhe i grabitjes, që kishte vendosur me klikën e tij, do të përmbysesj shumë shpejt dhe se në atdhe do të valonte përsëri, brenda një kohe të shkurtër flamuri i demokracisë. Po tirani mundi ta forconte sundimin e vet reaksionar me anën e mercenarëve, të bejlerëve, të bajra-tarëve dhe të fashistëve italianë.

Në ato vite të vështira, në radhët e të mërguarve politikë, vetëm një grusht i vogël demokratësh revolucionarë i qëndroi besnik luftës parimore kundër despotizmit të Zogut dhe pushtetit të bejlerëve. Mirëpo këta elementë revolucionarë, duke jetuar në mërgim dhe duke pasur përpara tyre gardhin e fortë të censurës zogiste, ishin të shkëputur nga lëvizja punë-tore dhe fshatare shqiptare, nga puna revolucionare brenda në Shqipëri.

Kalonin muaj e vite. Shpresat e Nolit për përmbysjen e shpejtë të sundimit të Zogut filluan të pakësohen. Ai kishte vite që endej në dhe të huaj. Siç thotë vetë poeti, në këto

pranë dijes i panxënë,
lakuriq dhe i dregosur,²⁾
trup e shpirt i sakatosur.

Seç e shembën derbederët,
mercenarët dhe bejlerët
seç e shtypën jabanxhinjtë³⁾
seç e shtrydhën fajdexhinjtë;
Seç e pren' e seç e vranë,
Ç'e shkretuan anembanë
nënë thundrën e përdhunës
anës Vjosës, anës Bunës!

Çirrem, digjem i vrerosur
sakatosur, çarmatosur,
as i gjall', as i varrosur,
pres një shenj' e pres një dritë,

endje ai «vajtonte pa fund e pa shpresë» fatin e atdheut dhe të popullit të zhytur në varfëri dhe errësi.

Por ja, më në fund, në këtë gjendje shpirtërore të dërrmuar, Nolit iu ngjall përsëri shpresa. Nga Shqipëria filluan t'i vinin lajme se punëtorët dhe fshatarët po përgatiteshin për furtunën revolucionare, se nga kjo furtunë dridhej tirani, beu dhe pasaniku. Këto lajme i dhanë fuqi, e përtërinë, e bënë ta ndiejë veten më djalë e më trim, i dhanë shpresë se pas dimrit të rëndë të reaksionit do të vinte shumë shpejt vera e demokracisë.

Në kohën kur u shkrua kjo vjershë, «furtuna» për Nolin ishte revolucioni popullor, revolucioni që propagandonin bashkëpunëtorët e tij të Komitetit të Çlirimit Kombëtar dhe të organit të këtij komiteti «Liria kombëtare», që botohej në Gjenevë.

Poeti e mbyll vjershën me një brohori për «furtunën» që po afrohej.

«Anës lumenjve» është vjersha më revolucionare që ka dalë nga pena e Nolit. Ajo është si një pishtar drite në vitet e errëta të reaksionit zogist.

pres me vjet' e pres me ditë,
seç u tera⁴⁾, seç u mpaka,⁵⁾
seç u çora, seç'u mplaka,
larg prej vatrës dhe prej punës,
anës Rinit, anës Tunës.

Çakërdisur,⁶⁾ batërdisur,⁷⁾
përpëlitur dhe zalisur,
ëndërroj pa fund, pa shpresë
anës Elbës, anës Spreesë.

Dhe një zë vëngon nga lumi,
më buçet, më zgjon nga gjumi,
se mileti pò gatitet,
se tirani⁸⁾ lebetitet,
se pëlçet, kërcet furtuna,
fryhet Vjosa, derdhet Buna,
skuqet Semani dhe Drini,
dridhet beu dhe zengjini⁹⁾
se pas vdekjes ndriti jeta
dhe kudo gjëmon trumbeta:
Ngrehuni dhe bjeruni,
korrini dhe shtypini,
katundar' e punëtorë,
që nga Shkodra gjer në Vlorë!

Ky ilaç, e ky kushtrim
më bën djal' e më bën trim,
më jep forc' e më jep shpresë
anës Elbës, anës Spreesë.
Se pas dimrit vjen një verë
që do kthehem njëherë
pranë vatrës, pranë punës,
anës Vjosës, anës Bunës.

Arratisur, syrgjynosur,
raskapitur e katosur
brohoras me bes'e shpresë
anës Elbës, anës Spreesë.

1. **katosur** — përkulur shumë, rënë; shprehje popullore:
«Më ra kali me shqelma e më katosi».
2. **i dregosur** — me drega; këtu ka kuptimin «i sëmurë»
3. **jabanxhi** — i huaj
4. **u tera** — u thava, u bëra kockë e lëkurë
5. **u mpaka** — u zvogëlova, u mblodha kuspull
6. **çakërditur** — davaritur, shushatur
7. **batërditur** — shembur, shkatërruar
8. **tirani** — këtu: Ahmet Zogu
9. **zengjini** — i pasuri

Sulltani dhe kabineti*

(Botohet me shkurtime)

Shokë, sot kam panair,
shokë, bëmëni sehir,
sillni kupat e gostisë,
sillni shishet e rakisë!

Vjersha «Sulltani dhe kabineti» është një nga krijimet e fundit të F.S. Nolit. Ajo u shkrua dhe u botua për herë të parë në vitin 1961. Në këtë poezi Noli demaskon figurën e urryer të ish-monarkut A. Zogu, bën aktakuzën e fundit ndaj kundërshtarit të tij politik më të fortë, duke arritur një përgjithësim artistik të tiranisë zogolliane. Poezia është ndërtuar në formën e një monologu gjë që e bën më të fuqishme forcën e saj demaskuese (formë të konceptuari artistik që e gjejmë edhe te satira e Çajupit «Sulltani»).

Në qendër të poezisë është vënë figura e një sulltani despot dhe zhahil. Zgjedhja e kësaj figure ishte lidhur ngushtë me detyrën që i vuri Noli vetes për të demaskuar jo vetëm Zogun, por edhe emigracionin reaksionar dhe për t'u zbuluar patriotëve thelbin shoqëror dhe politik të forcave që flaku në shportën e historisë populli shqiptar. Duke vizatuar atmosferën e vrasjeve, të shtypjes dhe të despotizmit të një shteti mesjetar feudal, psikologjinë dhe mentalitetin prapanik e obskurantist të një mjedisi tipik feudal, Noli sikur u kujton patriotëve shqiptarë nga radhët e emigrantëve ekonomikë se ç'skllavëri të urryer duan t'i përgatitin popullit shqiptar kriminelët e luftës që përkrahen nga imperialistët amerikanë.

Në një kuptim më të gjerë vjersha është një satirë e fortë kundër despotizmit, obskurantizmit dhe çdo forme të shtypjes së egër sociale e politike, kundër reaksionit në përgjithësi.

Kup' e parë, jam aga,
kup' e dytë jam pasha,
kup' e tretë, shpall ferman,¹⁾
ngjesh një pall' e jam sulltan.

Jam Ali Qopeku i Parë,²⁾
qen si unë s'keni parë;
pra, kur leh, duartrokitni,
zbrazeni topa e brohoritni,

Jam imani³⁾, jam dovleti,⁴⁾
padishahu⁵⁾ e Muhameti,
jam zhehnemi⁶⁾ e jam xheneti,⁷⁾
kijameti⁸⁾ e selameti⁹⁾

Jam xhamia e jam namazi¹⁰⁾
jam zinxhiri e jam kafazi,¹¹⁾
jam bodrumi e jam zullumi,¹²⁾
kush ngre kokën e merr lumi.

Kush do ligj e republikë
me statut e me logjikë,
e ka pisk dhe ngordh si hor¹³⁾
në konop, si tradhëtor

Jua nisa historinë
dhe ju solla prokopinë;¹⁴⁾
lë pas meje dinasti
për vazhdim e për lavdi.

Nuk pata paraardhës,
po ju lë një bir pasardhës,
gjurmën time të pasojë
dhe vatanin ta mendojë.

Shkruaj ti, o bash-qatip,¹⁵⁾
shkruaj mpreht' e me tertip,¹⁶⁾
lidhi lllomotit¹⁷⁾ e mia,
shkrepi nesër të xhamia.

Ty Abdull, jezit¹⁸⁾ sersem,¹⁹⁾
ty të bëra sadrazem,²⁰⁾
nxirr nga burgu çdo rezil,
çdo kusar dhe çdo katil.

Ty Abdull, xhahil,²¹⁾ Nefer,²²⁾
ty të bëra serasqer,³³⁾
bjeru armiqve, shuaji,
thyeji dhe bluaji.

Ti, Halim, që s'di këndim,
je vezir²⁴⁾ për arsim;
mbylli shkollat, se na nxinë
me kalemn' e tradhëtinë.

Leri hapur medresetë,
seminaret dhe teqetë,
po me gjuhët arabishte
hebraishte dhe greqishte.

Këtë urdhër shpall me vrap:
Libër, ti laik, mos hap;
me ungjillin dhe kuranin
merret prifti me imamin.

Me këta të dy pastaj
e ujdís Dervish pashaj;
papazllar' e hoxhallarë
jan' vëllezër të pandarë.

O Kalam, kaur behri,
ty të bëra bash-myfti;²⁵⁾
shpall: Rakia është e lirë
për myslim²⁶⁾ e për qafirë.²⁷⁾

O turgut, o turk i lig,
ty të bëra bash-patrik;²⁸⁾
shpall: Kauri s'merr dot grua,
se prej Krishtit u ndalua.

Grat' i marrin kapedanët,
pashallarët dhe sulltanët,
dhe kështu bashkohen fetë,
në këtë dhe n'atë jetë.

Kështu thot' ungjill' i shenjtë,
për të gjithë të mëdhenjtë:
I ka bërë perëndia
të na zërë llahtaria.

Ti Selim, vezir kusar,
ruaj arkën me hanxhar;
sillma plot me çdo çarë²⁹⁾
merr dhe ti ndonjë meze.

Ty Haxhi, domuz³⁰⁾ evlat,³¹⁾
ty të bëj vezir xhelat,
lidh litar dhe mprih sëpatë,
var e ther po pa shamatë.

Vraji, preji kundërshtarët,
si të fundmët dhe të parët,
se ma prishën qetësinë,
ma shkallmuan mbretërinë

Të pabesët me sevap³²⁾
piqi paq si shishqebap.
Të paudhët me usull³³⁾
zieji, bëji si qull.

Ty onbash,³⁴⁾ të bëj binbash,³⁵⁾
shpejt e shpejt, o dinkardash:³⁶⁾
Ty, hajdut, të bëj polic
vidh pa frik' e me shumicë.

Ty Mazllum, o arkadash,³⁷⁾
ty të bëra akçi-bash;³⁸⁾
ziej çorbë dhe tërhan
me tenxher' e me kazan.

.....
Mos harro, jam trim dhe ha
sa një buall dhe një ka;
pastaj sillmë tri kafë
dhe dy shishe nargjile.³⁹⁾

Si të ha, bëj temena,⁴⁰⁾
ngrimë me një makara,
më vendos mbi një sofat⁴¹⁾
urt' e but' e me rehat.

.....
Kur të shtrihem, nga çdo anë,
vermë nga një shishe pranë,
vermë kupa dhe meze,
ndryshe, gjumi, or vlla, s'më ze.

.....
Ty, or Hajrullah sevda,⁴²⁾
Ty të bëj kizllar-aga,⁴³⁾
Ti haremin ma përmbush
Plot me çupa, shëg' e rrush.

.....
Ty të shqepi tirania,
Mua hamja dhe rakia;
Që të gjitha, o perëndi.
Na i bën me urtësi.

-
1. **ferman-i** — urdhër me shkrim që lëshohet nga sultani.
 2. Sipas zakonit në Perandorinë Osmane, oborrarët dhe kronistët u vinin ofiqe sultanëve (shih «Kënga e Salep-sulltanit»). Ky ofiq që Noli i vë këtij despoti, ka nota të theksuara satirizuese (qopek-u-qeni)
 3. **iman-i** — simboli i fesë myslimane; besimi
 4. **dovlet-i** — mbreti, këtu: pushteti, qeveria
 5. **padishah-u** — sultani

6. **xhehnem-i** — ferri
7. **xhenet-i** — parajsja
8. **kijamet-i** — mbarimi i botës
9. **selamet-i** — shpëtimi
10. **namaz-i** — vakt të faluri për myslimanët.
11. **kafaz-i** — rojtari i posaçëm që vendosej pranë konsullatave, misioneve të huaja etj. në vise të ndryshme të Perandorisë Otomane.
12. **zullum-i** — zarr, dëm
13. **hor-i** — horr, njeri pa cipë, rezil
14. **prokopi-a** — dobi; këtu: gjithshka që keni
15. **bash-qatip-i** — shkruesi i parë, sekretar
16. **tertip-i** — rregulli, kujdesi
17. **llqmotit** — flas kot
18. **jezit-i** — njeri i pafe, tradhtar, shpirtkeq, i djallëzuar
19. **sermen** — i turbullt, i tërbuar, i mprapshët
20. **sadrazem-i** — kryeministër
21. **xhahil-i** — njeri i paditur, i trashë
22. **nefer-i** — ushtari
23. **serasqer-i** — komandant i përgjithshëm i ushtrisë
24. **vezir-i** — funksion i lartë në administratën e Perandorisë Otomane.
25. **myfti-u** — klerik i lartë muhamedan që drejton punët fetare të një rrethi a qarku.
26. **myslim** — myslimanë
27. **qafir-i** — i pabesë, i pafe, këtu: të krishterët
28. **patrik-u** — titull i kryetarit të ortodoksëve në disa shtete
29. **çare** — pa derman, patjetër
30. **domuz-i** — derri
31. **evlat-i** — biri
32. **sevap-i** — me të mirë për shpërblim
33. **usull-i** — me takt, me kujdes, prapashpine, me pabesi
34. **onbash-i** — gradë ushtarake, e mbante ai që komandon-te dhjetë ushtarë, tetar
35. **binbash-i** — gradë ushtarake në ushtrinë otomane
36. **dinkardash-i** — vëlla, njeri i besës
37. **arkadash-i** — shoku
38. **akçi-bash-i** — kryekuzhinier, kuzhinier i parë
39. **nargjile-ja** — kuti të vogla metalike me ujë, që i përdorin popujt e lindjes për të pirë duhan; nëpër to kalon tymi i duhanit dhe pastrohet e filtrohet.
40. **temena-ja** — përshëndetje allaturka, duke vënë dorën më parë në zemër dhe pastaj në ballë, në shenjë nderimi.
41. **sofat-i** — këtu: lloj kanapeje e gjatë dhe e gjerë me shpinëz
42. **sevda-ja** — dashuria
43. **kizllar-aga-i** — komandant i kazermës, zot i kazermës,

Skënderbeu*)

Lufton luftën¹⁾ dhe fiton²
mbreti Ladisllav³⁾ gjëmon;
djeg si ferr, si vdekje pret
ditën e rushajevet⁴⁾.

Dhe nga fush' e kuqe gjak,
ikën, rend përpara tij
e Muratit ushtëri⁵⁾
që shpëtoi e s'ra në lak.

Kur u ngrys e kur u err,
Skënderbeu, nder, lavdi
i asqerit Osmanli⁶⁾

Tok me turqit krismën merr,⁷⁾
si lufton e si humbet
ditën e rushajevet.

Mbet e vdekur prapa tij
e Muratit ushtëri,

*) Poema «Skënderbeu» e poetit amerikan Longfellou është shkruar më 1873 dhe bën pjesë në qerthullin «Histori të një hani buzë udhës». Poeti, Fan Noli, që e përktheu këtë poemë, e ka derdhur në një shqipe kaq të gjallë, sa që mund të themi se sot kjo vepër bën pjesë në letërsinë tonë.

kryerojtja⁸) udhën hap,
praparojtja⁹) rend me vrap
dhe armiku gjakësor
Si me drapër grin e korr.

Po kujdes ai s'të ka
as për bej, as për pasha,
edhe natën tek po shkon
yjt' e fatit po shikon
që i ndrisnin n'udhëtim;
edhe kalit tij i ra.
nënqeshi edhe tha:
«Është koha për gëzim».¹⁰⁾

Mes' i natës kur afroi.
ikja e rreptë kur pushoi,
një qatip na vjen, i mbretit¹¹⁾
me myhyrin e dovetit¹²⁾
edhe tha me zemërim:
«Njoll' e parë¹³⁾ t'u vu sot
n'emër, o Gjergj Kastriot!
Pse kështu? Oh, mjerë ne!
Ushërinë pse e le
therur fushës për vajtim?
U përgjigj Skënderi e tha:
«Dergjen mbytur nëpër gjak,
thembr' e kalit¹⁴⁾ i ka prag.

Po kështu e shkruar qe
nga i madhi zot atje
q'urdhëron çdo ushtëri,
dhe ku kemi ne fuqi
kur ngre dorën kundër nesh
dhe na grryen si rrebesh?

«Lidheni, — tha. — me litar,
shkruesin me kallamar!»¹⁵⁾
Dhe qatipi tha: «Po ç'faj
paskam bërë që pashaj¹⁶⁾

ma bën mua këtë gjë?»
U përgjigj Skënderi e tha:
«Faj s'ke bërë asndonjë,
po që të mos na shpëtosh,
dhe të fshihesh e të shkosh,
përandaj ta bëj këtë».

Tani shkruamë një shkrim¹⁷⁾
— Dhe për fis e paç bekim! —
Me myhyrin e dovletit
për mytesarifn¹⁸⁾ e mbretit
që mban Krujën, një qytet
rreth me mur e me hendek,
të ma kthejë gjën' e atit
n'emrin e sulltan Muratit;
se çdo urdhër që të japë
kurrë nuk merret prapë.

Dhe Qatipi u krrus prej tmerrit
dhe kështu i tha Skënderit:
«O Allah i madh, i naltë,
që të jemi hi e baltë!¹⁹⁾
qysh t'i shkruaj këto shkrime
kur e di që kokën time
po ma pret ai dovlet?»²⁰⁾
Shpejt ahëre si një yll
që këputet larg nga qielli
shpallet²¹⁾ nga i arti myll
një hanxhar me rreze djelli
dhe gjëmon²²⁾ Skënderi: «Shkruaj!»
dhe Qatipi i tmerruar
shkroi në dritën e dridhmuar²³⁾
afër zjarrit, i dërrmuar,
flokëbardhë, kokëngrirë,
nga e ftohta i mërdhirë,
zemërprerë, vdekjegrirë.

Dhe Skënderi prapë tha:
«Tani eja pas me mua,

se të mbetesh këtu s'dua,
do t'të kem si mik e vlla,
gjithnjë do t'të nderoj
me kujdes do t'të rrethoj
sa të rrosh në këtë botë».
U përgjigj Qatipi e thotë:
«Udha jonë këtu ndahet,
shoqëria jonë s'mbahet».
Pa mbaruar këtë fjalë,
një hanxhar i rëndë ra,
kur s'ish afër asnjë tjatër,
dhe Qatipi po përmbysset
si një gur që rrugulliset²⁴⁾
në liqen të zi dhe shket
tatëpjetë dhe humbet.
Edhe rreth në qetësi
asnjë pipëtim s'u ndi²⁵⁾
përveç kalit Skënderbeut
që përpjet' u hodh prej dheut.

Pastaj sulet si shigjeta
me treqind pothuaj veta
nëpër lum' e pyll e gardh²⁶⁾
përmbi malet Argjendar;²⁷⁾
dhe me zemrën plot gëzim
kapërceu lumin Drin
dhe u gdhi e n'agullim²⁸⁾
pa kështjellën Ak-Hissar,²⁹⁾
Krujën, ah atë qytet
rreth me mur e me hendek,
tek u lind e tek u rrit,
yll mëngjesi mbi të ndrit.

Dhe aherë trumbetarët
brirëve t'argjendë u bien
edhe togje rreth i mblidhen
turqit bashkë me shqiptarët
që dëgjuan atë thirrje.
Dhe kremtoi me miq³⁰⁾ e tij

dhe u ngrohën me dolli.
Dhe u thotë: «Miqt e mi,
shihni fati ç'na dërgon,
perëndia ç'na bekon!
Mbret Murati urdhëron
mall' i gjerë i tim eti
vend' i tërë dhe qyteti
të më jepen nga dovletit».
Dhe pastaj me salltanet,³⁰⁾
veshur armët si një mbret,
shkon kaluar në kështjellë
edhe hyn nga port e gjerë
dhe pashajt që urdhëron
përmbi Kruj' i dorëzon
urdhërin e Murat mbretit
me myhyrin e dovletit.
Dhe pashaj, si heshti, tha:
«Lavdi pastë perëndia,
ja ku hiqem nga fuqia,
Merre vendin dhe qytetin;
kush lufton dot me kësmetin?»

Nga kështjella shpejt ka rënë
flamuri me gjysmëhënë
edhe populli shikon
që në vend të tij valon
flamur' i Skënderit n'erë
shkab' e zezë me dy krerë.
Dhe një thirrje lart u ngrit;
se çdo zemër e çdo shpirt
u mërzit nga turku i lig,
q' e kish bërë atë Krujë
zi, murtajë³¹⁾ dhe rrëmujë.
Ai zë me gas, me bujë
q' oshëtin nga breg në breg
është: «Rrofsh, o Skënderbeg!»

Ja kështu Skënderi trim
mori Krujën me rrëmbim;
edhe lajma³²⁾ u përhap
si një flakë, si një zjarr
q'i fryn era në behar
dhe qytetet afër e larg,
thotë Ben Isa Ben Miri³³⁾
në qitap³⁴⁾ të tij fakiri,
«Binin m'atë lehtësi
që zë burri veshn' e tij».³⁵⁾

1. **Lufton luftën** — Këtë shprehje të moçme shqipe e gjejmë edhe tek arbëreshët e Italisë: «Të ljuftoj ljuftën e prasëm» (Ballada popullore arbëreshe, «Skënderbeu dhe vdekja»).

2. **dhe fiton** — Është fjala për betejën e Nishit, që u zhvillua në nëntorin e vitit 1443 midis hungarezëve dhe turqve. Hungarezët kishin në krye mbretin Ladislav dhe kapitenin Janosh Huniadi, vojvodën e Transilvanisë; turqit kishin komandant të parë Kasem pashën.

3. **Ladislavi** — mbret i Polonisë qysh nga viti 1434 dhe i Hungarisë nga viti 1439.

4. **rushajet** — shën-trinia, festë fetare

Rushajet bijen në verë, kurse beteja e Nishit u bë në nëntor. Këtu kemi një mospërputhje përsa i takon kohës.

5. **e Muratit ushtëri** — ushtria e sulltan Muratit II të Turqisë.

6. **i asqerit Osmanli** — i ushtrisë së osmanllinjve, domethënë i ushtrisë turke.

7. **tok me turqit krismën merr** — shprehja «merr krismën» ose «krisën e ikën» do të thotë ua mbathën me të katra, ikën me vrap. Sipas Barletit, Skënderbeu nuk mori pjesë në betejën e Nishit, por iku me shokët e tij besnikë, sepse kishte kohë që priste rastin të kthehej në atdhe dhe ta çlironte.

8. **Kryerojtja** — pararoja.

9. **Praparojtja** — praparoja

10. **është koha për gëzim**. — Sipas Longfellout ose atij që ka treguar ngjarjen, Skënderbeu vendosi të kthehej në Shqipëri pas betejës së Nishit, duke përfituar nga thyerja e ushtrisë turke. Fati i mirë ia solli përpara qatipin, të cilit i shkuli me pahir fermanin që t'i dorëzohej fortësia e Krujës. Marin Barleti thotë se Skënderbeu kishte vendosur të ikte që përpara luftës, ishte marrë vesh për këtë qëllim me të nipin, Hamzain, dhe me shokët e tjerë; pra e kërkoi qatipin, e gjeti në ikje e sipër dhe i mori fermanin të lëshuar në emër të Muratit II. Formularët e fermanëve mbaheshin të gatshëm dhe vuloseshin me vulën e sulltanit.

11. **qatip i mbretit** — shkruesi i sulltan Muratit II
12. **me myhyrin e dovletit** — me vulën zyrtare të shtetit turk, me vulën e sulltanit.
13. **Njollë e parë** — Shkruesi i sulltan Muratit II e qorton Skënderbeun dhe çuditet, sepse kjo ishte hera e parë që trimi shqiptar tërhoqej përpara armikut.
14. **Thembr' e kalit** — thundra e kalit
15. **kallamar** — enë e vogël, si kupë, zakonisht prej tunxhi, ku mbahej boja për të shkruar, kallamari kishte një bisht të gjatë e të zbrazët brenda, ku futeshin pendët e shkrimit; kallamari mbahej me bishtin të futur në brez.
16. **pashaj** — gjenerali i ushtrisë turke; këtu: Skënderbeu
17. **shkruamë një shkrim** — më shkruaj një urdhër, një ferman.
18. **mytesarif** — qeveritar turk i një krahine
Këtu është fjala për qeveritarin turk të Krujës, Hasan beun, të cilin Murati II e kishte dërguar me të pabesë të pushtonte Krujën dhe tërë principatën e Kastriotëve, pas vdekjes së Gjon Kastriotit, kurse e drejta, sipas marrëveshjes, e donte që këto vise t'i trashëgonte i biri i Gjonit, Skënderbeu.
Në të vërtetë qeveritari turk, i Krujës nuk mbante titullin «mytesarif», por «subash».
19. **Që të jemi hi e baltë** — Përpara teje ne s'jemi asgjë, jemi si hiri e balta.
20. **dovlet** — shteti turk, këtu: nënkuptohet sulltani
21. **Shpallet** — Këtu ka kuptimin del
22. **gjëmon** — thërret me një zë kaq të fortë, sa duket, sikur gjëmon.
23. **në dritën e dridhmuar** — në dritën që dridhet, që valëvitej
24. **rrugulliset** — rrokulliset
25. **s'u ndi** — s'u ndie, s'u dëgjua
26. **gardh** — këtu ka kuptimin pengesë
27. **malet Argjendar** — malet e Sharrit, në Kosovë
28. **n'agullim** — kur agullon drita, kur zbardhëllon mëngjesi.
29. **kështjella Ak-Hissar** — Turqisht Ak-Hissar do të thotë kështjella e bardhë; kështu e quanin turqit Krujën.
30. **me salltanet** — me madhësi, me bujë
31. **murtajë** — sëmundje e tmerrshme ngjitëse; këtu fjala murtajë ka kuptimin mjerim i madh, shkatërrim
32. **lajma** — lajmi
33. **Ben Isa Ben Miri** — kronikan arab i Spanjës, emri i të cilit nuk njihet në histori dhe ndoshta është trilluar nga poeti.
34. **qitap-i** — libër
35. **që zë burri veshn' e tij** — përnjëherësh, po aqë lehtë sa njeriu zë veshin e tij me dorë.

Prometeu i mbërthyer

(Hefesi me Përdhunën dhe Pahirin e sjellin Prometeun të lidhur mbi një shkëmb të Kaukazit).

Përdhuna

Arritëm tek m'i largmi çip i dheut,¹⁾
në malet e pashkelura të Skithisë.²⁾
Ti, pra, Hefest,³⁾ pas urdhrit atëror⁴⁾
këtë keqbërës e mbërthe mbi shkëmbin
dhe lidhe me vargonj të pashkëputur,
se lulen tënde, zjarrin, kryemjeshtër,

*) Prometeu — titan i mitologjisë greke
Prometeu përfytyrohej si mbrojtës dhe ndihmës i njerëzve, të cilëve u dha zjarrin, i mësoi të zbutin kafshët, të merren me bujqësi, të njohin artin e lundrimit, të punojnë metalet. Po ai, thuhet, u dha njerëzve shifrat dhe shkronjat, u mësoi mjekësinë. Megjithatë njerëzit nuk i nderonin shumë perënditë dhe nuk u sillnin dhurata dhe therrorë të mjafta, Zeusi, i ati i perëndive, ua mori zjarrin, por Prometeu ia grabiti nga qielli dhe ua dha prapë njerëzve. Atëhere Zeusi u zemërua dhe e ngarkoi Hefestin ta mbërthejë Prometeun në një shkëmb të malit Kaukaz, ku një shqiponjë t'ia copëtonte ditën mishrat e shtatit dhe t'ia shqyente mëlcinë me sqepin e saj. Plagët e shëroheshin natën, por të nesërmen shqiponja vinte përsëri dhe fillonte prapë mundimi. Ndëshkimi duhej të zgjaste mijëra vjet, po ndërkaq Zeusi bëri paqe me njerëzit dhe i dha leje Irakliut që ta vriste shqiponjën dhe ta çlironte Prometeun, pas tri vjetësh mundimesh.

ta vodhi, ua fali njerëzve.
Kështu mëkatin e tmerruar lan,
mëson t'i ulet mbretërisë së Jovit,⁵⁾
dhe dorë heq nga helm' i njeridashjes.⁶⁾

Hefesti

Përdhunë dhe Pahir, për ju të dy
ndalim për porosin' e Jovit s'ka.
Po mua s'më bën zemra ta mbërthej
gjirinë perëndi⁷⁾ mbi këtë shkëmb.
Mjerisht jam i shtrënguar ta zbatoj,
se nuk e shkel dot urdhrin atëror.

(Prometeut)

O bir i mençur i Themidës⁸⁾ së drejtë,
pa dashur un' aspak dhe ti pa dashur,
do të mbërthej mbi këtë shkëmb të shkretë,
ku s'ke për të dëgjuar zë njeriu,
ku do të piqesh nën diellin,
ku ditën do të preç notin⁹⁾ e natës,
dhe natën vapën brymëshkrirëse,
se do të përvëlojë gjithnjë
mundimi i së keqes së tanishme,
se çlirimtari yt s'ka lindur edhe.
Këto t'i solli vepr' e njeridashjes.
Si perëndi, s'iu trembe perëndisë,¹⁰⁾
dhe njerëzit pa mas' i pasurove.
Këtu, pra, u dënove të qëndrosh
tendosur, gjupaepur, dhe pa fjetur;
këtu do të vajtosh me lot më kot,
se Jovi s'ka mëshirë e nuk zbutet.
Çdo mbret i ri në krye është i ashpër!¹¹⁾

1. tek m'i largmi çip'i dheut — malet Kaukaz, të cilat të vjetrit i pandehnin si cakun më të largët të tokës.

2. Skithia — vendi ku banonin skithët, një popull i mocëm që endej në hapësirat midis Kaukazit dhe verijut të Danubit.

3. **Hefesti** — (Vullkani i romanëve) — biri i Zeusit, që numërohej si hyjni e zjarrit të nëndheshëm, domethënë e zjarrit të vullkaneve.

Sipas mitologjisë, Hefesti ishte farkëtar i shquar. Të vjetrit e përfytyronin Hefestin të çalë, të shëmtuar dhe shumë të vrazhdët.

4. **urdhri atëror** — urdhrin e Zeusit, ati i Hefestit dhe prijësi i të gjithë perëndive.

5. **Jovi** (Jupiteri i romanëve) — Zeusi.

6. **Dhe dorë heq nga helm' i njeridashjes** — heq dorë nga dashuria për njerëzit; këtë ndjenjë, Zeusi, babai i perëndive, e numëronte si «helm», meqenëse njerëzit nuk i shtroheshin; nuk i blatonin dhurata.

7. **Prometeu** ishte nipi i Kronosit, të atit të Zeusit, pra ishte gjiri, farefis me Zeusin.

8. **Themida** — bija e qiellit dhe e Tokës, perëndeshë e drejtësisë në mitologjinë greke.

Shpeshherë të moçmit e përfytyronin këtë perëndeshë me sy të lidhur, si simbol të paanësisë dhe me një peshore në dorë. «Bir i mençur i Themidës» ka kuptimin bir i drejtësisë. Emri Prometeu do të thotë «njeri që mendon përpëra, që parashikon».

9. **noti** — lagështi, freski

10. **si perëndi, s'iu trembe perëndisë** — Prometeu nuk ishte perëndi, por titan, nip perëndie. Megjithatë, nuk ua kishte frikën perëndive dhe i ndihmonte njerëzit.

11. **Çdo mbret i ri në krye është i ashpër** — Këtu është fjala për Zeusin, të birin e Kronosit. Kronosi i përpinte bijtë e tij, që të mos i merrnin fronin. Zeusi nuk e përpiu dot, sepse Rea, e shoqja e rrëmbëu dhe e dërgoi në ishullin e Kretës. Kur u rrit e përmbysi nga froni t'anë, Kronosin, dhe e detyroi të nxirrte nga barku gjithë fëmijët që kishte përpërë. Zeusi ishte «mbreti i ri».

Male, pyje plot me fletë

(Nga «Don Kishoti i Mançes»)

Male, pyje plot me fletë,
të mëdhenj e të përpjetë,
pa pushoni e më dëgjoni,
ejani më ngushëlloni,
për hatanë,¹⁾ për belanë,²⁾
për qederin,³ për sevdanë,
që më ssthuri anëmbanë,
këtu qan trim Don Kishoti te dëllinja
për largimin nga Dylqinja
e Tobozës.

Te ky vend më solli fati,
fat' i zi e taksirati,⁴⁾
se si unë s'ka ashik,⁵⁾
dhe si unë s'ka besnik,
dhe kështu më mori djalli,
më svarnis⁶⁾ për kapistalli,⁷⁾
pra nga halli dhe nga malli
këtu qan trim Don Kishoti te dëllinja

Vjersha «Male, pyje plot me fletë» është një vajtim i nxjerrë nga libri «Don Kishoti i Mançes» i shkrimtarit të madh spanjoll Miguel Servantes, por një vajtim pak si qesharak, sepse Dylqinja e Tobozës s'ka qenë kurrë veçse diçka e trilluar në mendjen e Don Kishotit.

për largimin nga Dylqinja
e Tobozës.

Duke ndjekur aventyra,⁸⁾
te ky mal i shkretë hyra,
por më ndjek nga pas sevdaja
më qëllon, më ndjek murtaja
me shigjetën e helmuar
dhe jam djegur, përvëlur,
dhe kështu i dëshpëruar,
këtu qan trim Don Kishoti te dëllinja
për largimin nga Dylqinja
e Tobozës.

1. **hata** — mjerim, fatkeqësi, pikë e zezë
2. **bela** — ngatërresë, punë e mërzitshme
3. **qeder** — dëm, humbje, helm
4. **taksirat** — fat i keq
5. **ashik** — dashnor
6. **svarnis** — zvarrit, heq zvarrë
7. **kapistall** — kapistër
8. **aventyrë** — aventurë, ngjarje me të papritura

Këtu dergjet Don Kishoti

(Nga «Don Kishoti i Mançes»)

Këtu dergjet Don Kishoti:¹⁾
Ish i fort' e ish i zoti,²⁾
botën prapa desh ta kthente³⁾
dhe me ushtë⁴⁾ ta mbërthente.

Këtu brenda fle Dylqinja:
seç këndonte si mëllinja!
Ish e kolme,⁵⁾ rrumbullake,
faqekuqe, pupulake.⁶⁾

Këtu dergjet Sanço Pança:
si ai s'ka parë Mança!⁷⁾
E kish barkun sa një kosh,
e kish kokën fare bosh.

Këtu dergjet Rosinanti:
ishte më interesante
nga çdo kalë që kulloti
barin që ka bërë zoti.

1. Don Kishoti dhe Sanço Pança janë heronjtë kryesorë të kryeveprës «Don Kishoti i Mançes», të shkrimtarit spanjoll Miguel Servantes.

2. Ish i fort' e ish i zoti. — Ky është një varg thumbues, tallës, për të kuptuar të kundërtën: as i fortë, as i zoti.

3. botën prapa desh ta kthente — të kthente kohërat e para; kohërat e perënduara të mesjetës së parë.

4. ushtë — heshtë, pra, kuptimi është: pasi ta kthente botën prapa, ta mbërthente në vend me heshtë.

5. e kolme — e hijshme, e këndshme

6. pupulake — e mbushur; thuhet edhe topolake, popolake

7. Mança — krahinë e Spanjës në provincën Ciudad Real.

Rubaitë¹⁾ e Lirisë

Më mirë bukëthat²⁾ e rrobëshqyer³⁾
me ujë rro, i lirë, poçethyer⁴⁾,
sesa tiran⁵⁾ prej skllëvërish gjakpërlyer
e skllav në zgjedhë shtypëse mbërthyer.

Çudi, që parësi e titulluar⁶⁾,
nga skllavëria kalbur, shtazëruar,
kur shohim një të varfër, po të lirë,
e quajn' a të marr⁷⁾, a të mallkuar.

Rrëmbyen mall⁸⁾, memuriet⁹⁾ e ar,
dhe t'urtin plak e t'urët shkencëtar
e quajnë gjaur¹⁰⁾, se s'beson prralla,
se s'qas mbi supet¹¹⁾, si ata, samar.

Të kisha, ah, fuqi prej perëndie,
i jepja shkelmin kësaj gjithësie
dhe krenja¹²⁾ botë tjetër, ku të kishte.
Çdo plotësim dëshire dhe lirie!

Rubaitë e mëngjesit

A di përse këndesi po këndon
menatë¹³⁾ dhe nga gjumi po të zgjon?
Që shkoi një ditë po lajmëron,
dhe ti, shkujdesur, fle dhe ëndërron.

Zgjohu! Mëngjesi me shigjet' e grisi
perden e natës, yjt i arratisi¹⁴)
dhe dielli gjahtar me rreze kapi
qdo majë mali e pallati e lisi.

Qesh trëndafili e thotë: «Lulëzoi
dhe botës bukurinë po ia shtoi:
Pastaj e hap kuletën e mëndafshtë¹⁵)
dhe përmbi kopsht thesarin po e shtroj.».

Mbi lulet po pikojnë vesë retë,
dhe me një zë qiellor, bilbil' i shkretë:
Ah, Verë! Verë! Verë! Trëndafil
i lyp të skuqë faqezën e zbetë.

1. **rubai** — strofa me katër vargje, që kanë një kuptim të plotë. Rima e tyre e zakonshme është a-a-b-a, d.m.th. rimojnë midis tyre vargu i parë, i dytë dhe i katërt. Është përdorur mjaft sidomos nga poetët persianë.

2. **bukëthat'** — të rrosh bukëthatë, domethënë me një krodhë bukë të thatë, të pangjyer në gjellë.

3. **rrobëshqyer** — i rreckosur, rrobëgrisur

4. **poçethyer** — Omar Khajami ka adhuruar dhe kënduar verën. Shprehja «poçethyer» ka kuptimin «pa verë».

5. **Sesa tiran** etj. — Në këto dy vargje poeti përçmon edhe tiranin e përlyer me gjak, edhe skllavin të mbërthyer në zgjedhë dhe thotë se varfëria është më e mirë për të.

6. **parësi e titulluar** — ata që i thonë vetes parësi, krerë: pasanikët.

7. **të marr'** — të marrë, të çmendur,

8. **mall** — pasuri

9. **memuriet** — nëpunësit

10. **gjaur** — i pabesë, në kuptimin fetar, që s'beson fenë myslimane (kështu i quanin dikur myslimanët ata që besonin fe të tjera).

11. **Se s'qas mbi supet..** — se nuk i nënshtrohet skllavërisë, se qëndron i lirë, kundër shtypjes, përuljes

12. **krenja** — ndërtoja, bëja

13. **menatë** — herët, pa gdhirë

14. **i arratisi** — shpërndau tej e përtej

15. **kuletën e mëndafshtë** — këtu ka kuptimin gjethet që rrethojnë e mbyllin lulet e trëndafilin.

Otello*

Uilliam Shekspiri (William Shakespeare)**) dramatiçi më i madh i botës lindi më 1564 nga një familje e

*) Kjo introduktë është botuar për herë të parë si parathënie e veprës «Tragjedia e Otellos, Arapit të Venedikut» që u shtyp në Boston-Mass më 1916.

Noli u shqua jo vetëm si poet, historian, publicist, përkthyes, muzikolog e figurë politike, por edhe si kritik i fuqishëm letrar. Në këtë fushë ai e dha mendimin e tij të guximshëm në një kohë kur kritika jonë letrare sa po hidhte hapat e parë. Kritika letrare e Nolit lindi si një kërkesë e domosdoshme për t'i ardhë në ndihmë lexuesit të thjeshtë shqiptar, në radhë të parë për të kuptuar drejt kryeveprat e letërsisë botërore që ai me aq mjeshtëri i përktheu në gjuhën shqipe. Prandaj edhe afirmimi si kritik letrar bëhet kryesisht nëpërmjet «parathënieve» (introduktave) që penda e tij mjeshtërore krijoi e i vendosi si hyrje në veprat që përktheu.

Noli na ka lënë gjithsej 8 introdukta. Serinë e tyre e hap introdukta që shkroi më 1916 për «Otellon» dhe e mbyll introdukta për romanin «Don Kishoti i Mançës» që e shkroi më 1932. Gjashtë të tjerat për «Hamletin», «Makbethin», «Armikun e popullit», «Zonja Ingra e Ostrotit» dhe «Rubairat» i shkroi brenda vitit 1926.

**) Shekspiri është një nga shkrimtarët që e ka tërhequr më shumë Nolin. Kjo ndoshta lidhet edhe me faktin se që në rininë e hershme, kur punoi si sufler në grupin teatror shëtitës, ai u njoh me disa nga veprat e këtij kolosi të letërsisë, ndaj edhe e dashuroi gjithë jetën.

Introduktën për tragjedinë e «Otellos», meqenëse është e para, Noli e gjykon me vend që ta nisë me një paraqitje të shkurtër për jetën dhe krijimtarinë e autorit, pastaj kalon në elementët e analizës ideoartistike të brendisë dhe në tiparet më të rëndësishme të personazheve kryesore (Otello, Desdemona, Jago etj.).

mirë fshatarakësh të katundit Snitërfild (Snitterfield), të vendosur në Stratford-on-Ajvën (Stratford-on-Avon). Mësimet e tij i bëri në shkollën e këtij qyteti. Më 1585 shkoi në Londër dhe zuri punë nëpër theatret si aktor. Më 1597 Shekspiri kish fituar famë dhe që i njohur si më i madhi dramatist i Inglisë¹). Kumpanja²) teatrale, në të cilën punonte Shekspiri, u nderua prej mbretit të Inglisë, Xhejms I (James), i cili i dha disa privilegje të veçanta dhe u dha aktorëve titullin «King's Servants» (shërbëtorët e mbretit). Më 1613, në dasmën e princeshës Elisabetë³), u lojtën shtatë vepra të Shekspirit në pallat. Shekspiri vdiq më 1616 dhe u mbulua në Stratford Çërc⁴ (Church). Busti i tij në këtë kishë u ngrit pak vjet pas vdekjes së tij. Pas kësaj më e vjetra fytyrë e Shekspirit që kemi është një gravurë⁵) prej Droeshoutit, e botuar në krye të Folios⁶) I më 1623. Kjo Folio I është e para koleksje (mbledhje), e gjithë veprave të Shekspirit, dhe u shtyp nën kujdesin e dy shokëve të Shekspirit, Xhon Hemingut (Jon Hemming) dhe Henri Kondellit (Henry Condell).

Shekspiri ka shkruar vjersha, komedi, drama historike dhe tragjedi. Famën në botë e fitoi më tepër me tragjeditë e tij. Nga këto më të dëgjuarat janë *Hamleti*, *Makbethi*, *Romeo dhe Zhulieta*, *Otelloja*, *Mbreti Lir* dhe *Jul Cezari*.

«*Othellua*, *Arapi i Venedikut*» u shkrua më 1604. Subjekti e kësaj tragjedie e ka marrë Shekspiri nga Hekatomiti (Një mijë përralla) i novelistit italian Xhirdaldi Çintio (Giraldi Cinthio), i cili rronte në krye të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Natyrisht, e ndrrroi, e shtoi dhe e ujdisi me një mënyrë të tillë, sa nga përralla pa vlerë e Çintios krijoi një kryevepër artistike nga më të mëdhatë në botë. «*Othellua*», pas mendjes së përgjithshme⁷), është tragjedia e lidhur më mjeshtërisht se gjithë veprat e tjera shekspiriane.

Subjekti i tragjedisë me pak fjalë është ky: *Othellua*, një arap i Mavritanisë⁸) dhe gjeneral i Republi-

kës së Venetikut, bie në dashuri me Desdemonën, të bijën e senatorit Brabant të kësaj republike, e rrëmben dhe martohet fshehurazi. Jagua, nënoficer i Othellos, i fut idenë që e shoqja e turpëron me një oficer të tij të quajtur Kasi dhe ia mbush aq mirë kokën, sa Othellua e mbyt në shtrat të shoqen e tij dhe pastaj vret dhe veten, kur e merr vesh që e shoqja e tij qe fare e pafajshme.

Rolet e para⁹⁾ të kësaj tragjedie i lozin Othellua, Desdemona dhe Jagua, rolet e dorës së dytë Brabanti, Kasi, Roderigu, Emilia dhe Bjanka.

Othellua, një arap i Afrikës së Veriut, i lindur nga një fëmijë mbretërore, që ka shëtitur tërë botën dhe ka shkuar tërë jetën në luftëra, kish hyrë në shërbim të Republikës së Venetikut, e cila aherë qe mbretëresha e deteve¹⁰⁾ siç është sot Inglija, dhe kish arrirë të jetë gjenerali më i mirë dhe më i besuar i Republikës. Është trim, besnik, i nderçim, i drejtë, i padjallëzuar dhe kryelartë, ngaqë ka fituar me vlerën e tij një shkallë aq të madhe. Megjithëkëtë, parësia e Venetikut e quajnë gjithnjë si të huaj dhe të zi¹¹⁾. E nderojnë dhe e qasin nëpër shtëpitë e tyre, po nuk e quajnë si shok, ngaqë është lindur zezak. Kjo gjë e lëndon arapin trim mu në zemër. Po një ngjarje e papritur e bën lumtërinë e Othellos të plotë e të mbaruar. Desdemona, vajza e bukur e një senatori¹²⁾ të Republikës, bie në dashuri me Othellon, ikën nga shtëpia e t'et dhe martohet fshehurazi me të. Othellua nuk është më i huaj në Venetik, kur një vajzë nga shtëpitë e para të vendit e merr për burrë. Kjo martesë, pra, është kurorëzimi i gjithë mundimeve të tij. Othellua tani u bë vendës dhe shok me të parët¹³⁾ në Venetik.

Desdemona, e shoqja e tij, qe nga shpirti, nga zemra dhe nga fytyra, siç thotë Emilia, «më i bardhi dhe më i ëmbli pullumb që fluturoi në këtë botë». E rritur mirë, muzikante e mbaruar, aq sa «munt të zbutë një ari me këngë», lot valle me elegancë aristokratike, flet me ëmbëlsi dhe mirësi prej ëngjëlli, ni-

koqire dhe e zonja në gjilpërë, e qetë dhe e urtë që ka turp e skuqet dhe nga vetja e saj. Trimat flokëdredhur nga shtëpitë e para të Venetikut vdesin për të, po ajo s'u këthen syrin aspak dhe s'do të martohet me asnonjë prej syresh. Brabanti, i ati i saj, s'e shtrëngon për martesë, se e ka të vetmen bijë. Desdemona, pra lihet e lirë të pëlqejë e të zgjedhë vetë burrin e saj, dhe Desdemona zgjeth Othellon. I ati i saj e ftonte shpesh në shtëpi të tij gjeneralin arap dhe i pëlqente të dëgjonte trimëritë dhe aventurat e tij. Desdemona në krye¹⁴⁾ kishte frikë prej këtij arapi të zi si pisa, po kur pa që ishte njeri zemërbardhë dhe fisnik, nisi t'i afrohet dhe t'i vërë veshin, kur tregonte historitë e tij. Qe një histori trimërirash, rrezikesh, arratirash dhe vuajtjesh të çudiçme, që e bënë Desdemonën të derdhë lot fshëhurazi. Desdemonës i vinte keq për këtë të huaj të arratisur që vuajti dhe po vuante kaq shumë; qe çapi i parë i dashurisë. Desdemona çuditej për trimërinë e këtij gjenerali të dëgjuar; qe çapi i dytë i dashurisë. Othellua qe i zi nga fytyra, po qe i math, bujar dhe i bukur nga shpirti dhe nga zemra; Desdemona e barabiti¹⁵⁾ me bukuroshët shpirtljepur që i vinin rrotull dhe iu mbush mëndja që Othellua s'kishte shok në Venetik; qe çapi i tretë dhe i funtmë i dashurisë. Arapi qe më trim dhe më i bukur nga të gjithë. Ky qe burrë për të. Po historinë e tij s'pati rasje¹⁶⁾ ta dëgjojnë mirë, se shumë herë, kur e tregonte Othellua, ajo dilte jashtë për punë shtëpiake. Një ditë, pra, iu lut t'ia tregonjë këtë histori, të cilën e kish dëgjuar vetëm copra-copra. Othellua ia tregoi që në krye e gjer në fund. Kur e mbaroi, Desdemona, me lot në sy, u sul dhe e puthi disa herë. I tha që historia e tij qe e çudiçme dhe për të derdhur lot pa masë, i tha që do të ish më mirë për të, të mos e kish dëgjuar, po që dëshironte të ish lindur jo vajzë, po burrë si Othellua, pastaj iu fal nderit dhe iu lut Othellos që, po të kishte nonjë mik, i cili të kishte rënë në dashuri me të (me Desdemonën), t'ia dërgonte, pasi t'i

mësonte qysh ta tregonte historinë e tij, se kjo mjaftonte që t'i fitonte zemrën. Ahere Othellua kuptoi dhe i foli, Desdemona e deshte Othellon. Po kish një ndalim¹⁷⁾ të pakapërçyer për martesën e tyre. Brabant, senatori i Venetikut, do mos t'ia jipte kurrë vajzën e tij një arapi të arratisur. Këtë ndalim e kapërceu Desdemona, duke ikur natën nga shtëpia me një gondolë¹⁸⁾ dhe duke vajtur në Shigjetore, ku e priste Othellua.

Kjo martesë munt të qe shumë e lumur, dhe Desdemona me Othellon mund të trashëgoheshin e të mplakeshin; po Othellua kish një armik të fortë, i cili ish betuar t'ia mernte gjakun. Ky qe Jagua, rreshteri¹⁹⁾ i tij. Jagua kishte disa shkake zemërimi kundër Othellos. Flitej në Venetik që Othellua kish fjetur me të shoqen e Jagos. Kjo s'ishte e vërtetë, po dyshimi vetëm i arrinte Jagos që t'i futë Othellos idenë që edhe atë e gënjen e shoqja me një tjetër. Po shkaku i vërtetë i armiqësisë së Jagos është se Othellua nuk bëri atë lëftënar (mylazim²⁰⁾ po një florentin²¹⁾ të quajtur Kasi. Jagua nis intrigat e tij që ta hedhë poshtë Kasin e t'i zërë vendin. Bën planin, pra, t'i futë Othellos në kokë idenë që Kasi i turpëron të shoqen. Këtë plan e vë në punë me aq mjeshtëri dhe ia mbush mendjen Othellos aq plotësisht që Desdemona e gënjen me Kasin, sa Othellua ngarkon Jagon ta vrasë Kasin dhe ay vetë e mbyt Desdemonën. Karakteri i Jagos është aq i lik, sa shumë kritikë thonë që s'ka në botë njeri kaq të poshtër dhe shpirtzi dhe që Jagua është një djall në formë njeriu. Ligësia e tij do të ishte me të vërtetë e paduruar, po të mos ishte e bashkuar me një hollësi mendjeje, thellësi psikologjike dhe mjeshtëri intrige të rrallë dhe të çudiçme. Nga mëndja, Jagua është i pari në këtë tragjedi dhe gjithë të tjerët s'janë veç vegla të tij të verbra, që i lot si të dojë dhe i heq si gomarë nga kapistalli. Mënyra methodike²²⁾ dhe shkencore, me të cilën i kall zilinë²³⁾ Othellos, nuk mund të kapërcehet as prej djallit. Mënyra me të cilën i përdor të gjithë për qëllimet e

tij është mjeshtërake dhe e hollë pa masë. Nis duke i dhënë zë Brabantit që Othellua i vodhi të bijën dhe kështu i fiton zemrën Roderigut, i cili deshte Desdemonën, dhe, nga ana tjetër, vete i jep zë Othellos të ruhet se vjen Brabanti që t'ia rrëmbenjë Desdemonën nga duart dhe kështu i fiton zemrën Othellos, duke i dhënë të besonjë që i shërben si njeri i besës. Kur shkon Othellua prej Venetikut, ngarkon Jagon që t'i sjellë të shoqen në Qipro. Këtu prapë Jagua deh Kasin dhe shtyn Roderigun të zihet me të. Ngre një shamatë, ia ngarkon fajin Kasit dhe e bën Othellon ta nxjerrë nga puna. Pastaj këshillon Kasin që t'i thotë Desdemonës t'i lutet Othellos që ta thërrresë prapë në punë, nga ana tjetër, merr Othellon, e shpie mu në çast kur Kasi i lutet Desdemonës dhe i fut Othellos idenë që Desdemona dhe Kasi duhen. Që ta provojë, merr nga Emilia shaminë, të cilën e ka humbur Desdemona, dhe ia jep Kasit, dhe kjo shami në duart e Kasit është prova që ia mbush mendjen Othellos që e shoqja e tij e do Kasin. Qysh me një shami i zë të gjithë në grackë, është mjeshtëri e Jagos. Gjer më një pikë, Jagua e gjen fushën të gatitur për intrigat nga rasjet dhe nga njerëzit me të cilët ka të bëjë, po pa dyshim di dhe ai vetë t'i përdorë sa s'bëhet më mirë.

I pari që i ndih për të futur në zemër të Othellos zilinë dhe dyshimin për të shoqen është i ati i Desdemonës. Ky i thotë Othellos t'i ketë syrin gruas, se një vajzë që gënjen t'anë, do të gënjejë dhe të shoqin. Kjo ishte shigjeta e parë, të cilën Jagua ia fut Othellos më thellë në zemër. Një vajzë, i thotë, që fshehu aq mirë dashurinë që i kish Othellos nga i ati, sa ky kujtonte që arapi i shtiu magji dhe e gënjeu, duhet të jetë shumë dinake, hipokrite dhe e djallëzuar.

Othellua është njeri i drejtë dhe i padjallëzuar dhe e pandeh Jagon të nderçëm dhe të besës. Askurrë s'i shkon nga mendja që Jagua e gënjen. Duke e mejtuar, pra, i duket si çudi që një vajzë nga një shtëpi e madhe e Venetikut si Desdemona të mos martohet me

një njeri të vendit dhe të shkallës së saj, po të ikë me një arap të huaj. Kjo është fare kundër natyrës, i thotë Jagua, dhe shton që tani ndofta e ktheu mendjen dhe nisi dashuri me Kasin, i cili është i ri, i hieshim, dhe ka gjithë sendet që u pëlqejnë grave.

Desdemona është dhe ajo aq e padjallëzuar dhe aq mëndjefoshnjë sa, në vend që t'i shuajë Othellos zilinë që i ndez Jagua në zemër, ajo me sjelljen e saj hedh vaj mi zjarrin²⁴) dhe e shtyn punën atje ku do Jagua. Është aq shpirtëngjell, sa s'di që bëri faj, dyke marrë një burrë pa lejen e babait të saj, të cilit ia helmon jetën në pleqëri dhe e dërgon në varr përpara kohës. Gjëra të koklavitura s'mund t'i kuptonjë, se është çilimi nga mendja ose, më mirë, si thomi shqip, «dele e perëndisë». Zemërbardhësia e saj i bën varrin. Kërkon t'i bëjë një të mirë Kasit, që Othellua e ka nxjerrë nga puna, dhe i lutet burrit saj që ta thërresë prapë: nuk kupton që Othellua është zilar dhe që sa më tepër i lutet ajo, aq më tepër i mbushet koka atij që Desdemona e do Kasin. Hollësia²⁵) dhe takti i mungojnë fare. Pastaj, kur Othellua i thotë drejt në sy që ka dyshime për nderin e saj, Desdemona s'di si të mprohet, veç duke thënë që s'ka bërë kurrë nonjë faj. Natën e funtme, kur Othellua, vete ta mbytë, dhe Desdemona e di fort mirë që i shoqi i saj do ta vrasë, se beson që e turpëroi me Kasin, në vent që të mejtohet për të shpëtuar jetën e saj, bën lajthimin e trashë të qanjë për vrasjen e pabesë të Kasit, vrasje të cilën e bëri Jagua, i shtyrë prej Othellos. Atherë Othellos i mbushet fare mendja që Desdemona e deshte dhe s'i jep më asnjë minutë kohë që të falet, po e mbyt në çast. Desdemona është aq shpirtmirë, sa dhe kur vdes, prapë kërkon të shpëtonjë burrin e saj, duke thënë që ajo vrau vetveten.

Fajtoje për vrasjen e Desdemonës është, padashur, dhe e shoqja e Jagos, Emilia. Kjo ia jep Jagos shaminë e Desdemonës dhe, ndonëse pastaj sheh që tërë zihja²⁶) bëhet për atë shami, prapë, nga mendjelehtësi e saj dhe ngaqë s'kupton sa janë ashpërsuar punët,

nuk dëftën si është puna e shamisë që i ra në duar Kasit. Po në fund rrëfen të vërtetën dhe vdes që të dalë e drejta në shesh.

Othellua, kur mëson të vërtetën, vret veten, se jeta tani është një mundim për të. Humbi Desdemonën dhe nderin me ato që bëri. I pari kujdes në tërë jetën e tij që nderi i tij i veçantë dhe nderi i Republikës së Venetikut. Për nderin e tij vrau Desdemonën, të cilën nuk do ta kish këmbyer për një botë të artë; për nderin e Republikës luftoi tërë jetën e tij, për nderin e tij tani vret veten. Prandaj në fjalët e tij të funtme u përmend të dërguarve të Venetikut që vrau në Halep një turk, i cili rrihte një venetikas dhe çnderonte Republikën. Këtë gjë s'e rrëfen më kot, a që të mburret, po që të provojë që, si ahëre dhe tani, i pëlqen më mirë vdekja se një jetë pa nder. Dhe me atë zemërim që vrau në Halep një armik për të shpëtuar nderin e Republikës, ashtu dhe tani vret veten për të shpëtuar nderin e tij.*)

1. **Inglisë** — Anglisë (ndryshe quhet edhe Inglitera ose Britania e Madhe).

2. **Kumpanja** — shoqëri, grup (teatral)

3. **Elisabeta** — Mbretëresha e Anglisë prej vitit 1558-1603.

4. **Stratford Çerç** — Kisha e Stratfordit

5. **gravurë** — lloj vizatimi që bëhet me gdhendje në sipërfaqen e një sendi prej metali, guri, druri etj.

6. **folio** — faqja ose fleta e një libri

7. **pas mendjes së përgjithshme** — sipas mendimit më të përgjithshëm

8. **Mavritania** — shtet në Afrikë që shtrihet ndërmjet Algjerisë, Malit, Senegalit dhe Saharës Perëndimore.

9. **Rolet e para** — rolet kryesore

10. **mbretëresha e deteve** — zotëruese e deteve d.m.th. që kishte flotën luftarake më të fortë.

11. **të zi** — këtu zezak (në kuptim përbuzës)

12. **senator-i** — anëtar i senatit, organit më të lartë shtetëror në Romën e vjetër

13. **shok me të parët** — shok me parësinë, i barabartë me parinë e Venetikut

14. **në krye** — këtu: në fillim

15. **e barabiti** — e barazoi, këtu: e krahasoi (e vuri ballë për ballë)

16. **rasje** — rast, mundësi
17. **ndalim-i** — këtu: pengesë
18. **gondolë** — varkë e gjatë dhe e lehtë veneciane me një kabinë në mes
19. **rreshteri** — gradë nënoficeri në ushtri, këtu: ordinancë
20. **lëftënar-i (mylazim)** — toger, këtu: ordinancë
21. **florentin** — fiorentin, nga Firencia
22. **mënyra methodike** — metoda që përdor, rruga, intrigat që thurr
23. **zili** — këtu: xheloz
24. **hedh vaj mi zjarrin** — hedh benzinë në zjarr, e ndes më tepër (në vend që ta shuajë).
25. **hollësia** — këtu: mprehtësia, zgjuarsia për të kuptuar intrigat, shpifjet, kurthet që ngrihen kundër saj (Desdemonës).
26. **zihja** — zënia, grindja, këtu: ngatërresa, shamata...

Hamleti*

«Hamleti, Princ i Danemarkës», tragjedia më e famëshme e Uilliam Shekspirit, është shkruar, sikundër besohet përgjithërisht prej kritikëve, më 1601-1602 mi bazën e një sage daneze¹⁾, të marrë nga Saxo Grammaticusi a nga Belleforesti, po të ndryshuar, të çvilluar e të zbkuruar me një mjeshtëri aq të çuditëshme, sa mund të quhet vepra teatrale edhe më popullore, edhe më e thellë që luhet mi skenë.

Subjekti i thatë me pak fjalë është ky: Klaudi

*) Dhjetë vjet pas introduktës për «Otellon», Noli shkruan introduktën e dytë po për një vepër të Shekspirit, për «Hamletin, Princin e Danimarkës». Kjo introduktë sipas një shënimi që ka bërë vetë Noli, u shkrua në Berlin dhe u botua për herë të parë si parathënie e tragjedisë «Hamleti — Princi i Danimarkës», që u shtyp në Bruksel më 1926. Në këtë introduktë Noli, përveç dëshirës për ta lexuar veprën, synon t'u ngjallë njerëzve të thjeshtë shqiptarë edhe interesin për ta shikuar atë në skenë, sidomos kur ajo interpretohet nga aktorë që e ndjejnë thellë rolin që luajnë. Është kjo një rrugë tjetër që Noli e shikon me efektivitet për emancipimin kulturor të popullit tonë. Në këtë introduktë, si dhe në ato që do të shkruajë më vonë, mendimi letrar i Nolit ngrihet në një shkallë të re. Ai tashmë nuk kufizohet në shpjegimin e brendisë dhe të ideve të veprës, siç bëri te «Otelloja», por thellohet në analizën e personazheve, duke i lidhur ngushtë me kushtet ekonomiko-shoqërore, sociale e historike etj. Gjykimet e tij janë serioze, të guximshme e bindëse, gjë që tregon se përvoja dhe pjekuria e tij kanë arritur në një stad të ri, më të lartë, ashtu siç dëshmon edhe krijimtaria e tij, sidomos vjershat që lidhen me ngjarjet politike të viteve 20 në Shqipëri. Në këto gjykime ai u kundërvihet dhe polemizon me dinjitet edhe me kritikë e letrarë të njohur të kohës.

ka vrarë në gjumë mbretin Hamlet të Danimarkës, është martuar me të shoqen e tij dhe i ka rrëmbyer fronin princ Hamletit, të nipit të vet. Princ Hamleti informohet për këtë krim prej fantazmës së të atit dhe i betohet t'ia marrë gjakun. Për të arrirë qëllimin pa vënë të ungjin në dyshime, Hamleti bën sikur është i marrë dhe, pas disa peripecirash, mbaron zotimin plotësisht.

Detyra e princ Hamletit është e çkoqur²⁾. Pas zakonit medieval³⁾ ka detyrë t'ia marrë gjakun të atit të vrarë me të pabesë; pas nderit ka detyrë ta çkëputë të ëmën nga krahët e atij që vrau të shoqin e parë; pas kanunit të shtetit⁴⁾, si princ trashëgimtar dhe si mbret legjitim i Danimarkës, ka detyrë të punitë⁵⁾ një krim të poshtër dhe të hipë mi fronin atëror që i përket dhe që ia ka rrëmbyer një uzurpator, pas ligjës natyrale të vetëmprojtjes, ka të drejtë të spastronjë atë që i vë pusi ta vrasë dhe atë vetë, si dhe të atin; pas ndërgjegjies, ka të drejtë dhe detyrë ta çlirojë vendin e tij nga një tiran gjakatar dhe t'i japë një mbret të paqme dhe të drejtë. Po sa e rëndë është kjo detyrë për Hamletin, na e thotë ai vetë në vargjet pasonjëse, që përmbledhin tërë tragjedinë e shpirtit të tij:

«Kjo botë u çthur! O prapësi, o dreq,
që unë paskam lindur të të ndreq!»

Nga pikëpamja e tij, ka plotërisht të drejtë. Kishte jetuar gjer ahëre i çkujdesur në universitet të Vitenbergut midis librave, studimeve të larta dhe arteve të bukura, ishte djali i përkëdhelur i një mbreti heroik pa shoq nga trimëria dhe mirësia; ishte princi trashëgimtar ideal, i adhuruar prej popullit dhe i pajisur me të gjitha cilësitë dhe virtytet morale dhe intelektuale; kishte të dashur Ofelinë, vajzën më shpirtmirë dhe engjëllore të mbretërisë; nga maja e fronit ku lindi, s'kishte parë veç lumëritë, bukuritë dhe madhësitë e natyrës e të njerëzisë. Dhe befaz për këtë shpirt, delikat nga edukata, vjen katastrofa dërrmo-

njëse dhe i përmbysset bota mi kokë. Tani sheh anën tjetër të medaljes. Vëllai vret të vëllanë dhe i rrëmben të shoqen; e çma mëndjelehtë martohet me vrasësin e të atit; i ungji vrasës uzurpon fronin e të nipit; e dashura e tij e padjallëzuar, pa ditur e pa dashur vihet në shërbim të uzurpatorit që ta spiunojë; miqtë dhe shokët e djalërisë i vënë gracka dhe pusira; populli i falet një mbreti kriminal; është i vetëm, i neveritur dhe i përgjuar prej të gjithëve; është i shtrënguar jo vetëm të lërë universitetin, librat, studimet dhe artet e bukura, po dhe të fshinjë nga shpirti çdo ideal tjetër dhe të çkulë nga zemra dashurinë për Ofelinë, që kështu të koncentronjë⁶⁾ tërë vullnetin dhe energjinë për të mbaruar një detyrë të hidhur e të rëndë. Tani sheh poshtërsinë njerëzore në tërë shëmtimin e saj. Danimarka, e bukur si parajsë, i duket si një burg. Bota, kryevepra madhështore e krijatorit⁷⁾ iu nxi si pus e ferr. Jeta s'i ka më asnjë vlerë. Një pesimizmë e thellë ia thyen zemrën, ia turbullon kokën dhe ia err sytë. Dyshimi për veten e për të tjerët, për jetën e për botën ia mpin shpirtin e trupin. Vullneti dhe energjia i tronditen që nga themelitet. I dëshpëruar, i demoralizuar, i paralizuar, me makthin⁸⁾ në grykë, s'ka forcën as të rronjë as të vrasë veten. Që kur e pa fantazmën e të atit, baret si noktambul⁹⁾ dhe është bërë fantazmë dhe ai vetë. Fati, pasi e çthur gjithësej, i ngarkon barrën e tmerruar të ndreqë një gjendje gjithësej të çthurur.

Arësyeja kryesore e vojtjeve të Hamletit duhet kërkuar më tepër në ndjenjën që ka pësuar një tronditje fatale për vdekje se sa në ndjenjën që është i pazoti për punë e vepërim. Për të kuptuar mirë sjelljen e tij, duhet të dimë që kemi përpara nesh një të sëmurë me ethe, i cili është ngritur me pahir nga shtrati për të mbaruar një detyrë të shenjtë, i cili gjysmë në ëndërr, i këputur e me shpirt nër dhëmbë, përpiqet me qip e me thonj¹⁰⁾ të ngjitet zvarrë, përpiqet në majën e bregut para se të rrëzohet përdhe pa frymë. S'është as i gjallë, as i vdekur; as i marrë,

as nër mënt; as i zgjuar, as i fjetur tamam; ndodhet buzë vdekjes, buzë vetëvrasjes, buzë marrësisë, buzë greminës, ku e di që shpejt a vonë do të përmbysset e do të copëtohet. Mëndja e tij banon në varresat, midis fantazmave, skeleteve dhe kafkave grimacante¹¹). Që të mos marroset, e të mos vrasë veten, e të mos pëlcasë nga e keqja, duhet të koncentronjë tërë vullnetin dhe energjinë e tij, duhet ta frymëzonjë kufomën e tij me gjallësi, duhet ta çponjë pa pushuar me yzengji¹²) të përgjakura kalin e tij të ngordhur për një sulmë sipërnjerëzore¹³).

Ajo që ia bën situatën më të zorshme dhe më të koklavitur është ndërgegjësia¹⁴) e tij. I bie erë që në krye që vdekja e të atit nuk ishte natyrale, po do prova të gjalla dhe të sigurta. Nuk bindet plotërisht as pasi i flet fantazma e të atit dhe kërkon një provë të dytë nga keqbërësi vetë me anën e një drame. Kur s'i mbetet asnjë dyshim për fajësinë e të ungjit, pret gjersa t'i gjenjë rasjen ideale që ta vrasë. Nuk e nget më të falur e sipër, se është thëllësisht fetar, se kështu i ungji mund të shkonte përpara perëndisë i penduar dhe i zbardhur nga krima¹⁵) e tij. E vret kur i gjen rasjen më të mirë, kur është i nxirë në sytë e perëndisë e të botës si vrasës dhe helmonjës i pabesë. Gjakmarrja e tij është një vepër arti, një kryevepër nga fryma dhe nga forma.

Disa kritikë letrarë, që nga Gëteja e këtej, kanë pretenduar që Hamleti e vonon mbarimin e detyrës së tij ngaqë s'është njeri i punës, ngaqë s'ka asnjë prej virtyteve praktike, ngaqë i mungon zotësia të bënë një plan e ta verë në vepërim, dhe që nuk vepëron veç në rasje shtrëngese të pazakonëshme¹⁶). E vetëma bazë për këto gjendet në qërtimet që i drejton vetvetes Hamleti. Po këto vetëqërtime janë të eksagjeruara dhe kundërshtohen prej fakteve. Hamleti e mbaron detyrën e tij brenda në një kohë jo më të gjatë se katër muaj që ditën që u duk fantazma, dhe pikërisht në rasjen që kishte caktuar vetë, domethënë kur ta gjente të pirë dhe të ngarkuar me mëkate. Nga

këta të katër muaj duhet të zbresim të pakën dy të parët, kur Hamleti kishte dyshime mos fantazma ishte një instrument e një grackë e djallit; na mbeten pra të shumën dy muaj që kur Hamleti u bind plotërisht nga drama e vëllavrasjes, e lojtur prej aktorëve, që i ungji me të vërtetë ia kishte varrë të atin; dhe këta dy muaj janë një kohë shumë e shkurtër për të varrë një mbret kryedinak e për të zaptuar një fron. Për të arrirë qëllimin, Hamleti fshin e shuan nga zemra e do ideal tjetër dhe sakrifikon edhe të dashurën e tij. Ofelinë, nga frika se mos kjo dashuri i sjell nonjë ndalim, dhe kjo tregon një njeri egërsisht praktik. Për të vënë mbretin në gjumë, vë maskën e të marrit, dhe e lot këtë rol aq mirë saqë të gjithë gënjehen dhe e besojnë me të vërtetë të marrë. dhe kjo tregon një zotësi praktike dhëpërie dhe vetëkontrollimi në shkallën më të lartë. Gracka e dramës së vëllavrasjes, me të cilën e kap mbretin si një mi dhe ia çkëput sekretin e tmerruar. tregon që Hamleti është çuditërisht i zoti të bëjë një plan e ta vërë në vepërim aq hollë e aq thellë nga pikëpamja psikologjike sa gjykatësi kriminalist¹⁷) më praktik e më modern. Mënyra me të cilën dërgon në vdekje Rozenkracin dhe Gildensternin, kur këta e përcillnin në vdekje atë vetë, provon që Hamleti ka dy cilësira praktike kryesore në shkallën më të lartë, gjakftohtësi në kohë të rrezikut dhe shpejtësi rrufesore¹⁸) vendimi dhe vepërimi. Mieshtëria superiore¹⁹) e përdorjes së shpatës, me të cilën e shtrin Laertin përdhe. para se të rrëzohet vetë, kur Laerti s'ka carë kokën për gjë tjetër. tregon që Hamleti. ndonëse ka studiuar fillosofi, letrëtvërë²⁰) dhe art në universitetin e Vitenbergut. prapë është i gatitur për luftën e jetës praktike në një botë violente²¹) me një mënyrë më perfekte²²). Trimëria, gjakftohtësia dhe shpejtësia, me të cilat përmbys mbretin në grackën e tij. para se të bjerë ai vetë brenda, ndonëse është i helmuar. me njërin këmbë në varr e me shpirtin nër dhëmbë. janë maia e zotësisë në vepërim dhe arrijnë kulmin e heroizmës legjendare. Argumenti që Ham-

leti nuk vepëron veç në rasje shtrëngese mund të kthehet fare lehtë në favor të tij, veçanërisht kur të vihet re sa mirë di të përfitonjë nga këto rasje dhe t'i kthenjë kundër armiqve të tij. Kur të shtohet fakti, i shpjeguar më lart, që Hamleti është gjysmë i sëmurë, arrijmë lehtë në konkluzion që bëri të pamundurën të mundur në rasjet më të liga dhe e mbaroi detyrën me një mënyrë të shkëlqyer, të cilën mund ta dorëtrokasim pa shumë rezerva.

Nga të sipërmet mund të marrim me mend çfarë vigan do të bëhej Hamleti, sikur ta kishte lënë fati të çvillohej në kondita dhe rasje normale. Është një moskuptim pa vënd të besohet vetëm si intelektual e aspak si njeri i punës. Hamleti është, ashtu si e përshkruan Ofelia «oborrtar, shkollar, ushtar», domethënë, njeriu i mënyrave elegante, njeriu i mëndjes së lartë, njeriu i rreptë i luftës. Si «Princi» i Makiavelit²³) është dhelpër e luan. Është princi ideal i Përlindjes Ingлизе²⁴), heroik dhe fetar nga instinkti, intelektual dhe skeptik²⁵) nga edukata, në funt të kohës së mesme dhe në krye të kohës moderne. Kështu kanë qenë shumica e prindërve të shkëlqyer të kësaj periude, ëndërronjës, poetë dhe artistë nga njëra anë, dhe nga ana tjetër politikanë dinakë dhe të rafinuar, njerës të punës, të mprehtë dhe brutalë. Hamleti është piktura më e pasur dhe më e thellë që ka dalë nga penda e Shekspirit, i cili në fytyrën e tij ka pikturuar vetveten. Duke mbajtur mend që në galerinë shekspiriane s'ka pikturë të vogël, kuptohet sa rëndë është të cmojmë nga të gjitha pikëpamjet pikturën më të madhe, ku dramatishti ka vënë tërë mjeshtërinë, ku ka derdhur tërë mendjen, tërë shpirtin e tërë zemrën. ku ka hedhur dritat më të shkëlqyera dhe hiet më të errëta. A më mirë Hamleti është dushku më i lartë dhe më i bukur i pyllit shekspirian, po nuk e shohim veç pasi u copëtua prej rrufesë. Si ka qenë përpara katastrofës, mund ta imagjinojmë nga gërma-dhat e tij madhështore, misterioze dhe tragjike.

Ofelia, e dashura fatzezë e Hamletit, është nga

fytyrat më tragjike dhe më pathetike të theatrit shekspirian. Si Hamletit, ashtu dhe Ofelisë i është përmbysur bota mi kokë. Sikur të kishin marrë punët një udhë normale, Ofelia do të bëhej mbretëresha e lumur e Danimarkës, pranë të dashurit të saj, pranë një mbreti ideal. Që kjo nuk ishte një ëndërr pa bazë, provohet në varrim të saj, ku mbretëresha nga njëra anë e qan si nusen e pritme të birit të saj, Hamlet, dhe nga ana tjetër Hamleti vetë, si përgjigje në vajtimet e Laertit, të vëllait të Ofelisë, deklaroi që ay e kishte dashur me dashurinë e detyrimit të vëllezërve. Ofelia priste me siguri të hipte në kulm të lumërisë e të lavdisë, kur fati me një shkellë brutale e rru-kullis tatëpjetë në mjerim, në marrësi e në varr. Ofelia nuk i kupton aspak arësyet e ndryshimit tragjik të Hamletit, po di mirë që u bë një ndryshim themeltar, të cilin na e përshkruan fare bukur, dhe ndien në zemër të saj që nga ky ndryshim iu përpinë të gjitha shpresat e së pritmes dhe që jeta e saj u dërrmua dhe u copëtua. E pa Hamletin si trimin ideal të kohës së saj dhe tani e sheh të marrë; ia thëthiti mjal-tën nga goja dhe tani ia pi vrerin; ia dëgjoi një herë zilen e ëmbël e cila ia çjerr veshët tani e çarë, e ngjirur, çtingëllonjëse. E pa kulmin ku arriu e ku do të arrinte Hamleti dhe tani sheh avushën²⁶) ku u rrugullis duke e zvarnisur dhe atë bashkë tatëpjetë në greminë. Pas kësaj katastrofe është një shpëtim, si për Ofelinë dhe për Hamletin, që vdesin, se jeta do të ishte për të dy një torturë e padurueshme.

Aq sa shëmbëllen Ofelia me Hamletin sa për tron-ditjen e shpirtit, aq ndryshon i vllai-i saj Laerti, nga Hamleti sa për mënyrën me të cilën ia merr gjakun të atit, Pollonit, hoborrtar, këpucëlëpirës, gjysmëspiun, gjysmëpalaço, gjysmëçilimi. Për të nisur, baza morale e gjakmarrjes së Laertit është e dyshimtë, se i ati u vra prej Hamletit me lajthim, kur e spiunonte dhe i vinte pusi. Kur Hamleti, para se të vepëronjë, sigurohet absolutisht si dhe prej kujt iu vra i ati, Laerti s'pyet as si, as prej kujt, po duke u pështetur mi te-

vaturin²⁷⁾, kujton se vrasësi është mbreti dhe vërvitet kundër tij si dem i tërbuar, dhe kur mbreti i pëshpërit në vesh që vrasësi është Hamleti, gatitet t'i vërvitet Hamletit pa e thelluar punën aspak. Kur Hamleti i sheh rreziket hollësisht dhe, pasi i merr të gjitha në sy, sulet midis tyre, duke ditur ku vete, Laerti është trim, se nuk i sheh rreziket dhe s'di as ku futet, as ku do të dalë. Kur Hamleti njihet njerëzit, me të cilët ka të bënjë, është i zoti t'i lozë si cingla²⁸⁾ dhe di që në fytyrën e mbretit ka një armik kryedinak, kundër të cilit duhet proceduar me mend, Laerti bën një kryengritje, triumfon dhe e ka në dorë ta vrasë mbretin, po ky, ndonëse i çarmatosur, e fut në grackë Laertin dhe e bën vegël të verbër për të vrarë Hamletin. Kur Hamleti refuzon ta ngasë mbretin më të falur e sipër nga ca skrupulla²⁹⁾ fetare, Laerti është gati ta vrasë Hamletin edhe në mes të kishës. Kur Hamleti e vret mbretin hapur e burrisht, Laerti i vë pusi Hamletit dhe e vret me të pabesë. Kur Hamleti del faqebardhë nga vepra e gjakmarrjes përpara perëndisë dhe njerëzisë, Laerti del i nxirë nga të gjitha pikëpamjet dhe, para se të vdesë, i kërkon ndjesë Hamletit. Pas këtyre të gjithave është një tjetër moskuptim i çuditëshmë mejtimi i disa kritikëve, të cilët besojnë që Shekspiri na e paraqet Laertin si njeri më të zotin e punës se Hamleti. Është e vërtetë që, gjersa të mejtohet Hamleti i mençur. Laerti budalla e ka mbaruar punën, po e mbaron liksht dhe bie në gropën që mihu për Hamletin ai vetë i pari, i mundur, i turpëruar dhe i penduar për veprën e tij, të cilën e ka si barrë në zemër. Cili nga të dy është më i zoti i punës, na e tregon mbreti, i cili i njihet të gjitha kryengritës, s'ia ka frikën fare, e përball me siguri absolute dhe brënda në ca minuta e shtie në thes, po e zë data nga Hamleti qëkur i bie erë që nuk është i marrë me të vërtetë, s'guxon ta përballë si burrë, dhe i vë gracka të pabesa që ta vrasë prapa kurrizit.

Midis Hamletit të tronditur dhe Laertit të marrosur qëndron fytyra stoike³⁰) dhe romane³¹) e Horatit. Ndonëse i varfër, nuk hidhet nga ana e fuqisë, po nga ana e së drejtës, jo i ftuar dhe i lutur, po vetvetiu, vullnetar fisnik, pa kërkuar e pa pritur asnjë çpërblim. Merr përsipër me gjakftohtësi dhe trimëri heroike detyrën e rëndë, që ia ka caktuar vetvetes dhe, mik i patundur e i patrembur, futet në të gjitha rreziket pranë Hamletit, të neveritur dhe të përgjuar prej të gjithëve. Nuk flet shumë, nuk qahet fare, rrallë këshillon. Në një oborr të lyer me gjak dhe të kalbur nga veset, është personifikata e kthjellësisë dhe e virtytit; në një rrethim pabesie dhe poshtërsie, është she mbëlla e besnikërisë, e nderit dhe e dinjitetit. Ideali i tij është ta përkrahë Hamletin në mjerim e t'ia lehtësonjë vojtjet. Kur e sheh mikun më të vdekur e sipër, jeta i duket pa nonjë qëllim dhe do edhe ai të vdesë bashkë me të. Nuk e bën vetëm e vetëm për të mbaruar dëshirën e funtme të Hamletit, i cili e porositi të rronjë për t'i shpjeguar botës tragjedinë e tij. Ngushëllimi më i thellë për këndonjësin e kësaj tragjedie është që paska në botë shokë dhe miq gjer në vdekje si Horati.

Për të kuptuar mirë këtë vepër, si dhe çdo tjetër vepër shekspiriane, duhet mbajtur mend, që është shkruar kryesisht për t'u lojtur mi skenë. Duhet kënduar pra me vërejtje nja dy herë dhe pastaj duhet parë e interpretuar në theatër prej aktorësh, që i kanë hyrë brenda në frymë³²). Shpjegimet elementare, të dhëna këtu, nuk mund të shërbejnë shumë veç në qoftë se ia zgjojnë këndonjësit kureshtin ta shikonjë, ta shijonjë e ta gjykonjë vetë. Nga ana tjetër, është e ditur që interpretata e një artisti të fortë vlen më tepër se qindra kritikash e shpjegimesh prej savantësh³³) të specializuar.

1. **Sagë daneze** — këngë popullore e përhapur sidomos në vendet Skandinave e në Islandë në Mesjetë.

2. **e çkoqur** — e qartë

3. **medieval** — mesjetar, të mesjetës (kur zhvillohet ngjarja në vepër)
4. **kanuni i shtetit** — zakon, këtu: ligj i shtetit
5. **të punitë** — të dënojë, të ndëshkojë
6. **të koncentrojnë** — të përqendrojnë, të grumbullojnë
7. **krijatorit** — krijuesit, këtu: zotit
8. **makthin (në grykë)** — me ankth; në përrallat popullore makthi përfytyrohet si njeri që vjen natën e të zë frymën.
9. **noktambul** — somnambul; njeri që ngrihet nëpër gjumë dhe bën veprime e lëvizje të pavetëdijshme
10. **me qip e me thonj** — me sqep e me thonj, d.m.th., bën të gjitha përpjekjet e fundit, përpjekje jashtë forcave të veta.
11. **kafka grimacante** — kafka që ngërdheshen
12. **yzengji** — pjesa metalike ku vendos këmbët kalorësi dhe që i përdor për të nxitur kalin që të ecë shpejt.
13. **sipërnjerëzor** — mbinjerëzor
14. **ndërgjegjësia** — ndërgjegjja, vetëdija
15. **i zbardhur nga krima** — i larë nga krimi, i pafajshëm
16. **në rasje shtrëngese të pazakonshme** — në raste të jashtëzakonshme
17. **gjykatësi kriminalist** — ai që studion metodat dhe mjetet e hetimit
18. **shpejtësi rrufesore** — shpejtësi të rrufeshme
19. **superiore** — në një shkallë shumë të lartë
20. **letërryë** — letërsi
21. **violente** — me forcë, me dhunë
22. **perfekte** — të përkryer, të përsosur, mjeshtërore
23. **Makiaveli (1469-1527)** — personalitet politik, shkrimtar e filozof italian, i njohur për teorinë e tij reaksionare që qëllimi justifikon mjetin. Prej emrit të tij ka dalë edhe fjala **makiavelizëm** — metodë qeverisjeje pa skrupuj e pa moral, sjellje tinzare, e pasinqertë etj.
24. **i Përlindjes Ingлизe** — i Rilindjes Angleze
25. **skeptik** — njeri që nuk beson për vërtetësinë ose mundësinë e kryerjes së diçkaje.
26. **avushën** — honin, humnerën, gremenën
27. **tevatari** — fjalë të shumta që thuhën poshtë e lart, gojë pas goje.
28. **cingla** — shkopinj të vegjël me majë nga të dy anët që i përdorin fëmijët për të lojtur.
29. **skrupulla** — ngurim, ndruajtje për të mos bërë diçka në kundërshtim me rregullat ose moralin e shoqërisë.
30. **stoike** — e vendosur
31. **romanc** — romantike, ëndërrimtare
32. **që i kanë hyrë brenda në frymë** — që e ndjejnë rolin, që i jetojnë të gjitha emocionet e personazheve ashtu sikur t'i ndodhin vetë atyre.
33. **savantë** — dijetarë

Makbethi*

Asnjë vepër tjetër teatrale nuk përmbledh në një vend aq të ngushtë një gjëmë aq të madhe prej ngjarjesh tronditëse dhe ngjethëse sa «Makbethi», tragjedia më e tmerruar që ka dalë nga pënda demoniake¹⁾ e Shekspirit. Besohet që është shkruar afro më 1605, po sidomos jo përpara motit 1603 dhe jo pas motit 1610. Subjekti është marrë nga «Kronika» e Holinsheedit, po është trajtuar e çvilluar pa marrë shumë në sy hollësitë historike. Mund të gjykohet e të admirohet nga disa pikëpamje të ndryshme, po veçanërisht nga këto të tria që pasojnë:

*) *Introdukta për tragjedinë «Makbeth» u shkrua si parathënie e botimit të parë të kësaj vepre që u bë në Bruksel më 1926. Vetë tragjedia dhe gjykimet me të cilat Noli ia prezanton lexuesit shqiptar patën një tingëllim mjaft aktual për kohën. Marrja e pushtetit me ndihmën e forcave të huaja dhe shtypja brutale e popullit ishte një tragjedi që populli shqiptar dhe Noli e kishin jetuar dhe vuajtur vetë. Ardha e Zogut në fuqi me ndihmën e bajonetave të huaja s'i kishte mbushur ende dy vjet, ndaj mesazhi që autori u përcjell lexuesve është me domethënie të qartë politike.*

Konsekuenca në rrugën e tij për të dhënë gjykime objektive për veprën, e bën Nolin që edhe në këtë introduktë ta orientojë drejt lexuesin, duke ia thënë që në fillim se kjo është tragjedia më e tmerrshme që ka dalë nga dora e Shekspirit. Atë çka ndodh në këtë tragjedi, e përsëritur qindra herë me ca variante në historinë e botës, Noli e analizon të lidhur ngushtë me kushtet historike dhe e bën lexuesin që të depërtojë vetë në problemet që shtrohen në vepër.

1. Është pasqyra e tërë historisë së Skotlandës.²⁾ Filmi nis me një kryengritje të brendëshme, të për-krahur prej një ushtërie norvegjiane³⁾ dhe irlandeze kundër mbretit Dunkan të Skotlandës. Të dy gjeneralët skotezë, Makbethi e Bankua, e shtypin kryengritjen dhe i thyejnë ushtëritë e huaja. Pas vijtores⁴⁾ Makbethi vret Mbretin Dunkan, të cilin e kish mysafir në shtëpi për të kremtuar triumfin, ua ngarkon të bijve të mbretit vrasjen dhe u zë vendin si Mbret i Skotlandës. Që të sigurohet mbi fronin e uzurpuar, vret më të djathtë e më të mëngjër, midis të tjerëve dhe shokun e tij Banko. I biri i Dunkanit, Malkolm, me ndihmën e një ushtrie inglize, invadon⁵⁾ Skotlandën, e thyen Makbethin dhe hipën mbi fronin e stërgjyshërve të tij. Makbethi vritet prej Makdakit, të cilit i kish vrarë të shoqen me të bijtë. Kështu, me kryengritje të brendshme, me tradhëtira, me terrorizma gjakderdhëse dhe me ndërhyrje ushtërisht të huaja, vazhdoi historia e Skotlandës gjer sa kjo mbretëri u çduk dhe hyri përfundërisht nën zgjedhën e Inglisë,⁶⁾ nën të cilën ndodhet edhe sot. Ironia tragjike, që i vë kapakun kësaj tragjedie, është që Malkolmi, i cili zaptonte fronin e Skotlandës, me një ushtëri inglize, sallutohet⁷⁾ prej parësisë dhe prej popullit si liberator.⁸⁾ Një komp, i cili është i mërzhitur gjer më atë pikë nga terrorizma e guvernës⁹⁾ kombëtare sa të preferonjë invazjen e huaj¹⁰⁾ dhe ta quanjë si të vetëmin shpëtim, është i dënuar fatalisht ta humbasë indipedencën politike.

2. Është kritika e sistemit terroristik të guvernës dhe, nga kjo pikëpamje, është një përgjigje për Maklavelin. Pas mëndjes së këtij, «Princi» duhet të kujdeset më tepër që t'ia ketë populli frikën se sa dashurinë. Shekspiri anon nga teza e kundërt dhe, me pak fjalë, të hedhura andej-këtej si pa gjë të keqe, na tregon se ai që nis qeverimin me gjakderdhje dhe terrorizmë është i shtrënguar fatalisht¹¹⁾ të vazhdonjë ashtu si nisi, s'kthehet dot prapë më, hyn thellë e më thellë sa vetë, dhe është i dënuar të mbytet në pellgun e gjakut që ka krijuar vetë. Frika që i ka populli

është një dërrasë e kalbur, e cila thyhet nën këmbët e tiranit terrorist me rasjen e parë. Për shëmbëll, posa nis invazja e Malkolmit me ushtërinë inglize, parësia dhe populli e neveritin Makbethin dhe kapin armët kundër tij.

3. Është tragjedia e ambicjes kriminale, mëkati dhe punitja¹²⁾ jo në Ferrin e jetës tjetër, po në Ferrin e kësaj jete, dhe nga kjo pikëpamje është sermoni fetar¹³⁾ më i thellë, më i fortë dhe më i tmerruar që u predikua prej një prifti anglosakson që kur ka lindur krishtërimi gjer sot. Thema është kjo: Ambicja egoiste pa shkrupull, pa mëshirë dhe pa ndërgjegjësi është një kuçedër që ha vetëveten dhe krijon për të zotin një Ferr mi dhe, më të llahtaritur se ai i poetit fetar medieval Dante, në të cilin njeriu modern nuk beson dhe për të cilin s'janë në një mendje as teologët.¹⁴⁾ Ferri i Shekspirit nuk është i bazuar mi dogma kontroversiale,¹⁵⁾ po mi fakte, të provuara nga eksperiencia e jetës. Rrjeth nga natyra e ambicjes, nga ndërgjegja e ambiciozit, nga pasonjat e gjakderdhjeve të tij, nga tortura e gjithënjëshme që ditën e çapit të parë në udhën e krimës gjer në ditën e çapit të fundit në greminën dhe në pellgun e gjakut, ku tirani kriminal lan borxhin e tij. Skeptikët¹⁶⁾ mund të tundin kokën dhe të buzëqeshin për Ferrin e Dantes, po a mund të bëjnë gjithashtu dhe për Ferrin e Shekspirit? Tragjedia e Makbethit dhe e Zonjës Makbeth, e përsëritur qindra herë me ca Variantat në histori të botës, na provon me një mënyrë shkencëtare që ka një gjyq dhe një dënim këtu mi dhe për të ligun. Makbethi e parashikon përpara se të ngrerë dorën për vrasjen, e di sigurisht që s'ka për të shpëtuar prej tij, por është i dominuar¹⁷⁾ prej pasionit, prej monomanisë së ambicjes¹⁸⁾ e cila e çon përbrenda dhe e shtyn të kapë kamën e përgjakun që sheh në erë. Shkëlqimi i kurorës mbretërore, që i profetësuan¹⁹⁾ Magjistricat, fuqitë e Errësirës, vizualizata²⁰⁾ e jashtëme e impulseve²¹⁾ të tij të brendëshme, ia verbon ndërgjegjen; Zonja Makbeth, një alter

ego²²⁾ e vetes së tij, ia forcon vullnetin dhe krahun, se kjo nuk parashikon pasonjat dhe sheh vetëm qëllimin imediat²³⁾, se as i shkon nga mëndja që puna mund të dalë keq, as ka frikë që dikush mund t'u kërkonjë hesap mi Dhe. Janë të gënjyer që të dy, se s'kanë qënë gjakderdhës prej natyre, po bëhen prej ambicjes nga njëra anë dhe prej dashurisë mallëngjelijëse që kanë për njërijatrin. Makbethi e do kurorën për të shoqen dhe kjo për të shoqin, se besojnë që ashtu u ka hie dhe që kjo do t'u sjellë Parajsën mi Dhe që të dyve, po gjakderdhjen, me anën e së cilës duhet ta arrijnë qëllimin, nuk e kanë zanat. Ndërgjegjia e tyre njerëzore është tepër e fortë dhe s'mundin ta mbytin veç përkohësisht me forcën e vullnetit të tyre të çelniktë. Zëri i saj i flet Makbethit në krye, Zonjës Makbeth në fund. Makbethi nis i tronditur dhe i ngjethur, pas vrasjes së parë nuk flet dot më, nuk i qesh dot buza, sheh fantazmat e të vrarëve në gostitë mbretërore, jeta i duket si një makth, po dalëngadalë e mëson zanatin e gjakderdhjes, dhe, pasi hyri në valle, e vazhdon i patundur gjersa përmbysset i vrarë prej Makdavit. Zonja Makbeth nis e patundur, tronditet më vonë kur sheh në ç'katastrofë e shpuri të shoqin, përmbysset prej ndërgjegjës së saj të zgjuar, sëmuret, baret noktambule në gjumë, përpiqet më kot të lanjë duart e përgjakura dhe u jep fund torturave të paduruarshme me vetëvrasjen.

Gjëja më tragjike e kësaj vepre është se Makbethi dhe Zonja Makbeth e harxhojnë tërë heroizmen e tyre për të shtypur të tjerët dhe për të vrarë veten. Po në atë udhë që hyjnë ishte fatale të mbaronin ashtu. Esenca e ambicjes kriminale është si çorba e përvjellur e kazanit të Magjstricave. Një jetë, e frymësuar prej kësaj është jo vetëm një Ferr, po dhe krejt e çmëndur, është si një «përrallë prej budallai, plot bujë e plot tërbim, që s'ka asnjë kuptim». Dhe duket sikur Shekspiri, si anglosakson fetar dhe praktik konkludon me të thënë popullore: «Honesty is the best policy»,²⁴⁾ Po është aq artist sa asgjekundi nuk na

jep përshtypjen që na mban një konferencë historike dhe politike, të kurorëzuar prej një sermoni plot me mësimë morale. Na tregon një histori dhe na lë të heqim vetë konkluzjen.

Nga të gjitha tragjeditë shekspiriane, kjo është nofta më e lehta për të kuptuar. Zhvillimi i subjektit është i kjartë dhe natyral, aksioni rrjeth e rritet gjersa arrin në kulm me një simplicitet²⁵⁾ e një shpejtësi pothuaj klasike. Po nga ana tjetër, është edhe më e rënda për të lojtur në skenë, se s'munt të gjenden në çdo grup theatral dy artistë të kllasit të parë për të interpretuar bashkë rolet e Makbethit e të Zonjës Makbeth. Për këtë arsye, kjo tragjedi, që të shijohet plotësisht duhet parë të paktën dy herë, një herë me një aktor të madh në rolin e Makbethit dhe një herë me një aktoreshë të madhe në rolin e Zonjës Makbeth. Kur rastisin të dy në një grup s'duhet humbur rasje me asnjë mënyrë, se është një nga gëzimet artistike më të rralla të botës.²⁶⁾

1. **demoniake** — djallëzore, këtu: shumë e fuqishme
2. **Skotlanda** — kështu e quajnë anglezët Skocinë
3. **norvegjiane** — norvegjeze
4. **vijtoje** — fitore
5. **invadon** — pushton, sulmon
6. **nën zgjedhën e Inglisë** — nën sundimin e Inglisë
7. **sallutohet** — përshëndetet, këtu: pritët
8. **liberator** — çlironjës
9. **guverna** — qeveria
10. **të preferonjë invazjen e huaj** — të pëlqejë pushtimin e huaj
11. **i shtrënguar fatalisht** — i shtrënguar nga fati, këtu: i dënuar nga fati
12. **punitja** — dënimi
13. **sermoni fetar** — predikim fetar
14. **theologët** — teologët, ata që merren me studimin e dogmave të një feje
15. **dogma kontroversiale** — dogma me kontradikta, dogma kontradiktore
16. **skeptik** — ai që dyshon dhe shfaq mosbesim për gjithçka
17. **i dominuar** — i pushtuar

18. **monomania e ambicjes** — mania e vetme e ambicjes
19. **profetësuan** — i shtinë në fall, i parashikuan
20. **vizualizata** — pamja
21. **impulseve** — nxitjeve, shtytjeve, ambicjeve
22. **alter ego** — uni tjetër, një vetë tjetër
23. **qëllimi imediat** — qëllimi i afërt
24. **Honesti is the best polisay** — mbi të gjitha ndershmëria
25. **simplicitet** — thjeshtësi
26. Edhe në këtë introduktë Noli u sugjeron lexuesve

të thjeshtë shqiptarë që jo vetëm ta lexojnë këtë vepër, por edhe ta shikojnë kur interpretohet në skenë, duke u munduar të përvijojë kështu edhe një rrugë të re për emancipimin kulturor të masave punonjëse.

Migjeni de Cervantes Saavedra i njohur me emrin e shkurtër Cervantes, lindi më 1547 në Alcalá de Henares të Spanjës dhe vdiq në Madrid më 8 prill 1616. Ishi i biri i dytë i një farmaceuti mjekë, gjymëvëngës. I cili shkëlqente i shat me lshat e dytet më dytet për të shkur lshat e për të shkruar të shumë. Më 1570-1575 hyri në shkollimin ushtarak dhe mori pjesë në betejet navale (të Lepantos) së-Greçisë më 7 tetor 1571, midis Illoive veneciane dhe turke ku u plagos rëndë dhe humbi dorën e mëngjër. Më 1576, kur kthe-

te) Përvojë veprave drammatike të Shkëspitit e të Ibsenit. Vendi shkroi edhe dy introduktë për veprat të tijera, njëra për "Kështjën" e Omar Kështjës dhe tjetra për "Don Kishotin" e Serantestit, të parën më 1926 dhe të dytën 1932. Për shpirt dhe introduktën e tjetër që ka me nga Noli. Në introduktën për "Don Kishotin" njihen më tepër se kudo synimet e qymësimeve politike të autorit që lidhen me kushtet politike të vendit të ashpër me shpirtit me gjenden e shpeshës shqiptarë të kohës. Duke e analizuar titullin e Don Kishotit dhe të shprehur parës me kushtet politike-shqiptare të kësaj periode të 17-18, autori për parafjalim me pjesë të shprehjes në vëllim 30 kur, në thotë at... ka me mi-... të Don Kishotit... që kërkohen të kërkohen të historisë dhe... Noli me loj politikë në ashpër i kënd veprë dhe parafjalim i ashpër me një parafjalim të tillë ishte një detyrë kapitulum për kohën. Në introduktën e vet Noli shprehin në shprehje veprës këndon para lexuesit thotë e ashpër, traditën më të vjetër ushtarakë të Don Kishotit dhe veprën të tij të parë edhe për të dashur.

Don Kishoti*

Miguel de Cervantes Saavedra, i njohur me emrin e shkurtër Cervantes, lindi më 1547 në Alcalá de Henares të Spanjës dhe vdiq në Madrid më 3 prill 1616. Ish i biri i dytë i një farmacisti mjek, gjysmëvagabond, i cili shëtite fshat më fshat e qytet më qytet për të shitur ilaçe e për të shëruar të sëmurë. Më 1570-1575 hyri në shërbimin ushtarak dhe mori pjesë në betejën navale¹⁾ të Lepantos²⁾ së Greqisë më 7 tetor 1571, midis flotave veneciane dhe turke, ku u plagos rëndë dhe humbi dorën e mëngjër. Më 1575, kur kthe-

**) Përveç veprave dramatike të Shekspirit e të Ibsenit, Noli shkroi edhe dy introdukta për vepra të tjera, njëren për «Rubairat» e Omar Khajamit dhe tjetrën për «Don Kishotin» e Servantesit, të parën më 1926 dhe të dytën 1932, që është edhe introdukta e fundit që kemi nga Noli. Në introduktën për «Don Kishotin» ndihen më tepër se kudo synimet e guximshme politike të autorit që lidhen me kushtet politike të rendit feudo-borgjez në Shqipëri, me gjendjen e shoqërisë shqiptare të kohës. Duke e analizuar figurën e Don Kishotit dhe të Sanço Pançës lidhur ngushtë me kushtet politiko-shoqërore të Spanjës të shekullit të 17-të, autori bën paralelizma me gjendjen e Shqipërisë në vitet '30, ku, siç thotë ai, ...ka me mijëra Don Kishotër... që kërkojnë ta kthejnë rrotën e historisë prapa... Nisur nga kjo, botimi në shqip i kësaj vepre dhe prezantimi i saj nga Noli me një parathënie të tillë ishte mjaft kuptimplot për kohën. Me introduktën e vet Noli depërton në shpirtin e veprës, zbulon para lexuesit thelbin e saj, kontradiktën midis ëndrrave utopike të Don Kishotit dhe realitetit, gjë që të bën edhe për të qarë edhe për të qeshur.*

hej nga Italia në Spanjë, u zu rob prej piratësh al-gjerianë nën kryesinë e kapedanit shqiptar Arnaut Mami dhe u mbajt i burgosur gjer më 1580, kur u çlirua pasi pagoi shumën e caktuar për lëshimin e tij. Shkroi një shumicë të madhe veprash letrare, veçan drama e novela, të cilat s'patnë asnjë sukses as në kohën e tij, as pastaj. Në ditët e pleqërisë, kur ishte 58 vjetsh botoi veprën e tij me famë, Don Kishotin e Mançës, e cila me të drejtë ia bëri emrin të pavdekur. Kjo libër pati një sukses aq të madh sa Cervantesi shkroi një pjesë të dytë të kësaj vepre, si vazhdim të pjesës së parë. Suksesi i kësaj nuk qe më i vogël se ai i së parës. Bile, gjer më sot kritikët po hahen midis tyre dhe, s'kanë arrirë të merren dot vesh se cila nga këto të dy pjesë është më e bukur, e para apo e dyta. Shumëve u pëlqen më tepër pjesa e dytë. Gëtja preferontë pjesën e parë. Sidoqoftë, Don Kishoti i Mançës ka qenë për çdo kohë e për çdo vënd, një nga veprat më popullore të botës, popullore edhe për çiliminjtë, edhe për filozofët e mvrojtur, si Kanti³⁾ e Shopenhaueri.⁴⁾ Eduard Fitzxheraldi, përkthënjësi i dëgjuar i Omar Khajamit e quan si veprën më të lezeçime të botës.

Cervantesi e shkroi Don Kishotin, sikundër na thotë ay vetë, me qëllimin që të diskreditonte librat e kalorësisë. Vepra e tij, pra, ishte doemos revollucionare, se për të diskredituar librat e kalorësisë duhej të diskreditonte tërë kohën e mesme me të gjitha përrallat e saj. Për këtë qëllim, Cervantesi zgjodhi si heronj të veprës së tij dy nga tipat më reaksionarë dhe medievalë⁵⁾, që kishte e që kemi akoma përpara sysh: bejlurçinën⁶⁾, sojlinë e fandaksur të katundit, Don Kishotin e Mançës, dhe laron, sejmenin⁷⁾, fshatarin e varfër e të paditur, Sanço Pançën. Këta të dy marrin përsipër barrën të ringjallin periudhën e kalorësve të arratur, domethënë ta kthejnë Spanjën edhe tërë botën nja 300 vjete prapa e të hidhen: nga Spanja e madhe e qëntalizuar⁸⁾, që ka zaptuar gjysmën e Amerikës, në Spanjën e vogël të përçarë dhe të shtypur

prej arabëve, nga koha moderne në kohën e mesme, nga kapitalizma në feodalizëm; nga dyfeku dhe topat në shtijezën dhe çomangën,⁹⁾ nga shkenca në magji¹⁰⁾, nga historia në përrallat, nga përparimi në errësirën.

Me ç'mënyrë ka shpresë Don Kishoti ta mbaronjë këtë vepër utopike? Fare lehtë. Duke u bërë ai vetë kalorës i arratisur, sipas librave që kishte kënduar. Pra, merr nga qilari armët e çelnikta, të ndryshkura e të zgjyrosura,¹¹⁾ të stërgjyshëve të tij, i shkund, i lan e vishet me to; pagëzon¹²⁾ gërdallën e tij me emrin Rosinanti, zgjedh një të dashur që e riemëron Dylqinjë; dorëzohet kalorës nga një hanxhi dhe nga dy kalltake,¹³⁾ zgjedh Saço Paçën si shqytar¹⁴⁾ e sejmën; dhe niset për të reformuar¹⁵⁾ e për të shpëtuar botën. Është një fantazmë e ikur nga muzeu që shetit në Spanjën moderne. Është anakronizma-ambullante.¹⁶⁾ Është vizionari,¹⁷⁾ që nuk sheh realitetin po ëndërron me sytë e hapur. Është utopisti reaksionar që vete prapa e jo përpara, që përpiqet ta kthenjë rrotën e historisë prapa, që i bie me kokë murit të çelniktë modern.

Për të kuptuar Don Kishotin e Saço Paçën, duhet të kuptojmë mirë klasat shoqërore spanjolle prej të cilave kanë lindur, domethënë klasën e aristokratit të vogël, nga njëra anë dhe klasën e fshatarit të varfër e të paditur, nga ana tjetër, në shekullin e shtatëmbëdhjetë. Në Spanjën e kohës së mesme aristokratët e vegjël kishin punë si qehajanj¹⁸⁾ të feodalëve çiflik-sahibin¹⁹⁾ e veçanërisht si kapedanë komitaxhinj²⁰⁾ të çetave që luftonin kundër arabëve. Si u çlirua Spanja prej arabëve dhe si u modernizua përgjysmë, aristokratët e vegjël, që nuk shkuan në Amerikë, mbetën pa punë. U varfëruan, u proletarizuan, u deklasuan, ranë nga dynjallëku, s'kishin bazë ekonomike, se u preirati²¹⁾ i tyre dhe mbetën në erë. Nga oxhaku dhe nga kultura lidheshin me aristoklatinë feodale të lartë, po nga varfëria zbrisnin në shkallën e fshatarëve. S'ishin as tamam aristokratë, as tamam fshatarë, po ca më keq se që të dy palët. Pra, ishin më reaksionarë se feodalët e lartë dhe më budallenj se fshatarët e var-

fër e të paditur. Dyke mos patur as punë, as bazë, kërkonin dhe përpiqeshin t'i gjenin këto të dyja jo përpara, se s'kishte të pritme për klasën e tyre të vdekur, po prapa, në kohët e vjetra, kur klasa e tyre kishte një punë dhe një bazë. Kështu, Don Kishoti kërkon e gjen punë si kalorës i arratisur, siç ishin stërgjyshët e tij. 72

Artikuj

Tolstoi vdiq*)

Auktori rus me famë, kont¹) Leon Tolstoi vdiq.

Gazetat amerikane shkruajtën kollona të tëra mi rasjen²) e vdekjes së tij. Rusia humbet një nga shkrimtarët e saj me famë panevropiane.³)

Tolstoi është njohur në Ballkan si «filosof». Po qe aq filosof sa dhe Viktor Hygoi. Vëndi i tij i vërtetë është në mes të romancerëve realistë. Tolstoi si Gorki, Dostojevski, dhe Turgenievi⁴) shkruajtën romane në të

* Këtë artikull, Noli e shkroi dhe e botoi më 1910 me rastin e vdekjes së Leon Tolstoit (1828-1910) njëri nga figurat më të shquara të letërsisë ruse. Artikulli tregon jo vetëm vlerësimet objektive që i bëri Noli kësaj figure të shquar, por edhe faktin që ai jetonte me ngjarjet kulturore-artistike të kohës, ishte i lidhur me jetën kulturore në të gjithë botën, tipar ky i një njeriu të kulturuar e studiuesi të pasionuar.

Në krijimtarinë e Tolstoit gjetën shprehjen më të mirë veçoritë kryesore të letërsisë ruse të kohës si pasqyrimi i gjithanshëm i realitetit, kritika e pamëshirshme e rendit në fuqi, etj. «60 vjet ushtoi zëri i ashpër dhe i drejtë i tij, që demaskoi çdo gjë e këdo. Ai na ka treguar për jetën ruse gati aq sa edhe krejt letërsia tjetër». — «thotë Gorki, ndërsa Lenini e quan «pasqyrë e revolucionit rus».

Jehonën që bëri vdekja e tij e gjejmë jo vetëm në shtypin botëror, por edhe në atë shqiptar të kohës, ku cilësohej si një nga yjet më të ndritshëm dhe më të mëdhenj të kulturës botërore. Edhe Noli bashkohet me këtë kor bashkatdhetarësh dhe mbresat që i la kjo ngjarje i hedh me një ndjenjë respekti e mirëdashëseje në këtë artikull të shkurtër që e botoi në gazetën «Dielli» dhe flamurin më 25 Nëntor 1910, një muaj pas vdekjes së Tolstoit.

cilat u përpoqnë të pikturojnë realitetin e tmerruar.

Nga mendimet dhe idetë e tij sociale, Tolstoi hyn te familja e madhe e stërnipëve të Rusoit⁵⁾ (Rousseau). Konti rus që thellësisht demokrat, ose më mirë demagog,⁶⁾ armik i deklaruar i auktoritetit në çdo formë. Kjo e bëri të luftojë Synodin rus⁷⁾ i cili e çkishërroi me gjithë që Tolstoi ka qënë vetë një i krishterë i flaktë, siç e tregon jeta dhe shkrimet e tij.

Ca nga veprat e tij me famë janë: Lufta dhe Paqa, Ana Karenina dhe Ngjallja.⁸⁾

-
1. konti — titull aristokrati
 2. mi rasjen — me rastin
 3. panevropiane — në gjithë Evropën, të evropiane
 4. Dostojevski (1821-1881), Turgenievi (1818-1880) shkrimtarë rusë.
 5. Eusol (1712-1778) — filozof, sociolog dhe iluminist i shquar francez
 6. demagog — këtu: udhëheqës i popullit
 7. Synodi rus — organi më i lartë i kishës ortodokse ruse
 8. Ngjallja — Ringjallja

Shuberti harbut*)

Muajin e kaluar u mbushën njëqind vjet që kur ka vdekur Franc Shuberti (Franz Schubert), nga së-

*) Këtë artikull Noli e shkroi në Vjenë dhe e botoi në gazetën «Liria kombëtare» të Gjenezës më 1928 me rastin e 100 vjetorit të vdekjes së Shubertit.

Informacioni që u jep lexuesve artikulli si dhe nervi demokratik me të cilin është shkruar dëshmon jo vetëm për interesat krijuese e intelektuale të Nolit për letërsinë, por edhe për artet e tjera, si edhe për bindjet e tij të vendosura demokratike. Artikulli më tepër se një portret është një vlerësim me kompetencë prej specialisti për «një nga më të mëdhenjtë kompozitorë të botës...; që nuk dinte t'u lëpinte këmbët sundimtarëve të kohës... Po kështu, më tepër se një artikull përkujtimor është një aktakuzë e fuqishme kundër klasave në fuqi që e «vranë» Shubertin në lulen e pjekurisë së tij artistike dhe që e «përdorin» atë si mjet fitimi edhe më të gjallë edhe pas vdekjes. Artikulli ka tone të theksuara ironie, deri në sarkazëm kundër borgjezisë dhe sistemit të saj.

Franc Shuberti (1797-1828) është një kompozitor i shquar austriak. Kaloi një jetë plot vuajtje dhe pas vdekjes për një kohë të gjatë u la në harresë. Vetëm iniciativa e Shumanit, Mendelsonit e Listit, të cilët si solistë e dirigjentë të mëdhenj orkestre zbuluan pasurinë e pakrahasueshme të veprave të tij, e bëri atë të pavdekshëm.

Megjithëse jeta e tij qe fare e shkurtër ai karakterizohet nga një krijimtari me vlera të larta artistike dhe me përmbajtje të shëndoshë jetësore. Në themel të krijimtarisë së tij qëndron kënga popullore. Krijoi një numër të madh veprash, duke përfshirë të gjitha llojet e muzikës vokale dhe instrumentale (15 opera, vepra korale me orkestër e piano etj.) Por mbi të gjitha ai njihet si mjeshtër i madh këngësh, mbi 600, sipas poezive të Gëtes, Shilerit etj., që përbëjnë kontributin e tij më të madh.

mundjet e zakonëshme të proletarëve, nga uria dhe nga oftika⁴), në një gërmadhë të kalbur të rretheve të Vjenës, në vërsën²) e bukur prej 31 vjetsh, domethënë në lulen e burrisë. Pas mendjes së Moris Ravelit,³) Shuberti qëndron më lart se Bethoveni,⁴) pra është më i madhi muzikant i botës (...). Po nuk është nevojë të vemi kaq larg. Arrin të themi një gjë të pranuar prej të gjithëve që Shuberti është një nga më të mëdhenjtë muzikantë të botës, dhe veçanërisht në fushën e këngëve (gjermanisht, lied), në të cilat mbetet kryemjeshtër i pakapërcyer.

Po përse vdiq prej urie dhe prej oftike? Mos ishte vallë dembel e s'punonte mjaft? Apo mos ishte i panjohur në botën muzikale? Aspak. Na ka lënë afro dy mijë vepra muzikale, të mëdha e të vogla, nga të gjitha sojet, këngë, sinfoni, opera. Këto çmoheshin fare bukur, se editorët⁵) që ia blinin për një copë bukë dhe ia botonin, nxirrnin fitime të majme. Me fjalë të tjera, e vranë borgjezët, pasi i vodhën pemët e punës. Sa për feodalët, që mbretëronin atë kohë në Vjenë, ata s'u kujdesën t'i jipnin ndonjë punë, se Shuberti s'ish i zoti t'u lëpinte këmbët. Gëtja, nuk e bëri kabull t'i përgjigjet me dy fjalë falenderimi, kur Shuberti i dërgoi disa vjersha të tij — të Gëtes — të vëna në muzikë. Me qindra mijëra njerës i dëgjojnë sot disa vjersha të Gëtes vetëm e vetëm se i ka vënë Shuberti në muzikë. Po Shuberti harbut⁶) s'ka ditur t'i bënë mjaft komplimente Gëtes dhe kështu s'mori asnjë përgjigje. Kështu s'merrte përgjigje as nga feodalët e Vjenës.

Po, natyrisht, tani e do moda që t'i nderohet kujtimi dhe borgjezët me feodalët e festuan aniversarin⁷) e vdekjes së tij me shkëlqim e me pompë⁸) të kapardisur e barkfryrë i mbushën theatret ku bëheshin kremtimet, se biletat ishin aq të shtrenjta e s'i puthnin dot veç kamësit. Skamësit u shtrënguan të bëjnë shir që përjashta. Kështu pra kamësit na e vranë të gjallë Shubertin, na e monopolizuan⁹) dhe të vdekur. Venë edhe një çap më tutje. Përpiqen të na e mbushin ko-

kën që i bënë një shërbim të madh muzikës duke e lënë Shubertin pa bukë. Ja se qysh: Shuberti shkruante me nxitim një vepër muzikale, e shiste me vrap për pesë para, blente një kothere, nuk ngopej dot prej saj, shkonte prapë e niste një tjetër vepër. S'kishte nge t'i ndreqte e t'i rindreqte, se kështu do t'i prishte dhe i hidhte në defter ashtu siç i dilnin nga shpirti, si perëndesha të çveshura pa nonjë stoli. Sikur të mos e çponte uria në çdo çap, do ta merrte punën me javash e me të fjetur, do të rafinohej¹⁰⁾ nga shija, do të trashej nga barku, do të fitonte dhjamë në vend të oftikës, dhe të tjerat po i dimë, se merren vesh fare lehtë, se macja e ngopur nuk zë minj! Shumë bukur, po medalja ka një anë tjetër, e cila mund të rezumohet¹¹⁾ me një përrallë të Nastradin hoxhës: Gomari punon ca kohë pa ngrënë, po vdes pikërisht posa e mëson këtë zanat. Po borgjezët, kur na tregojnë pallasra për bukuritë artistike të stomakut të zbrazët, nuk meritojnë përgjigje me argumente, po me grushte kokës. Përndryshe, punëtorët përgjithësisht, të muzikës a fabrikës, të pendës a të parmendës do të ngorrdhin pareshtur nga uria e nga oftika, sa kohë i lënë borgjezët e feodalët t'ua thëthijnë gjakun, t'i vrasin me sistem¹²⁾ e më në fund të tallen mi varret e tyre. Dhe kështu u kthyem prapë në politikë, se kjo shtrigë e fut hundën kudo dhe kjo i ka të gjitha fajet.

Pa fjalë do të bisedojmë dhe për politikë, se të gjithë të tjerat s'janë veç mezera rreth kësaj bostan-tave.

1. **oftika-ja** — tuberkulozi. Noli (me ironi) «urinë» dhe «ofikanë» i quan sëmundje të zakonshme të proletarëve.

2. **në vërsën** — në moshën

3. **Moris Raveli** (1875-1937) — kompozitor francez

4. **Bethoveni** (1770-1827) — kompozitor i madh gjerman autor i 32 sonatave për piano, 17 kuarteteve, 9 sinfonive, 5 koncerte për piano, opera «Fidelio» etj. Muzika e tij pasqyroi idetë përparimtare të kohës. Në epiqendër të saj është lufta për lirinë e njeriut, dashuria për atdheun dhe gëzimi i popullit për fitoren. Tipari kryesor i veprave të tij është

heroika. Kjo tingëllon me forcë sidomos në simfoninë e III, V dhe IX. Për krijimtarinë e tij Noli shkroi veprën «*Bethoveni dhe revolucioni frëng*».

5. **editorët** — botuesit, këtu: ata që i vinin në skenë ose i ekzekutonin.

6. **harbut** — këtu përdoret në kuptimin që s'ishte servil, sahanlëpirës

7. **aniversarin** — përvjetorin, është fjala për festimin e 100 vjetorit të vdekjes së Shubertit

8. **me pompë** — me pompozitet, me shumë bujë

9. e **monopolizuan** — këtu e quajtën të tyrin, e bënë të vetin

10. **do të rrafinohej** — do të bëhej rrufjan, i djallëzuar.

11. **rezumohet** — përmblihet

12. **t'i vrasin me sistem** — t'i vrasin, sepse kanë pushtetin në dorë kanë shtetin, fuqinë (sistemin).

Për Toskaninin*)

Fashistët e Musolinit¹⁾ i treguan botës sa trima janë. Një ordi²⁾ prej syresh u vërvitnë kundër një plak-ku gjashtëdhjetë e pesë vjetsh dhe e goditnë aq keq sa e kanë sakatosur. Incidenti³⁾ ngjau në Bollonjë të Italisë. Plaku i rrahur quhet Arturo Toskanini (Toscanini), një nga më të fortët dirigjentë të orkestrës në historinë e muzikës. Shkaku, se Toskanini refuzoi⁴⁾ të lozë në këtë koncert marshin «Giovinezza»⁵⁾ dhe marshin kombëtar italian «Evviva il re»⁶⁾ për arsye artistike. Fashistët pretendojnë që arsyet ishin politike dhe që Toskanini është një agitator antifashist e antimonarkist i rrezikshëm. Pa dyshim, arsyet e Toskaninit kanë qenë artistike se «Giovinezza» dhe «Marcia Reale»⁷⁾ që refuzoi të lozë janë marshe palaçosh⁸⁾ që do ta prish-

*) Ky artikull është botuar më 1931. Për ta shkruar këtë Noli merr shkas nga një ngjarje konkrete. Si njeri me bindje të qëndrueshme demokratike e antifashiste, si personalitet politik dhe si figurë e shquar e artit dhe e kulturës, ai ndjek me interes gjithë veprimtarinë politike dhe kulturore të kohës. Në Bollonjë të Italisë ndodhi një skandal. Bandat fashiste rrahën dhe sakatuan një plak 65 vjeçar, sepse nuk pranoi të ekzekutonte një himn fashist. Ky ishte Arturo Toskanini (1867-1957), njeri nga dirigjentët më të dëgjuar të orkestrës italiane dhe botërore, që drejtoi për shumë vjet orkestrën e Skalas të Milanos dhe orkestra të tjera në botë, personalitet kulture dhe njeri me mendime përparimtare. Noli si njeri me kurajë qytetare, e merr në mbrojtje para opinionit publik, duke i hequr maskën fashizmit dhe duke e demaskuar atë si pjellë e forcave të errëta dhe e regresit shoqëror.

nin bukurinë e koncertit të Bollonjës. Po nga ana tjetër, refuzimi merr me rasjet e sotme, makar⁹⁾ edhe pa dashjen e Toskaninit një karakter politik e revolucionar të dorës së parë. Sidoqoftë, ky incident na tregon se Toskanini është jo vetëm një usta i madh¹⁰⁾ i orkestrës, por edhe një burrë në tërë kuptimin e fjalës, burrë që për arësye artistike e politike, a për të dya, refuzoi të unjet¹¹⁾ përpara tiranëve të ditës. «Evviva Toskanini!¹²⁾ Abbasso Musolini!»¹³⁾ Ja dy thirje që rimojnë me një mënyrë ominoze¹⁴⁾ dhe fatale. Ja dy parrulla që munt t'i bërtasë nesër i tërë populli italian kundër fashizmës e kundër monarkisë.

1. **Musolini** (1883-1945) — kryetar i Partisë Fashiste Italiane. Organizator i luftës imperialiste kundër Spanjës republikane dhe për pushtimin e Abisinisë më 1936 e të Shqipërisë më 1939.
2. **Ordi** — turmë
3. **incidenti** — ngjarje, ndodhia, e papritura
4. **refuzoi** — kundërshtoi, nuk pranoi
5. **Giovinezza** — marshi fashist
6. «**Evviva il re**» — rroftë mbreti
7. **Marçia Reale** — marshi mbretëror, i mbretit
8. **palazo** — njeri qesharak, pa karakter
9. **makar** — qoftë, sikur
10. **usta i madh** — këtu: mjeshtër i madh, dirigjent i madh
11. **të unjet** — të përulet, të bëhet servil
12. **Evviva Toskanini** — Rroftë Toskanini
13. **Abbasso Musolini** — Poshtë Muşolini
14. **ominoze** — ogurzezë

Për Don Kishotin*)

Ka nja njëzet a tridhjetë kryevepra letrare, të cilat s'duhet të vdesë njeriu para se t'i këndonjë. Një prej këtyre është «Don Kishoti» i shkrimtarit spanjoll Miguel de Cervantes Saavedra... Është dhurata më e lezetme që mund t'ju bëjmë, këndonjës të dashur. Jemi sigur që do ta shijoni. Është e pamundur të mos ju pëlqenjë. Këndonjeni me vërejtjen që meriton. Çdo shpjegim i gjatë është i tepër, se Don Kishoti e ka brenda shpjegimin. Duket që nga kaptinat e para çfarë çeshit¹⁾ është. Don Kishoti është një fantazmë që ka ikur nga muzeu i kohës së mesme dhe po shetit në Spanjën gjysmë të modernizuar të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Të vjen të qash e të qeshësh me ato që thotë e me ato që bën. I dehur me librat e kalorësisë vendos të ngjallë periudhën e feodalizmit të kryqësatave, ndonëse kësaj i kishte shkuar koha, ndonëse Spanja kishte hyrë që prej vjetësh në një fazë të re të historisë njerëzore, në periudhën nistore²⁾ të kapitalizmit moderne. Don Kishoti është ai që kërkon ta

* Këtë artikull Noli e shkroi dhe e botoi më 1931. Është më tepër një bashkëbisedim i autorit me lexuesin për këtë kryevepër të letërsisë botërore, të cilën Noli e radhit në «njëzet a tridhjetë kryeveprat letrare që njeriu s'duhet të vdesë pa i lexuar». Ai i drejtohet lexuesit me dashuri e sinqeritet për ta ndihmuar që ta kuptojë drejt thelbin e veprës. Dhe ai e ndien se në «Shqipëri kjo vepër do të kuptohet më mirë se kudo në botë».

1. çfarë çeshit — çfarë malli, ç'lloj, ç'mostër
2. nistore — fillestare

kthenjë rrotën e historisë prapa. Është tipi i sojliut³⁾ të vogël të fshatit më reaksionar e më prapavajtës se aristokrati i lartë gjysmëfeudal. Është tipi i ëndërronjësit që rron me përrallat e librave dhe jo me faktet e jetës. Po qëllimi i këtij reaksionari ëndërronjës është fare idealistik⁴⁾. Sakrifikohet për një ideal të vdekur, të ndryshkur e të zgjyrosur si armët e tij. Në Shqipëri kemi me mijëra Don Kishotër, reaksionarë të padjallëzuar që përpiqen ta kthejnë rrotën e historisë prapa, njerës që rrojnë me përrallat dhe fantazmat e patriarkalizmës dhe feudalizmës orientale. Këta reaksionarë janë komikë, se të bëjnë të qeshësh me prapambetjen e tyre, po janë edhe tragjikë, se sakrifikohen për ato përralla dhe për ato fantazma, tamam si Don Kishoti. Faji i tyre, si edhe faji i Don Kishotit, është që kanë lindur tepër vonë, kur shkoi koha, që kanë mbetur tepër prapa në një botë që ka vajtur tepër përpara. Don Kishoti vdiq ashtu si rroi, si kalorës i kohës së mesme, i arratisur në kohën moderne. A do të vdesin kështu edhe shqiptarët? Ja tragjedia e Shqipërisë me shqiptarët e prapambetur. Nga kjo vdekje tragjike përpiqemi ta shpëtojmë Shqipërinë, duke e modernizuar. Në këtë vdekje e shtyjnë Shqipërinë bejlerët, duke e lënë të mos modernizohet. Shqiptarët e errët⁵⁾ që refuzojnë të modernizohen, bëhen vegla të bejlerëve, dhe pa dashur e pa ditur vrasin edhe veten, edhe Shqipërinë. Nga kjo pikëpamje, këndojeni Don Kishotin. Dhe ahëre edhe do të qeshni edhe do të qani. Kështu kanë qeshur e kanë qarë, duke u kënduar Don Kishotin, me miliona njerëz qindra vjete me radhë. Se Don Kishoti është një tip i pavdekur. Hidhni syrin ku të doni e do ta shihni të gjallë përpara jush në çdo çip e në çdo çap. E kini nofta vëlla

3. **sojli** — ai që rrjedh nga një familje nga shtresat e larta (nga derë e madhe)

4. **idealistik** — i parelizueshëm.

5. **e errët** — këtu, të prapambetur

a kushuri të parë. Sidomos e kini njëkombas arnaut të kulluar me silah⁶⁾ e me tizga⁷⁾ që me kokën prapavajtëse⁸⁾ i bie trimërisht murit modern të çelniktë.⁹⁾

Don Kishotit e Manges- s'hapin
dorë nga vjetërnat)

Manuel de Cervantes Saavedra, i njohur në tërë botën me emrin e shkurtër Cervantes, botoi në një moshë të parë, kështu që tij Don Kishotit i Man- gës. Libri pati një sukses të çuditshëm e çka e bëri sot konsideronohet si një veper klasike e dorës së parë. Libri ndahet në dy pjesë po pjesë e dyta është shumë më vërtetë e parë. Që të dy pjesët kanë një du- kuni të veçantë, pasi kanë të bëjnë me (narrativat) të (kredituar) dhe të vdekur.

Vetë Cervantes na tregon sepa e shpirti këtu li- bër: e shpirti me shpresë që të kreditonte librat e shumta të kalorësishë, domethënë të bejlerëve feudalë të Korbës së Manges, të cilat ndonëse po çmureshin për- seq. lëvizshmëri dhe këmbësorinë, në mbarëvajtje e vjetër të cilat këtu i kishin kredituar për bindshmëri.

Don Kishotit dhe të tjerëve që të tjerëve shpesh

6. silah — brez i gjerë lëkure që shërbente për të mbajtur armët e mezit dhe pjesët e tyre.
7. tizga — rrip i ngushtë, zakonisht prej leshi që përdoret për të lidhur kallcat, tirqet, çorapet etj.
8. Prapavajtëse — e prapambetur, fanatike
9. Duke marrë shkas nga Don Kishoti, Noli në këtë arti- kull gjen rastin të shprehë edhe një herë mendimet e tij demokratike e të verë në majën e tehut të kritikës bejlerët dhe veglat e tyre.

«Don Kishotët e Mançes» s'heqin dorë nga vjeturinat*)

Miguel de Cervantes Saavedra, i njohur në tërë botën me emrin e shkurtër Cervantes, botoi në një moshë të lashtë, kryeveprën e tij Don Kishoti i Mançës. Libri pati një sukses të çuditshëm e cila edhe sot konsiderohet si një vepër klasike e dorës së parë. Libri ndahet në dy pjesë, po pjesa e dytë është sigurisht vazhdimi i pjesës së parë. Që të dy pjesët kanë një bukurri të veçantë, pasi kanë të bëjnë me insituata¹⁾ të çkredituara²⁾ dhe të vdekura.

Vetë Cervantes na thotë sepse e shkroi këtë libër: e shkroi me shpresë që të çkreditonte librat e shumta të kalorësisë, domethënë të bejlerëve feudalë të Kohës së Mesme, të cilat ndonëse po çdukeshin përsëri insistonin që të ktheheshin prapë në mbeturinat e vjetra, të cilat koha i kish çkredituar përfundimisht.

* *Figurë së Don Kishotit Noli do t'i rikthehet edhe një herë për herë të tretë, më 1945, kur shkroi e botoi këtë artikull-pamflet. Këtë radhë ai i rikthehet në kushte të reja politike. Figura e Don Kishotit i jep dorë kësaj herë të shprehë nga pozita e fitimtarit gëzimin e tij për Shqipërinë e rilindur me triumfin e Luftës Nacionalçlirimtare. Është koha kur mbeturinat e klasave të përmbusura morën rrugët e mërgimit dhe kudo që shkuan, të mbështetura edhe nga reaksionin ndërkombëtar, nisën të përhapnin një fushatë antishqiptare kundër Shqipërisë popullore. Në këto rrethana Noli demokrat merr në mbrojtje guvernën e Enver Hoxhës, duke iu kundërvënë reaksionit ballist-zogist, për tipizimin e të cilit nuk gjen figurë më të përshtatshme se atë të Don Kishotit. (Këtë ide Noli e trajtoi edhe më vonë, më 1961 të poezia «Sulltani dhe Kabineti».*

Kjo librë është një vepër revolucionare, pasi bën më shumë se çdo tjetër vepër letrare ose historike për të përmbysur përrallat dhe legjendat e Kohës së Mesme.

Që t'i jepet forcë tezës së tij Cervantes zgjodhi dy prototipa: një bej dhe një sejmën. Këta të dy babaxhanë muarrën përsipër punën e rëndë: përsëritjen e kohës së kalorësisë të Kohës Mesjetare, domethënë, përrallat e vjetra të cilat koha, zhvillimi, evolucioni i kish përmbysur përfundimisht.

Mirëpo kish bejlurçina dhe sejmene këtu-këtej që besonin se mund të qëndronin sahatin e evolucionit³⁾ dhe zhvillimin e popullit duke imituar kohërat e shkuara.

Në këtë libër Cervantes ka bërë një studim të hollë të klasave spanjolle: klasën e aristokratit të vogël dhe klasën e fshatarit të paditur, domethënë bejlerët dhe sejmenët e asaj kohe.

Tani pyetja vjen: A mund populli i Shqipërisë sot të tërheqë dot një mësim nga libra e Cervantes që u shkrua afro 400 vjet më parë?

Përgjigja është: Po.

* * *

Që kur fitoi independencën e gjër të Premten e Zezë më 1939 populli shqiptar u mundua disa herë me radhë që të dërmonte feudalizmin e bejlerëve dhe të sejmeneve me anën e kanunit⁴⁾ dhe me anën e revolucionit⁵⁾. Mjerisht në tërë këtë kohë, as kanuni, as revolucioni nuk punoi⁶⁾. Kryengritja e Qershorit të vitit 1924 mund të merrret si nisja dhe e mbarimit të kohës së Mesme në Shqipëri. Për fat të keq fqinjët që e rrethonin Shqipërinë nuk e lanë këtë kryengritje që të zhvillohej gjër në pikën e fundit, domethënë të mbaronte punën që nisi duke përmbysur klasin aristokrat të Shqipërisë.

Kështu pra, klasi aristokrat me ndihmën e forca-ve të huaja u stabilizua përsëri në Shqipëri e kapërceu dhe njëherë lumin.

Mjerisht këtë herë fati nuk nënqeshi për shumë kohë pasi forcat e jashtëme që e suallë në fuqi Don Kishotin me sejmenin e tij Sanço Paççen nuk iu dhanë dot as zotësinë, as vizhdanin⁷⁾ që të shikonin shenjat e kohës⁸⁾.

Kështu pra katastrofi i Prillit 1939 i gjeti të përgatitur si Don Kishotin ashtu dhe Sanço Paççen.

Që nga prilli 1939 dhe gjerësa u çlirua Shqipëria nga okupatori, populli shqiptar bëri një luftë në dy fronte, luftën kundër okupatorit dhe luftën kundër Don Kishotëve të vendit dhe çuditërisht doli faqebardhë.

Don Kishotët luftuan rreptësisht kundër popullit, u bashkuan me armikun okupator, mblodhë rreth e rrotull tyre të gjithë sejmenët që mund të gjenin, po për fat të mirë të Shqipërisë dhe për fat të keq të Don Kishotëve, sejmenët e Shqipërisë, nisën ta kuptojnë se interesi i tyre lidhej me interesin e popullit shqiptar përgjithësisht dhe kështu u hodhë me anën e popullit, domethënë me anën e Frontit Nacionalçlirimtar. Kështu pra, përralla e vjetër «beu dhe gomar të bëhet, mos ia hip» u çduk, shkoi, vdiq me fashizmin dhe nazizmin.

Po a e kanë kuptuar këtë të vërtetë Don Kishotët e Shqipërisë? Jo, aspak. Edhe as që do ta kuptojnë. Bashkë me ta kanë mbetur dhe një pakicë sejmenësh që po i ndjekin pas⁹⁾ nëpër Evropë. Për këta sejmenë na vjen keq dhe iu thomi që të mos humbasin kohën me përrallat e Don Kishotëve po të hyjnë sa më shpejt në marrëveshtje me guvernën¹⁰⁾ e Tiranës dhe të kthehen në Shqipëri.

Don Kishotët tani kanë nisur nga intrigat e zakonshme, kanë nisur të lidhen me armiqt e Shqipërisë me shpresë që të përmbysin regjimin e popullit dhe të kthehen ata në fuqi. Shumica e këtyre Don Kishotëve janë nga ata që i bënë varrë¹¹⁾ Shqipërisë demokratike më 1924 edhe përsëri Shqipërisë feudale më 1939! Këta ishin ata burra që «ftuan» Musolinin të skllavëronte dhe të çkombëtarizonte dhe kombin shqiptar.

Ka tani disa javë që po marrim letra nga këta Don Kishotë me anën e të cilave na «këshillojnë të mos kërkojmë njohjen e regjimit të sotmë, pasi ky është një regjim komunist». Përralla të këtilla i kemi dëgjuar dhe tjetër herë, po i sigurojmë Don Kishotët tonë se shqiptarët e Amerikës, nuk besojnë në feudalizmë dhe në të tjera insituta të vjetra dhe të çkredituara.

Don Kishotët qahen se në Shqipërinë e sotme e ka marrë në dorë fuqinë rinia. «Çupat dhe djemtë — thonë këta të mykur — janë demoralizuar,¹²⁾ bëjnë dashuri me kë të duan dhe martohen me kë të duan». Nga pikpamja e këtyre mbeturinave kjo qenka një krimë e madhe! Kur është dëgjuar kjo liri e madhe që një vajzë shqiptare të martohet me cilin t'i dojë zemra e saj? Sa gjë e keqe! Perëndia na shpëtoftë nga një regjim i këtillë!

Zotërinj Don Kishotë: Pranojeni që këtë herë e humbtë luftën. Hiqni dorë nga marrëzitë Don Kishotike. Koha juaj u mbulua.

-
1. **insituata** — këtu: kushte, gjendje, situata
 2. **të çkredituara** — këtu: jashtë kohës, anakronike, qesharake
 3. **të qëndronin sahatin e evolucionit** — të ndalonin zhvillimin, përparimin, ta mbanin në vend ose ta kthenin prapa rrotën e historisë.
 4. **kanunit** — këtu: luftës parlamentare
 5. **me anën e revolucionit** — Noli e ka fjalën për Revolucionin e Qershorit 1924.
 6. **nuk punoi** — nuk i doli për mbarë, nuk siguroi fitore.
 7. **vizhdanin** — këtu: kurajon, guximin
 8. **shenjat e kohës** — këtu: të parashikonin fundin, të ardhmen e tyre.
 9. **që po i ndjekin pas** — është fjala për forcat e reaksionit që pas fitores së revolucionit në Shqipëri, u shpërndanë në të katër anët e botës, ndër të tjera edhe në Amerikë.
 10. **gubernën** — qeverinë
 11. **që i bënë varrë** — këtu: që përmbysën qeverinë demokratike më 1924 dhe që ia shitën Shqipërinë Italisë më 7 prill 1939.
 - 12) **demoralizuar** — këtu: janë shthurur, janë bërë imoralë.

Kënga e Rrapo Hekalit*)

... Shumë nga shqiptarët¹⁾ na qahen në këtë mënyrë: «Ore, ç'kanë bërë që na lëvdohen kaq shumë». Edhe kur të thonë kështu, sikur ta presin gjuhën. S'kemi lënë kusur, i kemi bërë të gjitha pothuaj ç'kishim në program të bënir. Kishim në program një Shqipëri independente, e bëmë, të mirë të keqe, e

*) Gjykimet e fundit për problemet e letërsisë Noli i ka dhënë qy nga fundi i viteve 50 dhe në fillim të viteve 60. E kësaj periudhe është edhe shkrimi për këngën e Rrapo Hekalit. Kjo pjesë është shkëputur nga një fjalim që mbajti më 1958 në Boston përpara bashkatdhetarëve të vet.

Rrapo Hekali është një nga udhëheqësit kryesorë të kryengritjes fshatare antiosmane të vitit 1847. Krahas Zenel Gjolekës, ai u shqua sidomos në Luftimet për çlirimin e Beratit dhe në luftimet e Greshicës. Pas shtypjes së kryengritjes nga një ekspeditë e madhe ushtarake osmane që u kap befasisht, por edhe para torturave më çnjerëzore mbajti një qëndrim të paturdur burrëror, duke shpallur se luftonte për fakir-fukaranë. Vdiq në burg të Manastirit, i helmuar nga autoritetet osmane. Heroizmin e tij në luftën për çlirim, populli e përjetësoi në shumë këngë historike, njëra prej të cilave është kjo që analizon Noli.

Kënga popullore e ka frymëzuar Nolin që të bëjë një analizë më të bukur dhe të ngrejë lart vlerat e saj. Duke e zbërthyer brendinë në një sfond të qartë historik, Noli argumenton faktin se shqiptarët janë një popull shumë i lashtë në këto troje, ata kanë historinë dhe kulturën e tyre, të dokumentuar në shekuj, ashtu siç është dhe kënga e Rrapo Hekalit. Me këtë qëndrim Noli u kundërvihet atyre pseudopatriotëve që mburren se e filluan «punën për Shqipërinë nga hiçi», duke dashur të mohojnë kështu të kaluarën e lavdishme dhe heroike të popullit tonë.

bëmë. Nuk mund të presim nga një foshnjë që t'i ketë të gjitha të mirat. Foshnjes duhet t'i jepet kohë që të rritet e të tregojë se ç'është. S'mund t'i qortosh prindërit e t'u thuash: «Ç'keni bërë me këtë foshnjë!?» Duhet të presim të rritet foshnja dhe të tregojë se ç'lule është...

Tani pasi bëëmë këtë lëvdatë, duhet t'u heqim vërejtjen shokëve e t'u themi se këto nuk i bëëmë nga hiçi, p.sh., shumë thonë se patriotët shqiptarë s'kanë patur patriotizëm. Gjë më të gabuar se kjo nuk ka. Hap «Bletën shqiptare»²⁾ të Thimi Mitkos të botuar më 1878, ku ka mbledhur këngë popullore, disa nga të cilat janë nga shekulli i tetëmbëdhjetë dhe disa nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. Do t'ju them një nga këto vjersha popullore, e cila është në «Bletën shqiptare» dhe provon katërcipërisht se shqiptarët kanë pasur një patriotizëm të thellë që përpara se të niste ajo që quajmë lëvizja shqiptare moderne, të cilën ne e nisëm nga koha e Kristoforidhit, që më 1875.

Vjersha popullore që do t'ju deklamoj tani është krijuar më 1850, kur u bë kryengritja e Labërisë në kohën e Tanzimatit³⁾. Turqia desh të impononte Tanzimatit, një kanun të përgjithshëm për gjithë viset e Turqisë. Kjo do të thoshte që ca të drejta të paka vetëqeverimi që kishin shqiptarët, do t'i merrte Turqia dhe kështu vendi do të robërohej fare. Dhe populli u ngrit.

Kryetrimave të kësaj lëvizjeje u thonë Rrapo Hekali, Hodo Nivica⁴⁾ dhe Gjoleka⁵⁾.

Kënga që do t'ju them tani është kënga e Rrapo Hekalit, është vetëm njëmbëdhjetë radhë. Po jua them... Dhe pastaj do ta analizoj pak:

Hajde, mor Rrapo Hekali,
kur thërret sa tundet mali,
Hajde, mor Rrapo, o lule,
Lum si ti, bilbil që zure,
Një pasha me shtatë tuje.
Topi bam e ti po tutje.

Plumbat të binin mbi supe
 As u trembe, as u tute
 Se Hodo Nivica shkoi
 Kofshën derrit ia dërmoi.
 Ngriti flamurin te kroi.
 Pse, lufton a derëzi?
 As për mua, as për ti
 Po për gjithë Shqipëri!

Hapni «Bletën shqiptare» që të gjeni këtë këngë, të krijuar jo më vonë se 1860. Ato tri radhët e fundme tregojnë se qëllimi i kësaj kryengritjeje ishte për tërë Shqipërinë.

Tani do t'ju bëj një analizë të paktë që të shikoni se kjo vjershë me këto njëmbëdhjetë radhë është një kryeveprë e vërtetë, të cilën mund ta shkruante një nga poetët e parë të botës. Shikoni tani se si e përshkruan Rrapo Hekalin. Në kohën e Rrapo Hekalit nuk kishte telefon. Rrapo Hekali kur thërriste lebrit që të mblidheshin për të bërë luftë, i vetmi telefon që kishte, ishte zëri i tij. Dhe shikoni se sa bukur e përshkruan: «Hajde, more Rapo Hekali/ Kur thërret sa tundet mali». Kur bërtiste: «hej, hej, or shokë» tundej mali i tërë dhe gjithë lebrit dëgjonin dhe të gjithë mblidheshin.

Tri radhët e pastajme: «Lum si ti bilbil që zure/ Një pasha me shtatë tuje». Pashai që zure ti kishte shtatë tuje⁶⁾. Tujet ishin tamam si ato tujet që mbajnë gjeneralët në Amerikë. Kemi gjeneral me një yll me dy e me tre dhe me katër. Përmbi katër, gjeneral nuk ka. Gjithashtu edhe në Turqi kishte pashallarë me katër tuje dhe jo pashallarë me shtatë tuje. Po vjershëtori do të thotë se çfarë pashai zuri. Ky pasha që dy herë sa pashallarët e tjerë, domethënë gjenerali më i mirë i Turqisë. Edhe e shtypi Rrapo Hekali.

Shikoni tani tri vargjet që vijnë pas. Çfarë strategjie, çfarë taktike ndoqi Rrapo Hekali që e shtypi këtë gjeneral të dorës së parë të Turqisë:

Topi bam e ti tutje
Plumbat binin mbi supe
As u tunde, as u tute.

Domethënë me një trimëri të thjeshtë: asnjë zanat, asnjë mjeshtëri tjetër.

Tani ç'gjë e shkaktoi këtë hov të pathyer të shqiptarëve? Vjershëtori na e thotë përsëri me tri radhë:

Se Hodo Nivica shkoi
Kockën derrit ia dërmoi
Ngriti flamurin te kroi.

Derrit, të cilit ia preu kofshën Hodo Nivica, ishte turku. Ngriti flamurin te kroi dhe ky qe flamuri i kryengritjes, flamuri i lirisë. Dhe më në fund, qëllimi për të cilën bëhej tërë kjo luftë del përsëri me tri radhë. Na i thotë vjershëtori, ustai i madh nuk humbet shumë fjalë, dy-tri fjalë mjaftojnë për të:

Pse lufton, a derëzi?
As për mua, as për ti
Po për gjithë Shqipëri.

Kështu, që ne nuk e shpikëm patriotizmen shqiptarë, e gjetëm. E vetmja gjë që bëmë është që atë patriotizëm që ekzistonte midis shqiptarëve u përpoqëm ta organizojmë, ta kanalizojmë, vetëm këtë gjë bëmë...

1. shumë nga shqiptarët — Noli ka parasysh disa qarqe të caktuara në SHBA.

2. Bleta shqiptare — është përmbledhja më e plotë e folklorit shqiptar e bërë në shekullin e 19-të, që u botua nga Thimi Mitkoja në Aleksandri më 1878. Vepra dëshmon për njësinë kombëtare të kulturës popullore dhe për përpjekjet për çlirimin e popullit shqiptar. Botimi i saj në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shërbeu si një armë kulturore dhe politike kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit, që

synonin të copëtonin Shqipërinë. Duke marrë shkas pikërisht nga kjo këngë historike që ishte botuar në të, Noli me një mjeshtri të rrallë artistike e me argumenta bindës, mbron patriotizmin dhe lashtësinë e shqiptarëve në shekuj në këto troje (trojet e veta).

3. **Tanzimat-i** — reformë e qeverisë turke më 1839, që synonte rimëkëmbjen e autoritetit shtetëror me anë të centralizimit burokratik të administratës sipas shembullit të shteteve evropiane.

4. **Hođo Nivica** — një nga kapëdanët e forcave shqiptare në kryengritjen e Shqipërisë së Jugut më 1947. Pas shtypjes së kryengritjes nga ushtria osmane u internua dhe vdiq në Stamboll.

5. **Gjoleka** — udhëheqës i lëvizjes fshatare në Shqipërinë e Jugut në vitet 30-40 të shekullit të 19-të, sidomos kundër politikës centralizuese të Tanzimatit. Në kryengritjen e vitit 1847 u zgjodh komandant i forcave kryengritëse dhe udhëhoqi me trimëri kryengritjen e zonës midis Kurveleshit, Delvinës, Çamërisë, Gjirokastrës dhe Vlorës. U vra më 1852 në luftime me forcat malazeze, që shkëlpin vazhdimisht truallin shqiptar.

6. **Tuje** — shenjë dalluese, gradë për oficerët e ushtrisë osmane.

Bisedë*)

F. Noli. — Kam studiuar muzikë që kur isha fëmijë. Im atë merrej shumë me muzikë dhe punonte si psallt¹⁾ në kishë. Ai kishte studiuar hollësisht muzikën bizantine dhe këtë ma mësoi edhe mua. Sa herë që ai psallte në kishë, unë duhej ta ndihmoja. Kur erdha këtu²⁾, pata rastin të studioja për muzikë rreth 7 vjet në konservatorin e muzikës, ku mora gradën e parë shkencore.³⁾ Më vonë mora dhe gradën e dytë (atë të Mjeshtrit) me veprën «Bethoveni dhe Revolucioni francez» në kolegjin e muzikës të Universitetit të Bostonit. Kjo është e gjitha mbi formimin tim muzikor. Arsimin muzikor e mora këtu, por natyrisht e kisha filluar me tim atë që në vendlindje.

Pyetje — Ju e keni përkthyer Servantesin nga origjinali?

F. Noli. — Kam studiuar spanjisht për tre vjet në Universitetin e Harvardit⁴⁾ dhe profesori i

*) Kjo bisedë është mbajtur nga Noli anglisht më 1958, d.m.th. 7 vjet para vdekjes. Regjistrimi i saj gjendet pranë arkivit të Institutit të Gjuhësisë e- të Letërsisë.

Në këtë bisedë e në të tjera që ka mbajtur, Noli sjell përvojën e tij të gjatë për mjaft probleme që lidhen me figurën e tij të shumanshme si shkrimtar, përkthyes, muzikolog etj.

spanjishtes ishte spanjoll, ashtu si të gjithë profesorët e tjerë, për shembull, kurset e frengjishtes jepeshin nga francezë, ato të gjermanishtes nga gjermanë, ato të spanjishtes nga spanjollë. Pra, unë mund të lexoj spanjisht.

Pyetje — Po «Armikun e Popullit»?

F. Noli — «Armiku i Popullit» është i Ibsenit⁵⁾ dhe e kam përkthyer nga danishtja. Ata që mund të lexojnë gjermanisht, mund të mësojnë të lexojnë danisht në 15 ditë. Kursi jepej në Harvard mbi letërsinë daneze dhe norvegjeze. Me që unë e admiroja Ibsenin që kur punoja si sufler në teatër, desha ta ndiqja këtë kurs dhe ta lexoja Ibsenin në origjinal. Profeshori ynë na dha mësimet vetëm 7 ditë, sa për të qenë në gjendje të lexojmë danisht. Por, natyrisht, ata që lejoheshin të ndiqnin kursin duhet të dinin gjermanishten. Pra, atëherë unë zbulova se mund të mësosh të lexosh danishte brenda 7 ditëve, po të dish gjermanisht.

Pyetje — Në origjinal është «Volkefiende» d.m.th. një armik i popullit. Përse e keni përkthyer

Armiku i Popullit?

F. Noli — Po, ndoshta mund të keni të drejtë, është një armik i popullit. Volkefiende është një armik i popullit. Pra, siç e shihni nuk ka një shqesë përpara. Po, po, ndoshta keni të drejtë. Në frëngjisht është një armik i popullit, edhe në anglisht është një armik i popullit. Përkthimi më i mirë do të ishte «Një armik i popullit». Do ta ndreq kur ta rishtyp librin (të qeshura e duartrokitje).

Pyetje — Ju nuk e përmendët përkthimin e «Librit të këngëve» nga Kostandin Kristoforidhi.

F. Noli — Po, e di që Kristoforidhi ka përkthyer edhe këngët. Ai bëri një punë shumë të bukur,

por unë harrova ta përmend. Përkthimet e tij më pëlqejnë shumë. Të dyja përkthimet e tij janë shumë të mira.

Pyetje — Po njohuritë dramatike?

F. Noli. — Po, njohuritë mbi artin dramatik unë i mora gjatë atyre pesë vjetëve që kam punuar si sufler⁶⁾ në teatrin grek. Gjithë kohën lexoja dhe gjatë atyre viteve u njoha me të gjithë autorët e dramavë, më njohu vetë praktika, me veprat e Shekspir, Viktorian Sardasë,⁷⁾ sepse «Toska»⁸⁾ luhej në atë kohë. Pra, u njoha me të gjithë dramaturgët e lashtësisë dhe me ata të kohës së sotme, veprat e të cilëve luheshin në atë teatër. Unë punoja si sufler, por ngandonjëherë duhej t'i ndihmoja aktorët. Pra, duhej të ndihmoja të mbanin mend pjesën e tyre. Megjithatë, nuk pata shumë sukses. Për vetë i mësoja përmendësh. Ata nuk mund të mbanin mend shumë. Pra, kjo më dha njohuritë dramatike.

Pyetje — Ju po lexoni pa syze.

F. Noli. — Dikur kam mbajtur syze. Fillëva të përdor syzet kur po stërmundohesha me Omar Khajamin, kur përpiqesha ta përktheja sa më mirë Omar Khajamin. Kur po lexoja disa libra në bibliotekën e Berlinit, disa libra me shkronja shumë të vogla, mendova se më nevojiteshin syzet. Shkoja vazhdimisht në atë bibliotekë. Nuk e di, a ju kam treguar si mund të dallosh një gjerman nga një francez, një rus apo një grek? A ju kam treguar këtë?

Shumë studiues, shkojnë e studiojnë në Berlin, në universitetet gjermane. Disa nga ata gjermanë janë profesorë të mëdhenj, dijetarë të mëdhenj. Një herë, po diskutonin si mund të dallosh kush është student gjerman, e kush është student fran-

cez, kush është student grek e kështu me radhë. Dikush tha që po të jetë bjond është gjerman. Jo, tha një tjetër, mund të takosh disa gjermanë që duken si grekë. Pra, kjo nuk qëndron. Kështu njëri dha këtë shpjegim. Studenti gjerman është ai që hyn në bibliotekë së bashku me portierin që e hap derën dhe del nga biblioteka së bashku me portierin kur ai e mbyll derën. Ky pra është student gjerman. Studenti francez shkon në bibliotekë dhe qëndron rreth një orë. Pastaj del për të pirë një cigare dhe nuk kthehet më. Ndërsa student grek është ai që shkon në bibliotekë, e gjen librin që do të lexojë dhe pa e hapur fare librin del pas pak jashtë nga biblioteka. (të qeshura).

Në atë kohë punoja shumë dhe qëndroja në bibliotekë që kur hapej e deri kur mbyllej, sepse duhej të përfundoja punën. Mendova se më nevojiteshin syzet dhe i kam mbajtur ato që nga 1927 deri sa shkrojta disertacionin për gradën e doktorit mbi Skënderbeun.⁹⁾ Duhej të lexoja shumë libra. Më vonë i lashë syzet dhe zbulova se nuk më nevojiteshin fare. Ishte vetëm një iluzion.¹⁰⁾ Mendova se kisha nevojë për to. Kam marrë një këshillë nga një libër. Kur ndjeheni të lodhur mbyllni librin, ndërprisni leximin. Por, në atë kohë unë nuk e mora parasysh këtë këshillë dhe doemos kur je shumë i lodhur, nuk mund të lexosh. Kështu që mendova se më nevojiteshin syzet. Por në të vërtetë s'kisha nevojë fare për to.

Pycnje — Cilin libër do të parapëlqeni për të rinjtë, nëse do t'ju duhej të zgjidhni vetëm një?

F. Noli — Për të rinjtë, do të thoja të gjithë librat e mi. Po të më pyesni cilën poezi do të

parapëlqeja, poezinë e Marathomakut, si më të mirën.

Nuk e kam marrë librin me vete. Po ta keni «Albumin» këtu, do t'ju lexoja një nga ato poezi. Mund të lexoni edhe disa pjesë nga Omar Khajami. Do të doja t'ju lexoja disa nga poezitë e mia e jo përkthime. Nuk e kam marrë librin me vete. Mendova se këtu nuk do të flisja shqip, por vetëm anglisht.

Pyetje — Mund të na thoni diçka për pasurimin e fjalorit?

F. Noli. — (flet shqip) Nuk i kam kënduar këto libra. Të vetmit libra të fundit shqip që kam kënduar është Historia e Shqipërisë dhe kam lexuar pak Histori të letërsisë. Këto vetëm kam kënduar. Vura re një gjë që s'më pëlqeu. Nuk e di pse, p.sh., thonë ne duam, dhe gjithnjë atë «ne» e vënë përpara dhe kuptojnë që «unë dua, ti do, ai do, ne duam, ju doni, ata duan» dhe e vënë gjithnjë atë «unë» ose «ne» përpara. Në shqip nuk është e nevojshme ajo. Kur themi «ne duam» merret vesh fare. Në frëngjisht, p.sh., nuk mund të thuash «vulò», do të thuash «nu vulò»¹⁾, se ashtu e do gjuha, s'ke ç'bën. Por ne mund të themi «duam», dhe kur themi «ne duam», ne jo ju, pra është për ta theksuar.

1. psallf — ai që këndon këngë e lutje fetare

2. kur erdha këtu — është fjala për në SHBA.

3. gradën e parë shkencore — gradën e parë shkencore «Bakalar» në muzikë Noli e mori më 1939, në moshën 57 vjeç në degën pasuniversitare të Universitetit të Bostonit. (Një vit më parë, më 1938 ai ishte diplomuar në muzikë në Konservatrin e Nju-Inglandit).

4. Universiteti i Harvardit — universitet amerikan i themeluar më 1936 në Kembrixh nga Xhon Harvardi.

5. Henrik Ibsen (1828-1906) shkrimtar i dëgjuar norvegjez,

i njohur në vendin tonë nëpërmjet dramave «Zonja Ingra e Ostroutit», «Armiku i popullit», «Per Gynt», «Hijet» etj. Dy të parat janë përkthyer nga Fan Noli, nga të cilat e para shquhet për frymën e thellë patriotike dhe e dyta për frymën demaskuese kundër shoqërisë borgjeze e përgjithësisht kundër sistemit kapitalist, por nga pozitat e një socialisti utopik.

6. **sufler** — punonjës i teatrit që u pëshpërit fjalët aktoreve, për t'ua kujtuar gjatë shfaqjes. (Qëndron i fshehur në skenë).

7. **Viktorian Sardesë** (1831-1908) — dramaturg francez

8. **opera «Toska»** — operë me tri akte e Xh. Puçinit që u kompozua më 1900 sipas dramës së Viktorian Sardesë, (shkruar më 1887).

9. **disertacioni për gradën e doktorit mbi Skënderbeun** — Noli e mbrojti, kur ishte 63-vjeç. (në Universitetin e Bostonit).

10. **iluzion** — perceptim i gabuar ose i shtrembëruar i sendeve

11. **nu vulò (nous voulons)** — ne duam. Edhe nga kjo vërejtje vihet re se Noli është një njohës i mirë i gjuhës shqipe, megjithëse shumë pak jetoi në Shqipëri. Ai me të drejtë e quan të gabuar përdorimin e përemrit vetor të vetës së parë njëjës në funksion të kryefjalës (kur ajo nuk theksohet se kur nuk kemi kundërvënje).

Shekspiri dhe unë*)

Ishte viti 1897, unë atëhere isha 15 vjeç, kur takova Shekspirin për herë të parë.¹⁾ Kjo ishte një nga ngjarjet më të mëdha të jetës sime. Atëherë studioja në një gjimnaz grek. Megjithëse me prejardhje shqiptare, më duhej të shkoja në një shkollë greke në Adrianopolje, pasi shkollat shqipe nuk i lejonte qeveria turke.

Një ditë shkoj për të ngrënë mëngjesin tim mikroskopik që s'ish veçse një tas i vogël me kafe të zezë pa sheqer. Gjithë-gjithë disa gllënjka e asgjë më tepër. Në tavolinën e gjatë ku isha ulur vura re katër të panjohur, dy burra e dy gra, që po hanin të njëjtën gjë. Zonjat binin në sy nga kapelet ekstravagante,²⁾ me puplat që gati arrinin tavanin. Diskutimin zhurmshëm për vënien në skenë të «Hamletit».

*) Më 1964 u festua 400-vjetori i lindjes së Shekspirit. Komisioni i ngritur për këtë përvjetor i kërkoi Nolit, i njohur si një nga përkthyesit më të shquar të dramaturgut të madh, që t'i dërgonte nga një kopje të veprave të përkthyer, një artikull ku të tregonte se si e kishte njohur për herë të parë Shekspirin, dhe një artikull kritik për të. Me këtë rast Noli shkroi dy artikuj: «Shekspiri dhe unë» dhe «U. Shekspiri».

Është një rastësi e bukur dhe kuptimplote që Noli e nisi veprimtarinë e tij si përkthyes e kritik me Shekspirin dhe e mbaroi po me Shekspirin. Këto janë edhe dy shkrimet e fundit që kemi nga pena e Nolit.

Në artikullin «Shekspiri dhe unë» Noli jep kujtimet e tij se si u njoh dhe u dashurua me dramaturgun e madh. Lidhjet e tij janë të gjithanshme e mbi të gjitha lidhje një-rëzore e artistësh.

të cilin shpresonin ta luanin në teatrin lokal. Menjëherë e kuptova që ishin aktorë e aktore të një shoqërie teatrore shëlitëse greke. Nga bisedat e tyre mora vesh se dy aktorët e rinj dinin të lexonin e të shkruanin greqisht, ndërsa dy aktoret bukuroshe ishin analfabete. Bile, ato s'dinin të vinin as firmën.

Pas këtij mëngjesi të lirë, me gjysmë tasi kafe turke, dy djemtë morën të ngrihen.³⁾ Po para se të largoheshin thanë: «Tani, vajza, studioni pjesët që kini!» Ato u përgjigjën: «Po si ta bëjmë këtë? Ne s'dimë të lexojmë». Aktorët ua kthyen: «I thoni atij djalit (e kishin për mua), që t'ju ndihmojë. Ai ndjek gjimnazin dhe di të lexojë greqisht.» Aktoret u përgjigjën: «Po ne s'kemi para. Si ta paguajmë?» Aktorët ua kthyen: «As ne s'kemi, po e rregullojmë kështu: t'i japim bileta falas për të gjitha shfaqjet tona». Duke më vështruar, thanë: «A jeni i kënaqur kështu?» Unë pranova pa një pa dy.

Aktorët më dhanë pjesët dhe filluam menjëherë. Njëra do të luante Ofelinë, ndërsa tjera të ëmën e Hamletit, mbretëreshën. Do të vepronim kështu: unë do të lexoja pjesën, fjali për fjali, ndërsa aktoret do t'i përsërisnin.

Pas pak kohësh m'u ngarkua një detyrë tjetër po në këtë shoqëri. Sufleri u sëmur e s'kish kush ta zëvendësonte. Shumë pak aktorë dinin të lexonin në «katharevuza» (një dialekt artificial pseudoklasik). Dy aktoret që po ushtroheshin me mua, i sugjeruan⁴⁾ drejtuesit: «Njohim ne një djalë që e bën këtë punë». Përsëri edhe këtë herë unë pranova pa asnjë kundërshtim. M'u dha kështu rasti të bëja punën e suflerit të «Otello» i Shekspir, dhe unë mund ta bëja këtë pa parë fare në tekst. Vetëm për pak ditë arrita të recitoj në greqisht të gjitha monologët e «Hamletit» e të «Otellos».

Një natë ndodhi diçka që më tmerroi. Kostas Tavularis,⁵⁾ që po luante Otellon, duke dashur ta bënte sa më të gjallë lojën, gati sa s'po e mbyste Desdemonën. Dëgjova të shoqen, zonjën Tavularis, e cila luante

rolin e Desdemonës së shkretë tek thërriste për ndihmë dhe i lutej të shoqit: «Mos kaq fort. Do më mbytesh». Dhashë shenjë të ulnin perdet duke parandaluar kështu vrasjen.

Pasi mbarova gjimnazin, shkova në Kostandino-pojë, ku i hipa anijes për në Athinë për të gjetur ndonjë punë. Gjëja e parë që bëra kur mbërrita në Athinë, shkova në zyrën e trupës së Tavularisit dhe i kërkova të më jepnin punë në shoqërinë e tyre teatrale. E pritën me qejf. Më dhanë punë menjëherë të kopjoja pjesët.

Mënyra se si i paraqiteshin publikut grek pjesët e Shekspirin më 1898 ishte disi e çuditshme. P.sh., pas aktit të tretë, Hamleti dhe Ofelia do të dilnin në skenë pa i hequr kostumet dhe do të këndonin ndonjë nga ato duetet e rëndomta, që ishin shumë të përhapura aso kohe, të ngjashme me ato kanconetat e Frenk Sinatrës.⁶⁾ Po ç'ndodhte pas aktit të fundit të «Hamletit»? Luhej ndonjë komedi moderne njëaktëshe krejt pa vlera. Drejtuesi i shoqërisë e shpjegonte kështu: «Publiku zor se e duron tragjedinë e tmerrshme «Hamlet» pa ndonjë muzikë të lehtë midis akteve e një komedi gjallëruese në mbyllje».

Aktorët s'paguheshin rregullisht. Merrnin një lloj përqindjeje nga të ardhurat, por këto s'u mjaftonin për të mbajtur frymën. Në të gjitha qytetet çdo fund sezoni ishte i njëjtë. Shumë prej aktorëve mbeteshin në mes të katër rrugëve. U duhej të prisnin ashtu, pa asnjë dysh e të rraskapitur nga uria, derisa të gjenin ndonjë punë të re apo çmim nga ndonjë sipërmarrës teatros. Edhe unë gjendesha midis këtyre të braktisurve.

Një nga aventurat tona teatrale më të këqija ishte ajo e Ponto-Iraklias⁷⁾ në Anatoli.⁸⁾ Të ardhurat nga shfaqja e parë tregonin se gjithçka s'do ish veçse një dështim i tmerrshëm. Dy javë më pas drejtuesi i shoqërisë iku natën, duke marrë me vete dhe paratë. Aktorëve u duhej t'ia dilnin vetë dhe të jepnin shfaqje në një sallë të zymtë për të mbajtur frymën gjallë.

Pikërisht në mes të këtij mjerimi arrita të kuptoj ëndrën më të shtrenjtë të çdo aktori. Hamleti dhe Ofelia ishin sëmurë nga të pangrënët dhe lodhja. Dilte problemi nëse duhej shtyrë shfaqja apo duhej dhënë ajo, me qëllim që të nxirreshin ca para për bukë e të shtyhej kështu sa të ish e mundur. Më thanë në mund t'i zija vendin e aktorit kryesor dhe të luaja Hamletin. Pranova menjëherë, para se t'u kthehej mendja. Fundi i fundit unë e dija pjesën më mirë se çdo aktor kryesor, me të cilin — kisha bërë punën e suflerit.

Puna u ngatërrua kur u munduam të gjenim dikë për të luajtur Ofelinë. Vetëm një njeri mbahej ende në këmbë. Kjo ish Kaliroi. Ishte e çalë dhe kurrë s'kish dalë në skenë, bile as me ndonjë rol të vogël. Ajo i shërbente së motrës që ishte aktorja kryesore. Askush s'mund ta imagjinonte se ajo krijesë e gjorë kish ushqyer ndonjëherë shpresë për të luajtur Ofelinë. Ndodhi ç'ka s'pritej. Kur të çalës iu dha pjesa e Ofelisë, ajo s'po u besonte veshëve. Pranoi se gjatë gjithë jetës kish përgatitur fshehurazi rolin e Ofelisë.

Kështu tragjedia «Hamlet» u shfaq menjëherë të nesërmen në darkë të asaj dite, e improvizuar⁹⁾ në këtë mënyrë dhe pati sukses të madh. Askush nuk dyshoi se Ofelia ishte e çalë. Ajo ndenjtë në karrigë dhe e luajti pjesën ulur. Unë, si Hamlet, bëra ç'ishte e mundur që publiku të mos e vinte re atë gjë. Meqenëse Hamletin e marrin si gjysmë të çmendur, unë bëra lloj-lloj piruetash përreth karrigës për ta theksuar këtë edhe më. Ofelia ishte e detyruar të ndiqte lëvizjet e mia me sy, krejt e shtangur. Vite më pas e solla ndër-mend Kalironë e çalë, kur pashë Sara Bernardin¹⁰⁾ të moshuar, që jepte një shfaqje të mrekullueshme me zërin, fytyrën dhe krahët e saj, megjithëse mezi qëndronte në këmbë.

Gati dy javë më vonë një anije e ngarkuar me plehra për bimë, nga shkaku i një stuhie u detyrua të futej në portin e Porto-Iraklisë. Kapitani i mëshirshëm u prek nga mjerimi i aktorëve shekspirianë, disa nga të cilët ishin bërë kockë e lëkurë. Ai u dha ush-

qim falas e premtoi t'i çonte pa para në Kostandinopojë. Pjesa më e madhe e aktorëve ishin dobësuar kaq shumë sa që gjatë gjithë udhëtimit u desh të rrinin shtrirë, derisa marinarët bujarë t'i sillnin në vete, duke u dhënë për të ngrënë. Ja për çfarë kishin nevojë ata, që të ngriheshin në këmbë përsëri.

Katastrofa¹¹⁾ e fundit ndodhi në Aleksandri: përsëri të braktisur, përsëri të rraskapitur nga uria. Aktoret dhe aktorët e tmerruar u nisën njëri pas tjetrit për në Athinë me anijen e parë që gjetën. Erdha në përfundimin që ky ishte fundi i karrierës sime teatrale. S'kishte kuptim t'i mbetesh besnik një profesioni të tillë që më çoi nga një cep i Mesdheut në tjetrin, duke më kërcënuar në çdo port me urinë. Kështu, u largova nga teatri, por jo nga Shekspiri.

Shpëtimi më erdhi kur më ofruan¹²⁾ një vend për mësues në Shibin-el-Kom, pak orë larg Aleksandrisë. E pranova këtë rast pa asnjë ngurrim dhe u nisa me trenin e parë për në Shibin-el-Kom. Deri atëherë e kisha lexuar Shekspirin nga një përkthim grek pa vlerë. Kish ardhur koha që ta lexoja në gjuhën e vet.¹³⁾ Takova një misionar¹⁴⁾ anglez që më ndihmoi duke më dhënë falas mësim angliisht. I detyrohem atij që, kur erdha në SHBA në 1906, munda ta kaloj për pak minuta provimin e gjuhës.

Zbrita në Nju-Jork për të shkuar në Bufalo, prej Bufalos në Boston. Dhe atje e takova përsëri mikun tim të vjetër, Shekspirin në Teatrin Castle Square,¹⁵⁾ ku e paraqisnin dy aktorë të shkëlqyer, E.H. Sothorn dhe gruaja e tij Xhulia Marlou (Julia Marlowe).¹⁶⁾ Unë do t'u jem gjithnjë mirënjohës këtyre dy artistëve të mëdhenj. Deri atëherë unë e kisha lexuar Shekspirin, greqisht dhe e kisha parë të luajtur në skenë greke, por Sothorn dhe Marlou më dhanë përvojën e pashlyeshme që pashë Shekspirin në skenë angliisht.

Vitet e mia të para në Amerikë ia kushtova arsimimit tim. Kur një ditë, një miku im... më sugjeroi të ndanim bashkë pjesët e Shekspirit për t'i përkthyer shqip... Pranova menjëherë me kusht që «Hamletin»

ta merrja unë. Kështu filluam të dy. Unë me «Otellon»
botuar në shqip më 1916 e që u ndoq pas dhjetë vje-
tësh nga «Hamleti», «Jul Çezari» dhe «Makbethi»...
Më vjen mirë të them që disa nga të rinjtë shqiptarë
po e vazhdojnë punën për përkthimin e Shekspirit.

Përsa më përket mua, unë e kam braktisur mikun
tim të vjetër Shekspirin këta 38 vjetët e fundit, për
arsye të ndryshme, një nga të cilat ka qenë dhe Lufta
e Dytë Botërore. Kam shpresë t'i kthehem përsëri, duke
dhënë disa kryevepra të tij të tjera në shqip. Unë
mund ta bëj këtë. Jam ende i ri. Jam vetëm 82 vjeç.¹⁷⁾

1. **takova Shekspirin për herë të parë** — këtu ka kup-
timin: fillova të njihem për herë të parë me veprën e Shek-
spirit.

2. **ekstravagante** — këtu: elegante, të modës së fundit, tepër
luksoze.

3. **morën të ngrihen** — filluan të ngriheshin, po ngri-
heshin.

4. **sugjeruan** — propozuan, shfaqën mendimin, këtu: thanë.

5. **Kostas Tavullaris** — njëri nga aktorët e trupës tea-
trorë lëvizëse.

6. **Frenk Sinatra (1915)** — këngëtar amerikan

7. **Ponto Iraklias** — qytet në Azinë e Vogël

8. **Anatoli** — Krahinë në Azinë e Vogël

9. **e improvizuar** — e krijuar aty për aty, e papërgatitur
më parë.

10. **Sara Bernardi** — (1844-1924) — aktore e njohur fran-
ceze, e cila në vitet 1898-1922 drejtoi në Paris një teatër që
mbante emrin e saj.

11. **katastrofë** — fatkeqësi e madhe që vjen papritur, shka-
tërrim i madh

12. **më ofruan** — më propozuan

13. **në gjuhën e vet** — në origjinal, anglisht

14. **misionar** — ai që ngarkohet me një detyrë (mision) të
posacme për të përhapur një ideologji, një doktrinë etj.

15. **Costble Square** — teatër në Boston

16. **E.H. Sothern** — **Julia Marlou** — aktorë të teatrit të
Bostonit

17. Noli edhe pse i moshuar, 82 vjeç, është optimist për
jetën dhe veprimtarinë e tij krijuese.

U. Shekspiri*)

Së pari, më lejoni t'ju them se nuk do të flasë gjatë për madhështinë e Shekspirit si dramaturg. Çdo anglishtfolës e di këtë gjë, kështu që s'ka kuptim ta humbasim kohën me këtë temë. Por, a e kanë lexuar veprën e tij të gjithë anglishtfolësit dhe a e kanë parë të luajtur në skenë? Për këtë nuk jam i sigurt. Pjesa më e madhe e veprës së tij është shfaqur në një vend, ku nuk flitet anglishtja. E ky vend është Gjermania. Pikërisht atje kam parë të luhet një pjesë e mirë e dramave të Shekspirit.

Në këtë vështrim, Gjermania është një vend i madh. Ajo vepron kështu me të gjithë kompozitorët dhe dramaturgët e saj të mëdhenj, si dhe me ata të vendeve të tjera, dhe jo vetëm në qytete pak të njohura si Bajrejti (Bayreuthi)¹⁾ i Rikard Vagnerit,²⁾ por dhe në të gjitha metropolet gjermane. Do të habitesha po të mësoja se cikle të tilla të kryeveprave të Shekspirit

*) Në qoftë se në shkrimin «Shekspiri dhe unë» Noli sjell para lexuesit botën e gjerë e të pasur të kujtimeve që e lidhin me mjeshtrinë e madh, në këtë shkrim, Noli i moshuar, me një kulturë e përvojë të gjatë e të pasur jetësore e artistike, u mëson lexuesve rrugë të reja se si mund të hyjnë gjithnjë e më thellë në zbërthimin ideor e artistik të veprës së Shekspirit. Duke qenë vetë një njohës me themel i këtij mjeshtri të madh, Noli kërkon që shumanshmërinë dhe pasurinë e vlerave të Shekspirit t'ua bëjë pronë të tyre kulturore edhe lexuesve.

janë shfaqur dhe në Britani. E di mirë që kjo nuk është bërë as në SHBA ku kam 57 vjet që jetoj. Bie fjala, kjo nuk është bërë as në Boston, as në Nju-Jork, Filadelfia, Çikago, San Françisko, etj., po kështu dhe në Londër, Mançester, Birmingham.

Fakti që ndryshe ka ndodhur në Stratford mbi Ejvon³⁾ dhe në Stratford e Konektikat⁴⁾ s'ka ndonjë rëndësi të madhe për publikun e gjerë të qyteteve tona të mëdha. Ajo ka të bëjë me një grup aristokratësh që kanë para dhe kohë të lirë. Masat milionëshe, admiruese të Shekspirit nuk kanë aq para dhe kohë për t'i njohur ato vende të shenjta. Vendet anglishtfolëse të mundohen të bëjnë për Shekspirin të paktën atë që kanë bërë gjermanët për të.

Por Shekspiri nuk është vetëm një dramaturg i madh. Ai është dhe një mjeshtër i madh në shumë fusha të tjera, sa mund të shkruhen vëllime të tëra për çdonjërin prej tyre.

Në radhë të parë, ai është mjeshtër i monologut. Çdo nxënës anglishtfolës e di këtë, sepse atij i duhet t'i mësojë përmendësh në shkollë. Kjo ndodh vetëm me disa nga monologët më të famshëm si: «Të rrosh ose të mos rrosh» nga «Hamleti», «Nesër dhe nesër» nga «Makbethi», «Miq, romakë, bashkëqytetarë» nga «Jul Cezari». E ç'mund të themi për dhjetëra e dhjetëra monologë të tjerë? P.sh.: A njihet publiku me monologun e famshëm të Zhuljetës në aktin IV, skena III që mbaron me këto fjalë: «Romeo, ja për ty e pi këtë»! A e kujtojnë vajzat shkollare këtë monolog? Besoj se po. E njëjta gjë është e vërtetë dhe për monologët e tjerë të famshëm. Kështu, le të hartojmë një vëllim të veçantë me tërë monologët e Shekspirit dhe t'ia japim lexuesit me çmim të lirë.

Shekspiri është mjeshtër i maksimave,⁵⁾ po aq i madh sa dhe francezi Laroshfuko (La Rochefoucauld),⁶⁾ ndoshta dhe më i madh. Lexoni këshillën që Polloni i jep të birit të tij Laertit te tragjedia «Hamleti» akti I, skena III. Ju do të gjeni atje mjaft maksima të mira të Shekspirit. Ja, disa prej tyre: «As mos merr, as

mos jep hua kurrë», «Vëru vesh të gjithave, po jip zë më pak», «Dëgjo këshilla, rezervoj gjykimin». Le të kemi dhe një vëllim të veçantë me maksima nga Shekspiri.

Shekspiri është mjeshtër i portretizimit të karaktereve. Lexoni përshkrimin e Ofelisë që i bën Hamleti:

Oh, çfarë mendje e lartë u përmbys këtu,
oh, çfarë sy e çfarë gjuh' e shpatë
ushtari, oborrtari e shkollari
q'ish trëndafil e shpres' e shtetit bukur
pasqyr' e modës, shëmbëll e kulturës
m'i pam'i pamësve,⁷⁾ krejt, krejt përdhe.

ose më mirë akoma, lexoni përshkrimin që i bën Hamleti babait të vdekur dhe xhaxhait të tij, mbretit, me një paralelizëm⁸⁾ që fillon me fjalët:

Shiko këtë pikturë dhe këtë,
dhe barabit⁹⁾ fytyrat e dy vëllezërve.

Le ta kemi, pra, dhe një vëllim të Shekspirit ku portretizohen heronjtë e tij me fjalë.

Shekspiri është një mjeshtër i epigrameve. Këtu kemi një epigram që përmbledh tërë tragjedinë e Hamletit, në fund të aktit të parë:

Kjo bot' u cthur: o prapësi, o dreq
që unë paskam lindur të të ndreq.

Këtu më poshtë është dhe një epigram tjetër nga «Romeo dhe Zhuljeta», në fund të aktit të parë:

Shko pyet. N'është i martuar
m'u bëftë varr shtrat' i nusërisë.

T'i kemi dhe këto epigrame në një vëllim më vete.

Shekspiri është mjeshtër i shprehjeve dinamike që s'e kanë shoqen as në letërsinë angleze e as në letërsinë botërore. Ja, një mbi jetën:

Është një përrallë
e treguar nga një idiot, plot zhurmë edhe furi,
por që s'thotë asgjë.

Ja dhe një tjetër për dashurinë:

Dhe unë, ndër zonjat më e brengosura e më
fatkeqja,
që thitha mjaltin e tingujve të betimit.

Le ta kemi dhe një libër që përmban të gjithë këta margaritarë të paçmuar të Shekspirin.

Shekspiri është një qëmtues¹¹⁾ i madh i këngëve popullore angleze të kohës së tij. Desdemona këndon një prej tyre përpara se ta mbysin. Ofelia këndon një tjetër, kur është cmendur dhe po shkon të mbytet.

Le të kemi dhe një përmbledhje të këtyre këngëve popullore në një vëllim.

Ne mund të vazhdonim kështu të përshkruanim pa mbarim të gjitha ato fusha, ku Shekspiri është një mjeshtër, por na duhet të ndalemi. Përpara se të ndalem do të më pëlqente të bëja një sugjerim se si duhet lexuar Shekspiri. Kur lexojmë një vepër të tij nga fillimi deri në fund, pa lëvizur nga vendi, ose kur e shohim të luajtur në skenë brenda një mbrëmjeje ne e gllabërojmë Shekspirin. Është e vërtetë se ndiejmë një kënaqësi të madhe, për këtë s'ka dyshim. Por është kënaqësi e madhe edhe kur e lexojmë a kur e shohim ngadalë, si të thuash kur e rrufisim¹²⁾, pak nga pak, siç e pijnë me gllënjka ujën arabët në shkretëtirë ose siç e provojnë verën njohësit francezë. Këtë

gjë ne mund ta arrijmë duke lexuar nga një faqe të Shekspirit çdo mëngjes... pastaj atë e lexojmë prapë në darkë para se të shkojmë të flemë, rresht për rresht e fjalë për fjalë. Vetëm kështu mund ta kuptojmë vlerën e plotë të Shekspirit.

...Pavarësisht se sa bëjmë për Shekspirin, ne kurrë nuk arrijmë të bëjmë mjaft për të. Ta themi këtë me një fjalë të Shekspirit nga «Jul Cezari»: «Ky është më i madhi i të gjithë poetëve».¹³⁾

-
1. **Bayreuthi** — qytet në perëndim të Gjermanisë
 2. **Rikard Vagneri** (1812-1883) — kompozitor i dëgjuar gjerman, gjeni me një forcë të rrallë, por edhe dirigjent i dëgjuar për kohën kur jetoi, si edhe autor i shumicës së libreteve të veprave të tij muzikore. Ai u këndoi kryesisht idealeve njerëzore; shfrytëzoi shumë tregimet e legjendat popullore, duke i trajtuar në muzikë si këngë për natyrën, për dashurinë, për vullnetin e guximin njerëzor.
 3. **Stratford mbi Ejvon** — qytet ku ka lindur Shekspiri.
 4. **Stratford e Konektikat** — qytet në Konektikë, që është një nga shtetet e SHBA.
 5. **maksimave** — sentencave, mendime të shprehura me pak fjalë, gjykimeve të dhëna në formën e një proverbi ose fjale të urtë, që shpreh një të vërtetë jetësore ose morale.
 6. **Laroshfuko** (1630-1680) — shkrimtar francez moralist, autor i veprave «Kujtimet» dhe «Maksimat» të shkruara në trajtën e aforizmave.
 7. **m'i pam'i pamësve** — më i pashmi ndër të pashmit (këtu: më i bukuri ndër të bukurit).
 8. **paralelizëm** — krahasim i zgjeruar ndërmjet dy a më shumë sendeve a dukurive; këtu: ndërmjet pikturës dhe fytyrave të dy vëllezërve.
 9. **barabit** — barazo, këtu: krahaso, vëri ballë për ballë.
 10. **epigram-i** — mbishkrim i shkurtër që grekët e vjetër e shkruanin mbi një përmendore, një statujë, në ballë të ndonjë tempulli. Më vonë u bë hartim i shkurtër poetik, zakonisht shumë i gjallë dhe i mprehtë, gati kurdoherë me karakter satirik, therës.
 11. **qëmtues** — ai që gjurmon, që mbledh me durim e këmbëngulje diçka.
 12. **ruffisim** — pimë duke thithur pak nga pak diçka.

13) Mbresat e para për Shekspirin Nolit i lindën më 1897, kur ishte djalë i ri 15-vjeçar, kurse tani, burrë i moshuar 82-vjeçar, disa muaj para se t'i mbyllë sytë përgjithmonë, i lë lamtumirën e fundit mjeshtrit të madh, duke u dhënë këshilla brezave të ardhshëm se si duhet ta lexojnë e ta kuptojnë vlerën e plotë të këtij gjeniu të pavdekshëm.

10. Die...

PËRMBAJTJA

POEZI

	Faqe
Himni i flamurit	5
Jepni për nënën	8
Moisiu në mal	11
Marshi i krishtit	14
Krishti me kamxhikun	16
Shën Pjetri në mangall	19
Marshi i Barabajt	24
Marshi i kryqësimit	27
Kirenari	30
Kënga e Salep Sulltanit	34
Syrgjyn-vdekur	38
Shpell' e Dragobisë	41
Render' or Maratonomak	44
Anës lumenjve	48
Sulltani dhe kabinetit	52

SHQIPËRIME

Skënderbeu (H. Longfellow)	61
Prometeu i mbërthyer (Eskill)	68
Male, pyje plot me fletë (Servantes)	71

	Faqe
Këtu dergjet Don Kishoti (Servantes)	73
Rubaitë e lirisë (O. Khajam)	74

INTRODUKTA

Otello	79
Hamleti	88
Makbethi	98
Don Kishoti	104

ARTIKUJ

Tolstoi vdiq	111
Shuberti harbut	113
Për Toskaninin	117
Për Don Kishotin	119
«Don Kishotët e Mançes» s'heqin dorë nga vjeturinat	122

ESE DHE BISEDË

Kënga e Rrapo Hekalit	129
Bisedë	134
Shekspiri dhe unë	140
U. Shekspiri	146

Noli, Fan S.

Pjesë të zgjedhura: Poezi. Shqipërime. Introdakta. Artikuj. Ese dhe biseda /Fan S. Noli; Përgat. për bot. nga S. Bulo; Red.: R. Petro. — T.: Shtëp. Bot. e Librit Shkollor, 1990. — 156 f; 18 cm — (Bibliot. e Nxënësit)

891.983-821(075.3)

N 79

U dorëzua në shtyp në dhjetor 1989

Doli nga shtypi në maj 1990

Tirazhi: 5000 kopje Format: 78x109/32 Stash: 2204-82

Shtypur në KOMBINATIN POLIGRAFIK

shtypshkronja e Re, Tiranë 1990